Nexhat Ibrahimi



# Islami dhe muslimanët në tokat shqiptare dhe në Ballkanin mesjetar

/shekujt IX - XIV/

LogosA

Copyrighted material



©LOGOS-A
2003

LogosA

SHKUP
PRISHTINË
TIRANË

Copyrighted material

LEXO



Nexhat Ibrahimi

# Islami dhe muslimanët në tokat shqiptare dhe në Ballkanin mesjetar

/shekujt IX - XIV/

LogosA

Copyrighted material



Nexhat Ibrahimi

# Islami dhe muslimanët në tokat shqiptare dhe në Ballkanin mesjetar

/shekujt IX - XIV/

Copyrighted material

# Përmbajtja

Parathënie ......11
Islami dhe muslimanët në Bullgarinë mesjetare (shekujt IX – XI) ......15
Hyrje ......15
I. Prejardhja dhe vendlindja e parë e bullgarëve, vendosja e tyre në Ballkan dhe në trojet iliro-shqiptare ......16
II. Veprimtaria ushtarake bullgare dhe lëvizjet e tjera në Ballkan dhe në trojet iliro-shqiptare ...... 20
A. Veprimtaria ushtarake ...... 20
B. Lëvizjet etnike, misionariste dhe heretike ......22
III. Gjendja shpirtërore e bullgarëve para kristianizimit të tyre ......25
A. Gjendja e përgjithshme shpirtërore ......25
B. Islami dhe muslimanët në Perandorinë mesjetare Bullgare parakristiane dhe kristiane ......27
C. Kristianizimi i bullgarëve në mesjetë ......32
Ç. Rënia e Bullgarisë mesjetare ......35
Përfundim ......37
Summary ......38
Islam and Muslims in Mediaeval Bulgaria (IX-XI century) ......38
Sari Salltëku dhe roli i tij në përhapjen e islamit në trojet iliro-shqiptare e ballkanike para shekullit XIV ......39
Hyrje ......39
Sari Salltëku ndërmjet legjendës dhe historisë ...... 40
Sari Salltëku si predikues fetar dhe luftëtar ...... 44
Sari Salltëku në trojet iliro-shqiptare ......48
Vdekja e Sari Salltëkut ......53
Përfundim ......55
Summary ......56



Copyrighted material

Sari Salltuk and his role in spreading Islam in the Illyrian-Albanian and Balkan Territories before the XIV century ........ 56
Prejardhja, vendosja dhe roli i peçenegëve në përhapjen e Islamit në trojet iliro - shqiptare e në Ballkan (shekujt IX - XIV) ........ 57
Hyrje ........ 57
Prejardhja e peçenegëve dhe vendlindja e tyre e parë ........ 58
Vendosja historike e peçenegëve në trojet iliro-shqiptare dhe në Ballkan ........ 60
Aktiviteti ushtarak dhe lëvizjet e tjera peçenege në trojet iliro-shqiptare e në Ballkan ........ 63
Peçenegët dhe rusët ........ 64
Peçenegët dhe bizantinët ........ 65
Peçenegët dhe hungarezët ........ 68
Peçenegët dhe bullgarët ........ 69
Peçenegët dhe serbët ........ 70
Peçenegët dhe shqiptarët ........ 71
Peçenegët dhe popujt e tjerë ........ 73
Peçenegët dhe besimi e kultura e tyre islame ........ 74
Zhdukja e peçenegëve nga skena historike ........ 75
Përfundim ........ 77
Summary ........ 78
The origin, locations and role of the Pechenegs in spreading Islam in the Illyrian-Albanian and Balkan Territories ........ 78
Turqit vardarianë dhe roli i tyre në përhapjen e Islamit në trojet iliro-shqiptare nga shekulli IX - XIV ........ 79
Summary ........ 85
The Vardarian Turks and their role in spreading Islam in the Illyrian-Albanian Territories (IX – XIV century) ........ 85
Islami dhe muslimanët në Hungarinë mesjetare (shekujt IX – XIV) ........ 87
Hyrje ........ 87
I. Prejardhja, vendlindja e parë dhe vendosja e hungarezëve në Evropën qendrore ........ 88
II. Aktiviteti ushtarak hungarez dhe lëvizjet e tjera ........ 90
III. Gjendja shpirtërore e hungarezëve para dhe gjatë kristianizimit ........ 92
IV. Islami dhe muslimanët në Hungarinë mesjetare parakristiane dhe kristiane ........ 94
A. Rrugët dhe koha e migrimit të muslimanëve në Hungarinë mesjetare . 94



Copyrighted material

B. Pozita e Islamit dhe muslimanëve në Hungarinë mesjetare ..............100
Përfundim ..........109
Summary ..........111
Islam and Muslims in Mediaeval Hungarian (IX-XIV century) ..........111
Shtojca I ..........113
Jakut El-Hamewiu ..........113
Bashkirët ..........113
Shtojca II ..........117
Ebu Hamid El-Garnati El-Endelusi ..........117
Vendi i Sllavëve (Sakalibëve) ..........117
Qëndrimi në Hungari ..........120
Bibliografia (Burimet, literatura dhe periodiku sipas krerëve) ..........128
Islami dhe muslimanët në Bullgarinë mesjetare (shekujt IX – XI) ..........128
Sari Salltëku dhe roli i tij në përhapjen e islamit në trojet iliro- shqiptare e ballkanike para shekullit XIV ..........131
Peçenegët - prejardhja, vendosja dhe roli i tyre në përhapjen e Islamit në trojet iliro-shqiptare e Ballkan ..........133
Turqit vardarianë dhe roli i tyre në përhapjen e Islamit në trojet iliro-shqiptare nga shekulli IX – XIV ..........134
Islami dhe muslimanët në Hungarinë mesjetare (shekujt IX – XIV) ..........135
Bibliografia (Burimet, literatura dhe periodiku) ..........136
Treguesi i emrave ..........142



Copyrighted material

Copyrighted material

# Parathënie

Hulumtimi dhe studimi i historisë së kulturës islame ndër iliro-shqiptarët gjatë mesjetës, apo hulumtimi dhe studimi i procesit të ardhjes dhe vendosjes së Islamit dhe muslimanëve në trojet iliro-shqiptare dhe në vendet përreth gjatë shekujve IX - XIV është punë e rëndë, komplekse, serioze shkencore shumëdisiplinore.

Ky pohim në rend të parë vjen prej natyrës së Mesjetës, që karakterizohet me periudha të errëta përgjithësisht, dhe prej natyrës së Islamit veçanërisht. Burimet evropiane (ortodokse dhe katolike) janë të pakta, dhe karakterizohen prej paragjykimesh dhe ekskluzivizmi fetar e etnik, intolerancë dhe dhunë të përgjithshme, kurse burimet islame, kryesisht arabisht, janë fare pak të njohura për lexuesin, sepse disa syresh ende janë të panjohura në tërësi, disa në dorëshkrime unikale dhe si të tilla jashta përdorimit publik, e vetëm disa janë të njohura në fragmente apo në tërësi, dhe nuk ofrojnë ndihmesë të dorës së parë. Prandaj, para shkencëtarit qëndron punë e gjatë, serioze dhe shumë e mundimshme, që materialet e shkapërderdhura nëpër burime, literaturë e periodikë të zbulohen, të verifikohen historikisht, të vlerësohen shkencërisht dhe të përfshihen në tërësinë tekstuale.

Arsyen vijuese pse kjo temë ende është 'tabu', e përbën fakti se shumë institucione shkencore hulumtuese dhe individë me rëndësi, me xhelozi ruajnë monopolin mbi 'të vërtetën' dhe për interesa 'të përgjykuar' paraqesin pengesa reale drejt së vërtetës.



Copyrighted material

Ka edhe arsye të tjera për gjendjen ku ndodhemi aktualisht, por nuk do të merremi me të gjitha këto, pasi secili punim veç e veç në hyrjen e tij e trajton këtë çështje dhe, në anën tjetër, për këtë problem tashmë kemi shkruar në librin 'Islami në trojet iliro-shqiptare gjatë Mesjetës'.

Duke u nisur nga kjo gjendje e brenda mundësive reale në këtë kohë, lexuesit po i ofrojmë librin 'Islami dhe muslimanët në tokat shqiptare dhe në Ballkanin mesjetar (shekujt IX – XIV)', i cili është rezultat i një pune të gjatë e të mundimshme, duke hedhur dritë të re. Ai parashtron prova të dorës së parë dhe qasje origjinale rreth tezave tona më heret të shtruara, se Islami dhe muslimanët kanë ekzistuar në këto vende edhe para ardhjes së osmanlinjve, për të dëshmuar se trojet lindore iliro-shqiptare, dhe përgjithësisht shumica e trojeve iliro-shqiptare, të përfshira në Perandorinë Bizantine, atë bullgare, hungareze e të tjera, më herët kanë pranuar islamin, që d.m.th. në disa raste madje më vonë pranuan kristianizmin, siç e dëshmon realiteti i Bullgarisë dhe Hungarisë mesjetare, siç e thotë këtë J. Le Goff 'nga lart e me zor'. Veçanërisht trajtohen viset sot të njohura si Selaniku (një pjesë e Greqisë), Maqedonia, Bullgaria, Serbia, Kosova dhe Panonia, që d.m.th. Ballkani juglindor, lindor, qendror, verilindor dhe verior.

Libri përbëhet nga disa tërësi të shkruara veç e veç, por të përshkuara me një ide boshtore, të përbashkët, duke paraqitur vazhdim ideor dhe thellim të hulumtimeve të nisura nga libri 'Islami në trojet iliro-shqiptare gjatë shekujve' dhe 'Islami në Ballkan para shekullit XV'. Mbetet që po kjo punë të bëhet edhe për pjesët e tjera të Ballkanit: jugore, jugperëndimore dhe perëndimore, për ta plotësuar përfundimisht këtë temë të vështirë. Përgatitjet janë duke u bërë…!

Për ta bërë librin më komunikues me lexuesin, përveç shënimeve në fund të çdo faqeje, veçan kemi dhënë



Copyrighted material

edhe Literaturën, Treguesin e emrave dhe përmbledhjen anglisht.

Në fund, tërë kjo punë do të ishte e pamundur pa ndihmën e Allahut të lartësuar – vetëm Atij i takon falënderimi dhe lavdia!

Ndihmë të madhe dhe kurajo në momentet më të rënda, po ashtu, më ofroi bashkëshortja ime, pastaj drejtori i Logos-A në Shkup z. Adnan Ismaili, i cili fotokopjoi materiale të nevojshme nga veprat kroate të sh. XIX të F. Raçkit dhe V. Klaiçit, z. Muhdin Ahmeti - përfaqësues i shoqatës Convoy of Mercy në Prizren, i cili më mundësoi shfrytëzimin e Encyclopaedia Britannica, I-XXIII, recensentët, lektori dhe natyrisht botuesi-sponsoruesi, që siguroi mjetet për daljen në dritë të librit.

Vetëm Allahut i përket dija absolute!

Përfundoi për bajram të kurbanit 1422/25. 02. 2002, Prizren.

*N. Ibrahimi*



Copyrighted material

Copyrighted material

# Islami dhe muslimanët në Bullgarinë mesjetare (shekujt IX – XI)

## Hyrje

Nëse e pranojmë si të saktë periodizimin e historisë që e ofron evropocentrizmi[1], se Mesjeta kryesisht fillon e mbaron ndërmjet shekujve V e XV, atëherë shenjat dhe gjurmët e para historike e materiale të kulturës e qytetërimit islam në Ballkan, sidomos në trojet iliro-shqiptare, shpien në periudhën kur popujt e sllavëve të jugut ende i përkisnin besimit të tyre sllav, kurse ilirët gjendeshin ndërmjet qëndresës së fuqishme në pjesët rurale dhe përqafimit të ngadalshëm të kristianizmit greko-bizantino-romak në pjesët urbane. Shkencëtari boshnjak M. Haxhijahiq, kur e trajton këtë çështje, pohon se "*shfaqja e Kristianizmit te sllavët e jugut, ose te pjesa më e madhe e tyre, nuk është më e vjetër nga shfaqja e Islamit.*"[2]

---

[1] Periodizimi i këtillë i përgjigjet traditës pagano-kristiane evropiane dhe pa dyshim është i gabueshëm. Shih: Muhammed Umhazun, *Dirasa et-tarih'il-islamijj*, Rijad, botimi I, 1416 apo përkthimin boshnjak: Muhammed Umhazun. *Koncept izucavanja islamske historije*, botimi I, Sarajevë, 2000, fq. 5 - 88.

[2] Shih: Muhammed Hadzijahic e të tjerë, *Islam i Muslimani u Bosni i Hercegovini*, Sarajevë, 1977, fq. 20; Muhammed Hadzijahic, *Neki pojavni oblici Islamske civilizacije u nas*, Argumenti – Casopis za drustvenu teoriju i praksu, nr.2 / 1982, Rijekë, fq. 212; dhe shkrimet tona: *Islami në Ballkan para shekullit XV*, botimi II, Prizren, 2000, dhe *Islami në trojet iliro-shqiptare gjatë shekujve*, botimi III, Prishtinë, 2000.



Copyrighted material

Në kontaktet dhe bashkekzistencën e hershme të popujve ballkanikë me popujt muslimanë vendimtare ishin kushtet natyrore–gjeografike të Ballkanit dhe trojeve iliro-shqiptare. Rrugët tokësore e detare transballkanike gjatë mijëvjeçarëve çonin për Azi e Afrikë, dhe mundësonin fërkime dhe bashkekzistencë politike, ekonomike, tregtare, ushtarake, por edhe kulturore - filozofike.[3]

Në këtë pikëpamje duhet kuptuar edhe prania e Islamit dhe e të muslimanëve në Ballkan e në trojet iliro-shqiptare veçan.

Kjo temë deri tash vetëm fragmentarisht është trajtuar në literaturën e huaj, kurse në atë shqiptare është shpërfillur tërësisht, është e paprekur.[4] Është detyrë e ngutshme e institucioneve shkencore dhe e individëve që në të ardhmen Mesjetës t'i përkushtohen të liruar nga prangat dhe shabllonet judeo-kristiane dhe greko-romake, paliane dhe svetosaviane, kryqtare dhe inkuizicionale, karagjorgjiane dhe shënstefaniane. Mos të frikësohemi se hulumtimi i historisë islame ndër ne do të thotë edhe islamizimi ynë.

## I. Prejardhja dhe vendlindja e parë e bullgarëve, vendosja e tyre në Ballkan dhe në trojet iliro-shqiptare

Deri sot shkenca e historisë nuk zotëron të dhëna të sakta mbi prejardhjen e bullgarëve. Hipotezat dhe tezat e ndryshme që qarkullojnë në literaturë duhen pranuar me rezervë, sepse historitë nacionale për arsye tendencioze

---

[3] Marija Gjukanoviq, në: Grup autorësh, *Historia e letërsisë botërore*, vëll. I, Prishtinë, 1989, fq. 190 - 191

[4] Viteve të fundit nga ne dhe nga disa të tjerë kjo temë është prekur me nga disa rreshta, që nuk kanë përmbushur as nevojat më elementare shkencore.



Copyrighted material

të dhënat historike i interpretojnë në përshtatje me politikën aktuale nacionale. Megjithatë, historiani asnjanës jep ndihmesë që të krijohet një pasqyrë më reale.

Bizantologu botëror G. Ostrogorski bullgarët i quan "*popull turk*",[5] kurse historiani anglo-amerikan, N. Malcolm, bullgarët i quan si fis turk,[6] të cilët deri në shekullin VIII - IX ishin turqishtfolës, kur filluan të asimilohen.[7] *Enciklopedia Britanike* bullgarët i quan "racë turaniane me prejardhje hune-avare."[8] Edhe shkencëtari boshnjak A. Hukiq bullgarët i quan fis turko-tatar, për të shtuar se janë "pasardhës të drejtpërdrejtë të Hunëve, të cilët pas migrimeve të mëdha pas shekullit V u ndanë në dy grupe: njëri grup u vendos në Evropën qendrore dhe të mesme, kurse grupi tjetër u vendos rreth lumit Vollga dhe degës së saj Kamu. Aty formuan Bullgarinë Povolliane. Ky grup më vonë, gjatë viteve 921 – 922, e pranoi Islamin.[9]

Në shekullin IV konsiderohet se bullgarët jetonin ndërmjet Uralit dhe Vollgës, që në vitin 433 të ndahen në dy grupe: 1) Grupi i Utigurit dhe 2) Kutriguri. Grupi i Utigurit pas njëqind vitesh formoi një shtet të fortë në veri të Detit të Zi, të cilin në vitin 560 e shkatërruan avarët. Por në vitin 582 Utiguri formoi shtetin e tij në Vollga.

Nuk kemi të dhëna të sakta mbi vendin e prejardhjes së tyre, por supozojmë se ky duhet kërkuar në vendlindjen edhe të vetë turqve.

---

[5] Georges Ostrogorski, *Historia e Perandorisë Bizantine*, Tiranë, 1997, fq. 83.

[6] Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, botimi II, Prishtinë – Tiranë, 2001, fq. 23.

[7] Runciman, *Bulgarian Empire*, fq. 93, sipas: N. Malcolm, op. cit., fq. 377, shënimi 3. Kurse A. K. Bogdan bullgarët i quan përzierje të fiseve "Bullgare-Turke-Ugrike" të sllavizuara, që në trojet trako-ilire u vendosën në fund të shekullit VI. A. K. Bogdan, *Historia e shqiptarëve nga Ilirët e lashtë në erën e Islamit*, në: *Univers* – revistë shkencore kulturore, Nr. 1/2001, Tiranë, fq. 54.

[8] Encyclopaedia Britannica, LTD, vol. IV, fq. 359.

[9] Abdurrahman Hukic, *Arapi i Islam u Evropi*, Glasnik VIS-a, Sarajevë, nr. 4-6, 1961, fq. 152.



Copyrighted material

Sipas veprës *"Risaletu Ibn Fadlan"* të udhëpërshkruesit musliman Ahmed Ibn Fadlanit, në veri të lumit Vollga (ai e quan Itl) gjendej një qytet me po këtë emër me banorë, sipas tij, sllavë, që quhej Bullgar, thuajse çdo herë i mbuluar me borë, me shtëpi prej druri. Mes'udi, udhëpërshkrues tjetër musliman, pohon se Bullgarinë e banonin bullgarët dhe se ky vend gjendet përreth Detit të Zi.[10]

Rreth kohës së vendosjes së bullgarëve në Ballkan dhe në trojet iliro-shqiptare ka mendime të ndryshme. Mirëpo, do të vëmë re se *"bullgarët si fis turk kishin filluar të plaçkisnin në Ballkan në fund të shekullit V, duke mos lënë gjurmë më të thella."*[11] Sipas D'Angely, prej vitit 534 deri 562 *"Iliria përjetoi pushtimet e sllavëve, bullgarëve dhe hunëve"*[12], që atëherë, pas ndarjes së Perandorisë Romake në dy pjesë më 395, i takonte ritit bizantin.[13]

Sipas shkencëtarit çek, F. Dvornik, *"sllavët, avarët dhe bullgarët e filluan vendosjen e tyre në Ballkan nga fundi i shekullit VI."*[14] Është interesante të thuhet se sllavët nuk kishin ushtri të veten, ndonëse numerikisht ishin tejet shumë. Ushtrinë e zotëronin avarët, të cilët popullin sllav e përdornin për ushtri. Pas vitit 580, avarët dhe sllavët, duke vrarë, plaçkitur e djegur disa vite rresht, filluan sllavizimin e Ballkanit. Sidomos, sulmet e furishme të hordhive avare, sllave e bullgare, pas vitit 617, Ilirinë, Trakinë dhe Epirin i zhytën në gjak … Mendohet se si viktima e skllevër ranë mbi 200.000 njerëz.[15] Natyrën e pushtimeve të Ballkanit nga ana e avarëve, sllavëve dhe bullgarëve

---

[10] Sipas: H. Mehmed Handzic, *Teme iz opce i kulturne historije*, vëllimi II, Sarajevë, 1999, fq. 100. Shih: Jakut, *Mu'xhem'ul-buldan*, I, fq. 379 dhe II, fq. 379, Kajro, 1907, sipas: Mustafa Busuladzic, *Muslimani u Rusiji*, Sarajevë, 1996, botim reprint i vitit 1943, fq. 11.

[11] N. Malcolm, op. cit., fq. 23.

[12] Robert d'Angely, *Enigma nga Pellazgët te shqiptarët*, Tiranë, 1988, fq. 237.

[13] Blerim Çela, *Shqiptarët ndër shekuj*, Tiranë, 2001, fq. 115.

[14] Sipas: B. Çela, op. cit., fq. 115.

[15] B. Çela, op. cit., fq. 116.



Copyrighted material

e përshkruan F. Dvornik: "*E gjith kjo organizatë kishtare bashkë me shum monumente të kulturës kristiane u çdukën kudo që shkeli kamba sllave. Për gati një shekull i gjith gadishulli i Ballkanit u zhytën në gjak dhe në zjarr dhe shumë qytete të lasht dhe të lulëzuara u bënë hi e pluhur.*"[16] Pas vendosjes së sllavëve, avarëve dhe bullgarëve në Ballkan, popullsia në Iliri e përreth "*për një kohë të gjatë ishte larguar nga krishterimi* (bizantin, N. Ibrahimi). *Dhuna e ushtruar nga pushtuesit, djegia dhe rrënimi i çdo gjëje mbi tokë bëri që "ndërtesa kishtare të asaj kohe* (shekullit VII, N. Ibrahimi) *më nuk ka.*"[17]

Kah fundi i shekullit VII, përkatësisht në vitin 679 e pas, bullgarët nën udhëheqjen e hanit Asparuh, u shkëputën nga epërsia e avarëve (dhe sllavëve, N. Ibrahimi), por edhe nën presionin e hazarëve, dhe duke e kaluar Danubin, u vendosën në mes Danubit dhe Selanikut, përkatësisht në tokat e Bullgarisë së sotme, duke u pavarësuar nga Bizanti.[18] Mirëpo, pasi bullgarët ishin numerikisht më të vegjël se sllavët, gjuha bullgare filloi të zëvendësohej me atë sllave. Këtë fakt e pohon edhe N. Malcolm, për të theksuar se gjuha bullgare është zhdukur kah gjysma e shekullit IX.[19] Edhe G. Ostrogorski ishte i mendimit se "*vërshimi i popullit turk të bullgarëve në Ballkan është nga mesi i shekullit VII e pas*".[20]

---

[16] F. Dvornik, Les Slaves, Byzance et Rome au IX-eme Siecle, 1926, sipas: Tajar Zavalani, *Histori i Shqipnis*, botimi II, Tiranë, 1998, fq. 80. Shih gjerësisht: Neritan Ceka, *Ilirët*, Tiranë, 2001, fq. 277 (275-278).

[17] Hansjurg Frommer, Die Illyrer, Karlsruhe, 1988, në: *Autoktonia e shqiptarëve në studimet gjermane*, Prishtinë, 1990, fq. 173.

[18] *Encyclopaedia Britannica*, vol. IV, fq.359. B. Cela, op. cit., fq. 126.

G. Castellan pavarësimin bullgar e përshkruan si vijon: "Gjatë gjysmës së dytë të shekullit VII një popull turanian, i afërt me turqit, protobullgarët e detyruan Bizantin ta njihte shtetin e tyre që nga viti 681". Georges Catellan, *Histori e Ballkanit*, Tiranë, (-), fq. 23.

[19] N. Malcolm, op. cit., fq. 377; Barbara Jelavich, *Historia e Ballkanit*, vëllimi I, Tiranë, 1999, fq. 28.

[20] G. Ostrogorski, op. cit., fq. 83.



Copyrighted material

Në fillim të shekullit VIII dyndjet sllave morën fund në Ballkan, duke sjellë ndryshime të mëdha të strukturës etnike të vendeve të Ballkanit. Trakët, banorët e parë të Ballkanit bashkë me Ilirët,[21] u zhdukën krejtësisht duke e formuar Bullgarinë e sotme.[22] Kurse vendbanimet ilire u ngushtuan edhe më tepër dhe popullsia që banonte në vendet, të cilat sot quhen Slloveni, Kroaci, Dalmaci, Bosnje, Serbi, Maqedoni, Mal i Zi u asimiluan krejtësisht duke u sllavizuar ose duke u shfarosur.[23]

Pjesërisht këtij asimilimi apo kësaj shfarosjeje i shpëtuan trojet iliro-shqiptare, dëshmi të së cilës janë shqiptarët e sotëm.[24]

## II. Veprimtaria ushtarake bullgare dhe lëvizjet e tjera në Ballkan dhe në trojet iliro-shqiptare

### A. Veprimtaria ushtarake

Vendosja e bullgarëve në Ballkan e sidomos në trojet iliro-shqiptare kryesisht është kryer nëpërmjet avarëve, si elitë sunduese ushtarake, sllavëve si masë populli në ushtrinë avare dhe të bullgarëve. Këto sulme filluan kah fundi i shekullit V, në mënyrë josistematike, për t'u intensifikuar gjatë shekujve VI e VII.[25] Kah fundi i shekullit

[21] Për këta dy popuj ka të dhëna të mjaftueshme se janë ndër banorët e parë të gadishullit ballkanik. Shih: B. Jelavich, op. cit., fq. 17.
[22] B. Çela, op. cit., fq. 117.
[23] B. Çela, op. cit., fq. 117; Krhs.: T. Zavalani, op. cit., fq. 75.
[24] Shih: Neritan Ceka, *Ilirët*, Tiranë, 2001, fq. 275.
[25] Ibid., fq. 300 – 301.



Copyrighted material

VII (679) hani Asparuh i shkëputi bullgarët nga dominimi avaro-sllav. Ndonëse në fillim sllavët dhe bullgarët dallonin [26] mjaft në gjuhë, në besim dhe në traditat tjera, këto dallime më vonë për shkak të aleancave dhe bashkëpunimeve të tjera, u zvogëluan ndjeshëm. Kjo para së gjithash shfaqet në faktin se bullgarët e harruan gjuhën e tyre me prejardhje turke dhe pranuan sllavishten.

Qoftë në mësymje me synim zgjerimi, qoftë mbrojtje, gjatë disa shekujve bullgarët bënë luftëra të përgjakshme kundër Bizantit, Hungarisë, Rusisë, popullit peçeneg, fiseve të ndryshme dhe popullatës vendëse trakase dhe iliro-shqiptare.[27]

Kështu, më 821 deri 823 bullgarët i gjejmë aktivë në luftërat bizantino-arabe.[28]

Në kufijtë lindorë të Ilirisë patën arritur bullgarët, të cilët synonin zgjerimin e shtetit të tyre. Kështu, gjatë viteve 830 – 880 bullgarët janë tejet agresivë, duke mbjellë tmerr në viset e pushtuara, që deri atëherë i mbante Perandoria Bizantine. Në vitin 851 ata u shtrinë në Maqedoninë qendrore dhe në Shqipërinë e jugut, duke pushtuar Ohrin dhe Devollin.[29]

Deri në vitin 850 bullgarët e pushtuan edhe Kosovën.[30] Kurse gjatë sundimit të Simeonit (sundoi gjatë viteve 893 – 927) kufijtë e shtetit bullgar u zgjeruan edhe në të gjitha tokat shqiptare.[31] Simeoni duke përfituar nga lufta kundër arabëve në Selanik, ku shkoi si ndihmë për

---

[26] G. Ostrogorski, op. cit., fq. 83.

[27] Për luftërat bullgare me hungarezët, rusët, peçenegët, kumanët etj. shih: Encyclopaedia Britannica, vol. V, fq. 359.

[28] Shih gjerësisht: Rade Bozovic, *Arapi u usmenoj narodnoj pesmi u srpskohrvatskom jezickom podrucju*, Beograd, 1977, fq. 176.

[29] Shih: Hansjorg Frommer, Die Illyrer, op. cit., fq. 173; B. Cela, op. cit., fq. 130; Shan Zefi, *Islamizimi i shqiptarëve gjatë shekujve*, Prizren, 2000, fq. 47.

[30] N. Malcolm, op. cit., fq. 27.

[31] Grup autorësh, *Historia e popullit shqiptar*, vëll. I, botimi III, Prishtinë, 1979, fq. 150 – 151.



Copyrighted material

You have either reached a page that is unavailable for viewing or reached your viewing limit for this book.

masovisht në Bullgari e Maqedoni.[37] Konsiderohet se fillimi i tyre në Ballkan zë fill në shekullin VIII, kur paulicianët e Armenisë nga Bizanti qenë transferuar në Traki që t'i mbronin kufijtë kundër Bullgarisë.[38] Nismëtar i bogumilizmit ishte prifti Eremi i quajtur Bogumil, që jetoi në shekullin X. Ky shpalli idetë manikeiste dualiste, duke e quajtur veten kristian të mirë.[39]

Bogumilizmi me doktrinën e tij kundërshtoi katolicizmin dhe ortodoksizmin dhe ishte shumë më afër Islamit dhe monoteizmit të tij. Për këtë arsye, bogumilizmi u ndoq rreptë nga Bizanti, Bullgaria, pastaj nga Serbia etj. Në pamundësi veprimi, bogumilët filluan lëvizjet e tyre nëpër trojet iliro-shqiptare për t'u vendosur në shekullin XII në Bosnjë.[40] Më vonë, në shekullin XIII bogumilizmi u bë fe zyrtare e shtetit në Bosnjë, kur mbreti Kulin ban, me dekret të vetin, lëkundjet ndërmjet katolicizmit romak e ortodoksizmit greko-bizantin, e stabilizoi Kishën boshnjake bogumile,[41] kurse me ardhjen e osmanlinjve në Bosnjë, populli boshnjak e pranoi Islamin me vetëdëshirë, pa rezistencë, sikur edhe shqiptarët.[42]

Do të pranojmë se kalimi i bogumilëve nga Lindja në Bullgari, e pastaj në Serbi e trojet iliro-shqiptare nuk ishte pa ndikim te shqiptarët. Gjithashtu, pos asaj që doktrina bogumiliste ishte më afër Islamit se kristianizmit, ata u ndikuan drejtpërdrejt nga mësimet islame edhe gjatë qëndrimit të tyre në Bullgari, në trojet iliro-shqiptare e të tjera, nga Sari Salltëku, peçenegët, turqit vardariot, muslimanët e Panonisë etj. Këta edhe ishin disa nga faktorët e

---

[37] G. Ostrogorski, op. cit., fq. 182

[38] Shan Zefi, *Islamizimi i shqiptarëve gjatë shekujve*, Prizren, 2000, fq. 93.

[39] V. Klaic, op. cit., fq. 347; Sh. Zefi, Op. cit., fq. 92.

[40] V. Klaic, op. cit., fq. 347; Suljaga Saliagic, *Mi bosansko-hercegovacki muslimani u krilu jugoslovenske zajednice*, Banja Luka, 1940, fq. 9; Sh. Zefi, op. cit., fq. 93; Dh. Shuteriqi, *Gjurmime letrare*, Tiranë, 1974, fq. 24… .

[41] V. Klaic, op. cit., fq. 347; Sh. Zefi, op. cit., fq.93.

[42] Grup autorësh, *Rreth përhapjes së islamit te shqiptarët*, botimi II, Prizren, 2001.



Copyrighted material

jashtëm që Islami në kohën e osmanlinjve u përqafua nga shqiptarët vullnetarisht dhe pa përplasje të mëdha.[43]

2. Peçenegët. - Fërkimet e para të peçenegëve[44] me bullgarët i hasim në shekullin IX e pas. Këto fërkime disashekullore ndikuan te bullgarët që të njihen me mësimet islame, krahas njoftimeve që kishin për Islamin nga periudha e parakristianizmit më 856, kur hani bullgar Borisi personalisht e pranoi kristianizmin ortodoks dhe filloi pagëzimin e popullsisë vendëse. Peçenegët herë-herë në aleancë me bullgarët, e herë-herë në armiqësi me ta, por edhe në Perandorinë Bullgare për disa shekuj ndikuan që "arsimimin e tyre të shkëlqyeshëm" arabo-islam ta bartin në tërë Ballkanin dhe trojet iliro-shqiptare.[45]

3. Sari Salltëku. - Paraqitja e Sari Salltëkut në skenën historike dhe lëvizjet e tyre misionariste paraqesin faktin me rëndësi në përhapjen e Islamit ndër bizantinët, bullgarët, hungarezët dhe trojet iliro-shqiptare në shekullin XIII e XIV, në kohën kur shtetet e atëhershme evroballkanike ndërmerrnin të gjitha masat për çrrënjosjen e pikëpamjeve heretike.[46]

Nga Buhara, nëpër Anadoll, që pas vitit 1241 Sari Salltëku dhe ithtarët e tij të shumtë vendosen në Dobruxhë të Bullgarisë/Rumanisë, atëbotë territor bizantin.[47]

---

[43] Shih: Th. W. Arnold, *Povijest islama*, Sarajevë, 1990 (apo përkthimi shqip në dorëshkrim: Historia e përhapjes së Islamit); N. Ibrahimi, *Islami në trojet iliro-shqiptare gjatë shekujve*, botimi III, Prishtinë, 2000.

[44] Gjerësisht për peçenegët: N. Ibrahimi, Prejardhja dhe vendosja e peçenegëve në trojet iliro-shqiptare e në Ballkan dhe roli i tyre në përhapjen e islamit në këto troje, *Edukata islame*, nr. 65/2001, Prishtinë, fq.57 - 76.

[45] Rade Bozovic, *op. cit.*, fq. 183 etj.; Muhammed Hadzijahic, *Islam i muslimani*, op. cit., fq 26 etj.

[46] Kemal H. Karpat, Gradjanska prava muslimana Ballkana, në: *Muslimani Balkana – Istocno pitanje u XX veku*, Tuzla, 2001, fq.96; Skender Rizaj, *Shqiptarët dhe Serbët në Kosovë*, Prishtinë, 1991, fq. 49. G. & J. Testas, Inkvizicija, Zagreb, 1982, fq. 8.

[47] Halil Inalxhik, Perandoria osmane –1300 – 1600, Shkup, 1995, fq. 269 – 270; Dzemal Cehajic, *Derviski redovi u jugoslovenskim zemljama*, Sarajevë, 1986,



Copyrighted material

Prej Dobruxhës, Sari Salltëku dhe ithtarët e tij lëvizën në drejtime të ndryshme. Gjurmët materiale, toponimia dhe legjendat e shumta dëftojnë se ai ishte në misione fetare e ushtarake në Panoni, Hungari, Çeki, Sllovaki, Shkup, Srem, Maçvë, Bosnje, Krujë, Durrës, Opojë, Pejë, Gjallicë të Gjakovës, Prilep të Deçanit, Shën Naum të Ohrit, etj.[48]

Këta tre shembuj (bogumilët, peçenegët, Sari Salltëku) nuk janë të vetmit, por janë shembuj domethënës për ta pasqyruar sado pak më realisht gjendjen politike, fetare, sociale e kulturore në Bullgari dhe në trojet iliro-shqiptare, para kristianizimit të Bullgarisë, gjatë kristianizimit dhe pas përfundimit të procesit të kristianizmit.

## III. Gjendja shpirtërore e bullgarëve para kristianizimit të tyre

### A. Gjendja e përgjithshme shpirtërore

Gjendja shpirtërore në Bullgari dhe në trojet iliro-shqiptare në periudhën historike të problematizuar ishte e përcaktuar nga faktori ushtarak, politik e ekonomik. Romakët, gotët, anzhuinët, sllavët, avarët, peçenegët, bullgarët dhe popullësia vendëse e Evropës ishin në konflikte reciproke të vazhdueshme, madje në shfarosje. Trakët, peçenegët dhe pjesërisht iliro-shqiptarët janë shembuj tipikë të mbijetimit të popullit më elastik, të fortë e të zhdërvjelltë.

fq. 101. Shënimet historike tregojnë se me Sari Salltëkun janë shpërngulur disa dhjetëra mijëra njerëz të vendosur në 12.000 tenda. Sipas: Grup autorësh, *Muslimani Balkana*, op. cit., fq. 96.

[48] Shih gjerësisht: N. Ibrahimi, *Sari Saltuku dhe roli i tij në përhapjen e islamit në trojet ilir-shqiptare e ballkanike para shekullit XIV*, në: Edukata islame, revistë shkencore, kulturore, islame tremujore, Prishtinë, nr. 66 / 2002, fq. 115 - 131.



Copyrighted material

Kristianizimi i tipit katolik e ortodoks gjatë shekujve gjithnjë e më shumë institucionalizohej. Rezistenca e besimeve të lashta gjithnjë e më tepër dobësohej nga mësymja shfarosëse e romakëve, bizantinëve, pastaj e sllavëve etj.[49]

Në letrat shqipe ekzistojnë supozime, asnjëherë historikisht të argumentuara, se shqiptarët u kristianizuan menjëherë pas vdekjes (sic!) të Jezusit, drejtpërdrejt nga Pali. Përpjekjet që kjo "e vërtetë" të plasohet si e vërtetë janë të paqëndrueshme.[50]

Kristianizimi i Evropës dhe Ballkanit vërtet filloi herët individualisht e ilegalisht, që të intensifikohet në shekullin IV, kurse për të marrë hovë në shekullin IX e për të përfunduar në fund të shekullit XIII. J. Le Goff pohon se *"Kristianizimi në Rusi, Ukrainë dhe Ballkan në shekullin X, XI e XII është proces i hapur"*, për të vazhduar se në këto troje *"shpesh revoltat pagane dyfishoheshin, shndërroheshin në kryengritje shoqërore, kurse masat ktheheshin në paganizëm, sepse kristianizmi mesjetar është nga lart dhe me zor."*[51]

Në këtë gjendje politike, ushtarake dhe ekonomike gjendja shpirtërore e popujve ishte e ndrydhur nga pushtuesit dhe sunduesit e ndryshëm fillimisht paganë e më vonë kristianë. Shembulli i fesë islame dhe i muslimanëve në Perandorinë Bullgare ende të pakristianizuar dhe më pastaj të kristianizuar është domethënës për një pasqyrë të gjendjes shpirtërore në këto troje në këtë periudhë historike.

---

[49] Naser Ferri, *Latronët – lëvizje e rezistencës kundër romanizimit*, Bujku – e përditshme e dt. 23. 11. 1996, Prishtinë, fq. 13. N. Ibrahimi, *Islami në trojet iliro-shqiptare gjatë shekujve*, op,. cit., fq. 179 – 216.

[50] N. Ibrahimi, *Islami në trojet iliro-shqiptare gjatë shekujve*, op. cit.
I këtillë është edhe konstatimi se "në trevën e Kosovës kemi vetëm procesin e krishterizimit të përfunduar në antikitetin e vonshëm…" Muhamet Tërnava, *Studime për Mesjetën*, Pejë, 2000, fq. 265. Shih edhe: Shyqri Nimani, *Trojet shqiptare në harta dhe stema ndër shekuj*, Prishtinë, 1996, fq. 18 etj.

[51] J. Le Goff, *Qytetërimi i Perëndimit Mesjetar*, Tiranë, 1997, fq. 182 – 183.



Copyrighted material

## B. Islami dhe muslimanët në Perandorinë mesjetare Bullgare parakristiane dhe kristiane

Nuk zotërojmë të dhëna të përpikta se prej kur janë vendosur Islami dhe muslimanët në trojet e Perandorisë mesjetare Bullgare, që atëherë shtrihej në pjesën më të madhe të trojeve iliro-shqiptare, por mbetet e sigurtë që prania Islamo-muslimane është e dukshme qysh në shekullin IX, disa dekada para kristianizimit të bullgarëve. Sigurisht se rol me rëndësi kanë luajtur tregtarët, misionarët, migrimet e dhunshme dhe ato ekonomike etj.[52] Këtë temë orientalisti serb R. Bozhoviq e përkufizon në një mënyrë që praninë Islamo-muslimane në këto troje e sheh kryesisht *"nëpërmjet Bizantit, nëpërmjet pellgut të Mesdheut: Spanjës, Egjiptit fatimit dhe Sicilisë, nëpërmjet Hungarisë, apo veriut dhe luftëtarëve nomadë të peçenegëve"*.[53]

Disa burime qartazi flasin se në fillim të shekullit IX në Perandorinë Bullgare dhe vendet fqinje muslimanët ekzistonin masivisht, me një kulturë të lartë fetare, kulturore, por edhe të banimit, ushqimit etj. Historiani i vjetër kroat V. Klaiq pohon se në Bullgari dhe në vendet fqinje ka pasur muslimanë.[54] Historiani e teologu kroat i shek. XIX F. Raçki pohon se *"tregohet se arabët, duke shpërndarë libra, kanë përhapur islamin..."*.[55] Edhe Llujo Taller në librin e tij "Nga fallxhorët e magjistarët deri te mjeku modern" thekson se në këtë kohë Bullgaria ishte përplot muslimanë dhe se njëherë bullgarët madje i kanë djegur librat muslimanë në Bullgari.[56]

---

52 N. Ibrahimi, *Islami në Ballkan para shekullit XV*, botimi II, Prizren, 2000, fq. 17 – 37 dhe 43 – 77.
53 R. Bozovic, op. cit., fq. 176.
54 V. Klaic, op. cit., fq. 347.
55 Franjo Racki, *Bogumili i patareni*, fq. 350, sipas: Mehmed Handzic, *Islamizacija Bosne i Hercegovine i poreklo bosansko-hercegovackih muslimana*, Sarajevë, 1940, fq. 13.
56 Franjo Racki, op. cit., fq. 350. Shih: Mustafa Spahic, *Povijest islama*, 4, Sarajevë, 2000, fq. 136.



Copyrighted material

Tashmë pamë se bullgarët dhe Bullgaria, që në shekullin IX kapte pos Bullgarisë së sotme edhe trojet iliro-shqiptare,[57] ishin përplot libra muslimanë (saracenë), mirëpo ndonëse Franjo Raçki thekson se arabët ishin ata që i sollën dhe i përhapën librat, nuk kemi hasur në të dhëna se në cilat gjuhë ishin librat saracenë (muslimanë) në Bullgari, sepse po të ishin në arabishte nuk shohim ndonjë rrezik për bullgarët dhe kristianizmin e tyre të ri dhe për vetë Borisin. Ka gjasë që këta libra të kenë qenë në gjuhën e popullit, e mbase me shkronja arabe[58], që për bullgarët do të ishte rrezik më i madh [59] se sa librat islame në gjuhën arabe që pakkush i kuptonte nga populli.

Për muslimanët në Bullgari në pjesën e parë të shekullit IX është ruajtur dëshmi e dorës së parë në Arkivin e Vatikanit, në kreun CIII të letrës së njohur të papës 113 Shën Nikolla I i Madh (që sundoi gjatë viteve 858 – 867[60], me titullin "*Response Nicollai I Papae ad consulata Bulgarorum*", ku thotë:

"*De Ibieris profanis, quos a Saaracenis vos abstalisse ac apud vos habere perhibetis, quind facienden sit, in quiritis. Qui nimirund non sunt reservandi: 'Carrumpumt' enim, siont soriptum est 'mores bonos colloquia male', sed utpate noxii et blas phemi ignitradendi*".

"*Ju pyetni ç'duhet bërë me librat heretikë, të cilët pohoni, gjenden te ju, kurse i keni marrë nga saracenët. Ata, natyrisht, nuk duhet ruajtur, sepse sikur që është e shkruar (në Enciklikën*

---

57 Shaban Demiraj, *Gjuhësi ballkanike*, Shkup, 1994, fq. 194; Muhamet Tërnava, *Popullësia e Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI*, Prishtinë, 1995, fq. 20.

58 Kjo nuk është e pamundur kur dimë se edhe polakët që pranuan Islamin në mesjetë në shekullin XIII përdornin shkronjat arabe edhe për gjuhën amtare polake, sikur që boshnjakët më vonë përdornin bosnjishten (bosançicën) apo shqiptarët alfabetin e adaptuar arab. Shih: A. Hukic, *Arapi i islam u Evropi*, Glasnik VIS-a, Sarajevë, nr. 7-9, 1961, fq.280.

59 Muhamet Hadzijahic, *Islam i Muslimani*, op. cit., fq. 22.

60 Zef Mirdita, *Krishtenizmi ndër shqiptarë*, Prizren – Zagreb, 1998, fq. 438.



Copyrighted material

*mbi Korintasit), kuvendimet e këqija prishin moralin e shëndoshë, e për këtë si të dëmshme dhe heretike dorëzoni zjarrit.*" [61]

Nga përgjigjja e papës drejtuar Borisit duket qartë se bullgarët, përkatësisht hani Borisi, në hamendjet e tij më tepër politike ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, në këtë periudhë iu drejtua papës së Vatikanit për këshillë se si të veprojë me librat saracenë (d.m.th. muslimanë) pas kristianizimit të muslimanëve dhe të tjerëve në Bullgari. Këtë ndodhi e regjistrojnë si burimet muslimane, ashtu edhe ato jomuslimane.[62]

Përkundër kristianizimit të muslimanëve me dhunë në Bullgari, një pjesë e muslimanëve vazhduan të jetojnë në këto dhe trojet përreth.[63] Prania e peçenegëve, e ithtarëve të Sari Salltëkut dhe muslimanët vendas janë argumenti më i fuqishëm për pohimin tonë se Islami vazhdoi të jetojë.

Historiani e udhëpërshkruesi musliman Jakut el-Hamewiu shënon se në vitin 922 / 309 hixhri, i dërguari i mbretit bullgar e njoftoi kalifin abasid në Bagdad, El-Muktedir Bil-Lah, për pranimin e Islamit nga ana e mbretit dhe e familjes së tij.[64]

Ndonëse me ndryshime tejet të vogla, po këtë ndodhi e hasim edhe te udhëpërshkruesi i njohur musliman

---

[61] Citati në origjinal dhe përkthimi i tij janë sipas: Muhamed Hadzijahic, *Islam i Muslimani*, op. cit., fq. 22.

[62] Shih: *Enciklopedija živih religija*, Beograd, 1990, fq. 132; Georges Castellan, *Histori e Ballkanit*, Tiranë, (1996), fq. 39-40; Miroslav Brandt, *Srednjovjekovno doba povijesnog razvitka*, vëllimi I, Zagreb, 1980, fq. 345; Dhori Qiriazi, *Krishterimi i Shqipërisë*, Tiranë, 2000, fq. 55; Rade Bozovic, op. cit., fq, 178; Hansjorg Frommer, *Die Illyrer*, Karlruhe, 1988, në: *Autoktonia e shqiptarëve në studimet gjermane*, Prishtinë, 1990, fq. 178; G. Ostrogorski, op. cit., fq. 162 etj.

[63] Ka mendime se një pjesë e Bullgarëve Povollian mbetën në Bullgari, por një pjesë migroi këtë kohë por sidomos rreth vitit 1238, duke ikur para sulmeve të furishme të ushtrisë së Xhingiz-hanit. Një pjesë e tyre u vendos në Hungari, një pjesë në Finlandë dhe në pjesët e tjera më të qeta. Shih: A. Hukic, nr. 4-6/1961, op. cit., 152 dhe 281.

[64] Jakut el-Hamewiu, *Mu'xhem'ul-Buldan*, Kairo, 1323 /1906, fq. 486 – 487, sipas: F. Rexhepi, *Kultura arabo-islame në Ballkan para ardhjes së turqve*, Dituria islame, nr. 76/1996, Prishtinë, fq. 36.



Copyrighted material

Ibn Fadlan, i cili njofton se gjatë kohës së sundimit të halifit El-Muktedir Bil-lah (295-320 hixhrij / 907-932) arriti një i deleguar nga qyteti i bullgarëve dhe njoftoi se sunduesi sllav[65] me emrin Bulutvar (në disa burime me emrin Allmas) ka përqafuar Islamin dhe se kërkon dikë që do t'ia mësojë atij dhe të tjerëve këtë fe. Halifi El-Muktedir e përgatiti dhe e dërgoi një delegacion me dhurata, kurse shkresën ia dorëzoi Ibn Fadlanit. Ibn Fadlani e përshkroi udhëtimin e tij, por ky udhëpërshkrim humbi, pos disa fragmenteve. Këto fragmente rusët në Petrograd më 1823 i botuan në origjinal e përkthim.[66] Ibn Fadlani përshkruan sunduesin bullgar Bulutvarin se si e priti dhe gostiti, se si e mori emrin Xhafer, ai përshkruan ushqimet dhe pijet, traditat e tyre etj.[67]

Një burim tjetër sunduesin bullgar Bulutvarin dhe popullin e tij e vendos përbri Vollgës. Rreth qytetit bullgar jetonin fise që merreshin me gjueti, kurse banorët e tyre, bullgarët povollian, duke falënderuar sunduesin e tyre Allmasi (në burimet tjera Bulutvari) e pranuan islamin. Me kërkesë të Allmasin, halifi abasid El-Muktedir Bil-lah i dërgoi dijetarët e tij në Bullgarinë Povolliane me qëllim që të përhapet Islami. Më vonë shtatë dijetarë nga këta do të shkojnë në Hungari dhe në Evropën e mesme për ta përhapur Islamin.[68]

---

[65] Ibn Fadlani nuk e bën dallimin ndërmjet sllavëve dhe bullgarëve.

[66] Sipas: H. Mehmed Handzic, *Teme iz opce i kulturne historije*, op. cit., fq. 101.

[67] Ibid., fq. 101 – 102.

[68] Sipas: T. O. Tarhani, *Neki spomenici islamske kulture u Madzarskoj, Islamska misao*, nr. 43/1982, Sarajevë, fq. 43.

A. Hukiq pohon se "sunduesi i bullgarëve povollianë Almasi i dërgoi dhurata të çmueshme halifit El-Muktedir Bil-lahit, pasi e pranoi Islamin dhe një shkresë në të cilën kërkoi t'i dërgohen njerëz të ditur. El-Muktediri e dërgoi një delegacion në krye me Ahmed ibn Fadlanin. Ibn Fadlani pos tjerash shkroi udhëpërshkrimin e tij, ku përshkroi Bullgarinë, Bashkirinë, vise të detit Kaspik etj. A. Hukic, op. cit., fq. 152.



Copyrighted material

Praninë e Islamit në Bullgari e vërejmë edhe në burimet e tjera, pravosllave. Në vitin 896/376 hixhri në Kiev të Ukrainës, shkoi një i deleguar musliman ta përvetësojë Shën Vlladimirin, mbretin e Ukrainës, që ta përqafojë Islamin. Pasi ai ishte ende në besimin e tij të vjetër sllav, i ftoi teologët muslimanë bullgarë të Vollgës që t'i paraqesin themelet e besimit të tyre. Vlladimiri edhe vetë merrte pjesë në diskutime shkencore.[69]

Vetë Vlladimiri këtë ndodhi e përshkruan në mënyrën vijuese: "Ja, erdhën bullgarët duke më thënë: prano ligjin tonë (Islamin, N. Ibrahimi). Pastaj erdhën gjermanët duke e lavdëruar ligjin e vet. Pas tyre erdhën hebraikët. Më në fund erdhën grekët, të cilët i kritikuan të gjitha fetë pos të tyres… Këshilltarët më thanë: *"Ti e di, o sundues se askush nuk e qorton atë që është e tij, por përkundrazi, vetëm e lavdërojnë. Nëse dëshiron me kujdes të njoftohesh, dërgoji disa nga njerëzit e tu që t'i studiojnë traditat e ndryshme fetare dhe të shohin se si disa popuj e lavdërojnë Zotin."*[70]

Nga burimi tjetër, nga kronika mesjetare ruse *'Povest vremenih leta'* e shekullit XI, lexojmë se Vlladimiri pas takimit me shumë delegacione të feve të ndryshme, e dërgoi një delegacion për t'i vizituar disa qendra, për ta verifikuar besimin e tyre. Pas kthimit të delegacionit, ata pohuan: *"Erdhëm në Bullgari dhe pamë se si luten ata në tempull, përkatësisht në xhami…"*. Këto deklarata ata i dhanë në vitin 6495 sipas kalendarit të tyre rus, përkatësisht në vitin 987 sipas kalendarit gregorian.[71]

---

[69] M. Hadzijahic, *Islam i Muslimani,* op. cit., fq. 21 – 22.
Për bullgarët povollianë apo vollgianë, të grupit të Utigurit mendohet se fillimisht ishin politeistë, por shumë herët, në vitin 900, e pranuan islamin, që sigurisht ka të bëjë me Allmasin apo Bulutvarin. Shih: *Encyclopaedia Britannica*, vol. IV, fq. 359.

[70] Chronique dite de Nestor, ann. 987, XLI, Paris, 1884, sipas: Marko Susnjic, *Hrestomatija izvora za opstu istoriju srednjeg vijeka*, Sarajevë, 1980, fq. 355.

[71] Shih: Pamjatniki literatury drevnei Rusi: XI – nacelo XII v. fq. 123 – 125, sipas: Shkëlzen Maliqi, *Vizantijski kulturni areal,* Thema, 4(3), 1985, Prishtinë, fq. 20 – 31, shënimi 3.



Copyrighted material

Nga të gjitha të cekurat rezulton se në këto vise ka pasur vendbanime masive muslimane, pos tjerash edhe xhami të shumta, që janë argument i fuqishëm se Islami ishte fe më e hershme te banorët vendorë të pjesës më të madhe të Evropës juglindore, përkatësisht të Ballkanit qendror e lindor.

## C. Kristianizimi i bullgarëve në mesjetë

Pavarësimi politik i bullgarëve nga Bizanti në fund të shekullit VII (679 e pas), asimilimi gjuhësor i tyre duke e harruar gjuhën me prejardhje turke, por duke e pranuar sllavishten nga populli sllav, numerikisht më i madh, dhe zgjerimi i shtetit bullgar në të gjitha anët, Bullgarinë e bëri faktor në rajon. Njëkohësisht, krahas fërkimeve politiko-ushtarake, Bullgaria filloi fërkimet intensive edhe në rrafshin shpirtëror, kryesisht ndërmjet Papatit dhe Bizantit, që ishte karakteristik edhe për popujt e tjerë përreth (serbët, maqedonët, rumunët e rusët) në shekullin IX – X.[72]

Atë kohë mbi Bullgarinë sundonte hani Borisi (852 – 889). Për shkak të konflikteve me Bizantin, hani bullgar Borisi vendosi që kristianizmin ta pranonte nga frankët, d.m.th. nga Roma. Mirëpo, me të kuptuar këtë, ndërhyri Bizanti si në tokë ashtu edhe në det, duke e detyruar

[72] Sipas A. Gams, serbët, maqedonët, bullgarët, rumunët dhe rusët pranuan pravosllavljen bizantine prej shekullit VIII deri në shekullin X. Shih: Andrija Gams, *Biblija i drustvo*, Novi Sad, 1979, fq. 269.
J. Le Goff procesin e kristianizmit në Evropë të filluar më herët e sheh si proces të hapur që mori fund vetëm në fund të shekullit XIII, të imponuar me dhunë nga perandoritë apo shtetet në formim e zgjerim e sipër. J. Le Goff, op. cit., fq. 182 – 183.
Edhe M. Tërnava është i mendimit se fillimi i procesit të kristianizimit të sllavëve kishte filluar nga fundi i shekullit IX e tutje. Muhamet Tërnava, *Studime për Mesjetën*, op. cit., fq. 10.



Copyrighted material

Borisin që kristianizmin ta pranonte nga Bizanti.[73] Sipas G. Castellan, Borisi e pranoi kristianizmin më 864 nga duart e priftërinjve bizantinë, duke e vënë shtetin e vet nën juridiksionin e patrikut bizantin Fotit.[74] Me këtë rast Borisi u pagëzua me emrin Mihajli III. Kurse Mihajli III, si shpërblim për veprimin e Borisit, e ia kaloi Borisi sundimin suprem mbi pjesët veriperëndimore të Maqedonisë dhe mbi pjesët jugore të Shqipërisë dhe njëherit, gjatë kungimit të Borisit, Mihajli III – perandori bizantin, u bë kumbar i Borisit.[75]

B. Jelavich luhatjet e Borisit ndërmjet Romës dhe Bizantit, përkatësisht njohjen e juridiksionit të Romës fillimisht dhe braktisjen e saj i sheh si veprim politik.[76]

---

[73] M. Brandt, op. cit., fq. 348.

[74] Georges Castellan, *Histori e Ballkanit*, Tiranë, (-), fq. 39.
Në literaturën shkencore historike qarkullojnë disa data të kalimit të hanit bullgar Borisit në kristianizëm. Mendojmë se dallimet e vogla më tepër janë çështje të llogaritjes jo të saktë të viteve se sa diç tjetër dhe nuk paraqet problem për historinë. P. sh. B. Jellavich në veprën *Historia e Ballkanit*, I, Tiranë, 1999, faqe 28 pohon se kryqimi ndodhi në vitin 865, kurse *Enciklopedija živih religija*, Beograd, 1990, faqe 132 pohon se kryqimi ndodhi ndërmjet vitit 864/865. G. Ostrogorski, op. cit., fq. 162 mendon se kryqimi ndodhi saktë në vitin 866. Edhe vepra e grupit të autorëve, *Historia e popullit shqiptar*, vëllimi I, botimi III, Prishtinë, 1979, faqe 150, e sigurisht në mbështetje të tij edhe Blerim Cela, op. cit., fq. 130, cekin se kryqimi i hanit bullgar Borisit dhe popullit të tij ndodhi në vitin 866. Shih: Neritan Ceka, op. cit., fq. 162.
Për vendin e pagëzimit të hanit Boris burimet historike janë diç më të varfra, por në mbështetje të disa veprave dhe gjurmëve arkeologjike vërejmë se ky ishte Ballshi në vitin 866. Ballshi sipas arkeologëve dhe historianëve është qyteti Bylisi, në Antikitetin e Vonshëm, apo në fqinjësi të afërt me të, më vonë të quajtur nën ndikimet sllave Gllavinicë, që gjendet në Shqipëri. (Neritan Ceka, op. cit., fq. 247 – 249, 286; 288.). Kjo argumentohet edhe nga një pllakë, rrasë guri me një mbishkrim, i cili u zbulua para Luftës II botërore në gjuhën greke në rrënojat e bazilikës së Ballshit ku lexojmë: *"U pagëzua prijësi i Bullgarisë, Borisi i quajtur Mihal, me popullin e tij të dhënë nga perëndia në vitin 6374 (ky vit sipas kalendarit bizantin tregon krijimin e botës sipas Biblës, e që korrespondon me vitin 866, që normalisht është paradoks, N. Ibrahimi.)"* Sipas: Praschniker C., *Muzakia und Malakastra*, fq. 23; dhe BZHSH, vëllimi II, fq. 29, sipas: Dhori Qiriazi, op. cit., fq. 55. Krhs.: Neritan Ceka, op. cit., fq. 304.

[75] Dragan Tashkovski, *op. cit.*, fq. 35 – 36.

[76] Barbara Jellavich, *Historia e Ballkanit*, I, Tiranë, 1999, fq. 28.



Copyrighted material

Me gjithë ndikimin që kishte Bizanti mbi Borisin bullgar dhe mbështetjen politike dhe ushtarako-ekonomike që u jepte bullgarëve, Borisi gjatë viteve 866 – 869 ishte në bisedime me papën Nikolla I, që Bullgaria të vihet nën ndikimin papnor. Njëherit, Borisi i pengoi klerikët grekë në kristianizmin e bullgarëve, duke marrë premtime nga papa Nikolla I se Bullgaria do të formonte ipeshkvinë e pavarur dhe klerikët romakë do t'i kryqojnë sipas ritit romak. Mirëpo, në Sinodin e vitit 870 u vendos që dioqeza bullgare të varej e administrohej nga Konstantinopoli.[77] Përkundër bashkëpunimit të sërishëm të Kishës bullgare me Bizantin për arsye të ndryshme, Kisha bullgare e ruajti organizimin e vet ekleziastik.[78] Mendojmë se edhe princat lokalë bullgarë ndikuan që Borisi të afrohej kah Bizanti, sepse ata i frikësoheshin afrimit bullgaro-frank.[79] Për më tepër kjo, kur kërkesa e Borisit për autoqefalinë e kishës bullgare drejtuar Romës u refuzua nga papa Nikolla I.[80] Kjo do të arrihet vetëm në kohën e Simeonit, në vitin 925, kur ky formoi patrikanën bullgare.[81] Qendër e patrikanës së re ishte Ohri, i cili në shekullin IX – X, paraqitej si qendër e fuqishme kulturore e fetare, kurse në fund të mbretërimit të car Samuillit kryepeshkopata e Ohrit përfshinte peshkopatën e Shkupit, të Lypjanit dhe ate të Prizrenit.[82]

Kristianizimi i bullgarëve ndikoi në shumë pikëpamje në tërë rajonin, sepse Bizanti u forcua edhe më shumë në Ballkanin qendror,[83] e njëkohësisht kristianizmi shërbeu si

---

77 *Enciklopedija živih religija*, op. cit., fq. 132; M. Brandt, op. cit., fq.348; Dh. Qiriazi, op. cit., fq. 44. Encyclopaedia Britannica, vol. V, fq. 359.
78 B. Jelavich, op. cit., fq. 28.
79 Momir Jovic, *Istorija Srba*, Prishtinë, 1997, fq. 49.
80 Ibid.
81 G. Castellan, op. cit., fq. 40.
82 N. Malcolm, op. cit., fq. 42.
83 M. Jovic, op. cit., fq. 55.



Copyrighted material

faktor integrues ndërmjet sllavëve dhe bullgarëve[84] për t'i përballuar rreziqet nga Perëndimi katolik. Në anën tjetër, kristianizimi i Perandorisë Bullgare pati një rëndësi të madhe kulturore, sepse në të njëjtën kohë ai ishte një konsolidim vendimtar i kulturës sllave nëpërmjet futjes së një gjuhe të shkruar të tyre; gjithashtu, me sllavizimin e përfaqësisë kishtare, kisha bullgare i shpëtoi edhe varësisë së fortë nga Bizanti.[85]

Më në fund, kristianizimi i solli Bullgarisë fundin e sllavizimit, që pati rezultuar me ndërrimin e gjuhës amtare me atë sllave, i solli bashkimin shtetëror dhe etnik të perandorisë së re,[86] duke i asimiluar apo persekutuar e zhdukur muslimanët dhe kulturën shpirtërore e materiale të tyre (librat, xhamitë etj.), të krijuar për një kohë të gjatë, por edhe popujt e tjerë në territorin që ata e sundonin.[87]

## Ç. Rënia e Bullgarisë mesjetare

Bullgaria e pushtoi Kosovën qysh në vitin 850 dhe atje mbeti deri në vitin 1014 – 1018, kur vdiq perandori Samuili,[88] dhe i dorëzoi përfundimisht edhe garnizonet e fundit në Berat dhe kalanë e Tomorrit.[89] Sipas të njëjtit burim, Bullgaria u largua nga të gjitha vendet e pushtuara në Shqipëri në vitin 1041.[90] Gjatë kësaj periudhe Bullgaria

---

[84] T. Zavallani, *Histori e Shqipnis*, botimi II, Tiranë, 1998, fq. 75.
[85] Hansjorg Froomer, op. cit., fq. 177. Krhs.: B. Jellavich, op. cit., fq. 28.
[86] Shih: N. Malcolm, op. cit., fq. 28. Krhs.: B. Cela, op. cit., fq. 130; Dh. Qiriazi, op. cit., fq. 45.
[87] Shih: Mustafa Spahic, *Povijest islama*, 4, op. cit., fq. 136. Ky pohon se "përkundër numrit aq të madh, muslimanët qenë asimiluar, kryquar, shkretuar dhe shfarosur."
[88] Shih: N. Malcolm, op. cit., fq. 28. Krhs.: B. Cela, op. cit., fq. 130; Dh. Qiriazi, op. cit., fq. 49.
[89] Neritan Ceka, op. cit., fq. 306.
[90] Ibid., fq. 307.



Copyrighted material

u përpoq ta forcojë sundimin e vet me të gjitha mjetet që kishte, duke luftuar kundër muslimanëve, por edhe grupeve më të vogla etnike, të a. q. grupeve heretike. Mirëpo, perandoria rivale, Bizanti, në fillim të shekullit XI, në vitin 1014 në Betejën e Kleidonit, në krye të së cilës ishte Basili II, e shkatërroi Perandorinë Bullgare dhe e ktheu në gjirin e Perandorisë Bizantine[91]. Me këtë rast, ai urdhëroi "*masakrimin e 10.000 bullgarëve të zënë robër në këtë luftë duke ua verbuar sytë.*"[92] Kështu u mbyll edhe një faqe e historisë, ndonëse bullgarët kanë vazhduar të jetojnë edhe më tej.

---

[91] Encyclopaedia Britannica, LTD, vol. I, fq. 511.

[92] The Barnes Review, New York, Mars – Prill, 2000, vëllimi VI, nr. 2, sipas: A. K. Bogdan, *Historia e shqiptarëve nga Ilirët e lashtë në erën e Islamit*, në: Univers – revistë shkencore kulturore, Nr. 1/2001, Tiranë, fq. 54.
Sipas Enciklopedisë Britanike Basili II vrau e masakroi 15000 bullgarë. Shih: Encyclopaedia Britannica, vol. V, fq. 360.



Copyrighted material

## Përfundim

Perandoria mesjetare Bullgare është e lidhur ngushtë me besimin islam dhe muslimanët. Prania e muslimanëve në Perandorinë Bullgare, e kjo nënkupton edhe trojet iliro-shqiptare të cilat ishin nën pushtimin e tyre, është e argumentuar si nga burimet vatikane, ashtu edhe nga ato bizantine, pastaj islame etj. Këshilla e papës Nikolla I drejtuar hanit bullgar Borisit për masat që duhet të ndërmarrë kundër muslimanëve dhe krijimit shpirtëror e kulturor të tyre – librit, është dëshmia më e fuqishme se kryqëzatat e inkuizicioni dhe luftërat e mëpastajme kundër muslimanëve deri në ditët e sotme, janë pasojë e jotolerancës dhe të mosnjohjes judeo-kristiane e greko-romake ndaj vlerave jashta tyre.

Është detyrim shkencor por edhe moral që studiuesit e ndryshëm (historianët, arkeologët etj.) te ne ta studiojnë historinë jo duke i seleksionuar temat varësisht rrethanave politike e ideologjike, por ajo, historia duhet të studiohet në tërësinë e vet. Islami dhe muslimanët janë realitet për disa shekuj gjatë mesjetës në Ballkanin juglindor, pra edhe në trojet tona, duke e përballuar dhunën e ushtrive dhe besimeve pagane e kristiane.



Copyrighted material

# Summary

## Islam and Muslims in Mediaeval Bulgaria (IX-XI century)

Even before the formation of the state and before the people became Christians, the mediaeval Bulgarian Empire, which also included the Illyrian-Albanian territories occupied by them at that time, was closely associated with Islam and Moslems. The point of this scientific theory is proved by manuscripts from the Vatican and also from Byzantine and subsequently Islamic sources, etc. The advice of Pope Nicholas I to the Bulgarian Khan Boris, about steps which should be taken against Moslems and the spiritual creativity of their culture – books and mosques, is strong evidence that the Crusades and Inquisitions and the wars which followed against Moslems up till the present day were the result of Jewish – Christian and Greek-Roman ignorance and rejection of values other than their own, but also continuous intolerance throughout history…



Copyrighted material

# Sari Salltëku dhe roli i tij në përhapjen e islamit në trojet iliro-shqiptare e ballkanike para shekullit XIV

## Hyrje

Të shkruash për fenomenin dhe për personalitetin e Sari Salltëkut, do të thotë t'i shtrosh vetes një detyrim mjaft të rëndë e të ndërlikuar. Kjo vështirësi dhe ndërlikueshmëri konsiston, para së gjithash, në mungesën e burimeve dhe të literaturës së mirëfilltë ndër ne e më gjerë; pastaj, në shfrytëzimin e literaturës ekzistuese me rezervë të madhe dhe, së fundi, në seleksionimin e së vërtetës historike nga gjysmë të vërtetat dhe nga gojëdhënat e legjendat.

Hulumtimi i fenomenit dhe personalitetit të Sari Salltëkut na imponohet *per se*, për arsye që të ndriçohet personaliteti dhe roli i tij dhe i nxënësve të tij në histori, të ndriçohen lëvizjet e tyre, kontributi i tyre për të vetekzistuarit dhe për historinë e *tesavufit* - mistikës islame në Anadolli e Rumeli, e veçanërisht në trojet shqiptare dhe, *per alend*, për kontributin e tyre në përhapjen - zgjerimin e fesë islame në Anadolli, e veçan, për interesin tonë, për zgjerimin e fesë islame në Ballkan dhe në trojet shqiptare në periudhën paraosmane, e kështu me radhë.

Ndonëse për Sari Salltëkun në botë është shkruar deri diku, po jo edhe në historiografinë tonë shqiptare,



Copyrighted material

megjithatë aspekti historik i personalitetit të tij dhe veprimi i tij misionarist ka mbetur i pandriçuar, i mbështjellë me elemente mistike, mitike e misterioze, që paraqet vështirësi të llojit të vet.[93] As ne nuk pretendojmë të shkojmë më larg se të tjerët, përpos që në bazë të të dhënave historike, legjendave e gojëdhënave ekzistuese të regjistrohet prania e tij e e nxënësve të tij dhe të shënohen vendet ku ata jetuan e vepruan, pastaj t'i ballafaqojmë mendimet dhe rezultatet e hulumtuesve mes veti, në mënyrë që studimet e mëtejme t'i thellojnë këto hulumtime, si në aspektin fetar, ashtu edhe në atë historiko-kulturologjik, e para së gjithash në ndriçimin e shumë çështjeve në lidhje me përhapjen e Islamit në Ballkan, veçanërisht ndër shqiptarët para depërtimit të osmanlinjve në këto vise.

## Sari Salltëku ndërmjet legjendës dhe historisë

Paraqitja e Sari Salltëkut në skenën historike dhe aktiviteti i tij misionar konsiderohet se paraqesin një periudhë shumë të rëndësishme në përhapjen e besimit islam në

---

93 Bibliografinë për Sari Salltukun e shtroi dr. Franz Babinger në: *Encyclopedie de l'Islam*, Leyde - Paris, 1934, fq. 177-178 dhe T. Tayyib Okiç, *"Sari Saltuk'a ait bir fetva"*, Ankara Üniversitesi Ilahiyat Fakültesi Dergisi, Cilt 1, Sayi I, fq. 48-58; dhe T. Tayyib Okiç, *"Bir Tenkidin Tenkidi"*, Ankara Universitesi ¡lahiyat Fakultesi Dergisi, *AÜIFD*, Cilt II, Sayi 2-3, fq. 219-290; nga autorët më të rinj: Abdülbaki Gölpinarlı¢, Remzi Kitabevi, Istanbul, 1961, fq. 27-41. Në gjuhën shqipe kemi: Hasan Kaleshi, *"Legjendat shqiptare për Sari Salltukun"*, *"Përparimi"* - revistë kulturore e shkencore, 1/1967, Prishtinë, fq. 86-103 dhe kalimthi Mark Tirta, *"Prania e kulturës arabo-islame në mite, rite e besime popullore shqiptare"*, në: *"Feja, kultura e tradita islame ndër shqiptarët"*, Simpozium ndërkombëtar (prej 12 deri më 15.10.1992, i mbajtur në Prishtinë), Prishtinë, 1995. Po ashtu, para disa vitesh kemi edhe shkrimin tonë: N. Ibrahimi, *Islami në trojet iliro-shqiptare gjatë shekujve*, botimi I, Shkup, 1998, fq. 235 – 245 etj.



Copyrighted material

Perandorinë Bizantine, Bullgare e Hungareze përgjithësisht, e në trojet iliro-shqiptare veçanërisht, para ardhjes së osmanlinjve.[94] Madje, shkencëtari Kemal H. Karpat mendon se "banorët e parë muslimanë në Ballkan qenë me prejardhje turke", kurse "grupi i parë musliman me rëndësi në shekullin XIII, edhe pse grupe më të vogla kanë ardhur qysh edhe në shekullin X apo XI."[95]

Kjo ndodhi në periudhën e paraqitjeve të herezive të ndryshme, sikur paraqitja e bogumilizmit, manikeizmit dhe në periudhën kur shtetet e atëhershme ndërmerrnin të gjitha masat e mundshme për çrrënjosjen e pikëpamjeve heretike.[96]

Shkrimtari i njohur shqiptar I. Kadare në një roman të tij e thekson ardhjen e grupeve të ndryshme misionariste, ndër ta edhe të Sari Salltëkut, duke e përshkruar se si dervishët turq endacakë kishin ardhur në trojet tona përgjatë rrugës së vjetër e të njohur që nga antikiteti *Via-Egnatia*, në grupe të vogla, nga dy veta, por shumë shpesh të vetmuar e të zbathur.[97]

Edhe historiani e diplomati shqiptar i dikurshëm Ekrem bej Vlora pohon se në periudhën paraosmane në tokat shqiptare erdhën misionarë, dervishë shëtitës, që nuk qëndronin në një vend, por bënin përgatitjen e vendit për pushtimin ushtarak të Turqisë. Ndër ta duhet përmendur edhe Sari Salltëku. E. Vlora, ata i quan pararojë të ushtrisë Turke në Ballkan.[98]

---

[94] I këtij mendimi është edhe orientalisti i mirënjohur shqiptar dr. Hasan Kaleshi, *op. cit.*, fq. 86.

[95] Kemal H. Karpat, *Gradjanska prava muslimana Balkana*, në: Fikret Karcic (përgatiti), *Muslimani Balkana – Istocno oitanje u XX vijeku*, Tuzla, 2001, fq. 96.

[96] Nexhat Ibrahimi, *Islami në trojet iliro-shqiptare gjatë shekujve*, op. cit., fq. 179 – 195, etj. Shih: Skender Rizaj, *Shqiptarët dhe Serbët në Kosovë*, Prishtinë, 1991, fq. 49 etj. G. & J. Testas, *Inkvizicija*, Zagreb, 1982.

[97] Ismail Kadare, *Ura me tri harqe*, Prishtinë, 1980, fq. 40 – 41. Shih edhe: Jashar Rexhepagiq, *Dervishët, rendet dhe teqetë*, Pejë, 1999.

[98] Ekrem Vlora, *Shënime mbi historin' e muslimanizmit në Shqipnie, Jeta Muslimane Shqiptare*, Revistë Fetare – kulturore, Detroit, VII/4, 1959.



Copyrighted material

Sipas një *Hagiografie* (në koleksionin e Osman Asaf Sokoloviqit, tash të ruajtur në Bibliotekën e Gazi Husrev-beut në Sarajevë), Sari Salltëku ka vepruar në kohën e fillimit të Perandorisë Osmane.[99]

Në Genel Kültür Ansiklopedisi, *"ANA BRITANICA"*, për Sari Salltëkun thuhet se ishte dervish turk që jetoi dhe veproi në shekullin XIII, se është luftëtar dhe se emri i tij i vërtetë ishte Mehmet.[100] Në *Enciklopedinë islame* të hartuar nga evropianët, pohohet: "Sari Salltëku është dervish turk, evlija bektashian, me prejardhje nga Buhara, kurse emri i tij i vërtetë është Mehmed Buhari."[101] Edhe shkencëtari turk M. Tufan pohon se Baba Salltëku ishte dervish dhe paraqiste udhëheqsin ideor për turqit muslimanë të Anadollit, dhe më vonë do të luante rol të madh në përhapjen e Islamit në Siujdhesën ballkanike.[102]

Turkologu me famë botërore, Halil Inalxhik, pohon se, pas kryengritjes së shehlerëve babaj në vitin 1241[103], Sari

---

J. Rexhepagiqi thotë se aktiviteti i Sari Salltëkut dhe të tjerëve ishte në të gjitha vendet e deri në bregdetin adriatik, kurse në veri madje deri në Suedi. Jashar Rexhepagiqi, op. cit., fq. 88.

99 Sipas: Muhamed Hadzijahic i drugi, *Islam i muslimani u Bosni i Hercegovini*, Sarajevë, 1977, fq. 26. Sipas veprës së njohur të M. Kiel, Sari Salltëk Dede, që jetoi në shekullin XIII, *"propagandoi islamin popullarizues dhe sinkretist në Ballkanin paraosman."* Machiel Kiel, *Ottoman architecture in Albania (1385 – 1912)*, Istanbul, 1410 h./ 1990, fq. 174.

100 *ANA BRITANICA, Genel Kültür Ansiklopedisi*, Istanbul, 1994, kaptina 27, fq. 175.

101 Shih: *Enciklopedia islame*, IV, S-Z, Leiden – Leipzig, 1934, fq. 184/I-II dhe 185/I, sipas: Dzemal Cehajic, *Derviski redovi u jugoslovenskim zemljama*, Sarajevë, 1986, fq. 101, fusnota 271.

102 Muzaffer Tufan, *Göç hareketleri ve Yugoslavia Turkleri*, cilt 5, sayi 15, Ankara, 1992, fq. 941, sipas: Maliq Osi, *Prizren drevni grad ...*, Prizren, 1996, fq. 154.

103 Dy vjet para invadimit mongol në vitin 1241, një dervish me emrin Baba Is'hak, në Anadollin Qendror, organizoi kryengritjen e madhe që ishte kryengritja e parë turkmene, për të cilën ekzistojnë gjurmë historike. Kryengritja u shua pas luftimeve të ashpra që u zhvilluan, e të cilat i humbën fiset turkmene. Halil Inalxhik, *Perandoria osmane – Periudha klasike 1300 – 1600*, Shkup, 1995, fq. 270.



Copyrighted material

Salltëku në vitin 1261, me dyzet familje turkmene, strehohet në territorin bizantin, në Dobruxhë të Bullgarisë.[104]

Sipas disa burimeve historike, në vitin 1241, Izzudin Kejkausi dhe aleati i tij Salltëk Baba bënë pa sukses një kryengritje kundër mongolëve. Për këtë arsye, rreth vitit 1261–1262 ai dhe një grup turkmenësh në krye me Salltëkun gjetën strehim në Perandorinë Bizantine dhe u vendosën përgjatë bregdetit të Detit të Zi, në viset që shtriheshin ndërmjet Varnës deri në Babadag në Dobruxhë.[105] Sipas po këtij burimi, disa grupe njerëzish të Kejkauzit (rreth 12.000 tenda) shkuan në Krime, por nga viti 1280 u kthyen në Dobruxhë. Disa vjet më vonë, ata u vendosën rreth Varnës, për t'u kristianizuar më vonë, por ruajtën dialektin e tyre të pastër oguz. Ata që mbetën në verilindje të Bullgarisë, në Dobruxhën veriore, mbeten muslimanë.[106]

---

104 Halil Inalxhik, op. cit., fq. 269 - 270.

Thuhet se pas vendosjes në Dobruxhë të Bullgarisë, Sari Salltëku ishte në shërbim të princit Nogaja. Ibid., fq. 270. Edhe M. Spahiq konfirmon se Sari Salltëku hyri në shërbim të princit Nogaja, i cili sundonte në stepë në veri të Detit të Zi. Po ashtu, M. Spahiq konfirmon se Sari Salltëku është paraqitur si misionar i mirëfilltë i islamit. Shih: Mustafa Spahic, *Povijest islama*, 4, Sarajevë, 2000, fq. 136. Kurse J. Rexhepagiqi pohon se sheh Sari Salltëku më 1260 me 40 dervishë turkmenë u vendosë në vendbanimin Dobruxhë dhe në pjesë të tjera të Ballkanit, dhe aty përhapën kulturën islame. Jashar Rexhepagiq, op. cit., fq. 88. Në *Enciklopedinë islame* të hartuar nga evropianët lexojmë se Sari Salltëku hyri në zonën e Dobruxhës rreth Baba Dagut në Rumani me dhjetë mijë turkmenë anadollakë. *Enciklopedia islame*, IV, S-Z, Leiden – Leipzig, 1934, fq. 184/I/II dhe 185/I, sipas: Dzemal Cehajic, op. cit., fq. 101, fusnota 271.

105 K. Karpat, *Gagauzlarin Tarihi Mensei Uzerine ve Folklorundan Parcalar*, në: Fist International Congress of Folklore, Ankara, 1975, fq. 163 ff, sipas: Fikret Karcic, *Muslimana Balkana*, op. cit., fq. 96.

106 Ibid.

Supozohet se turkmeni Sari Salltëku ishte muslimani i parë që përhapi islamin në Dobruxhë, në Bullgarinë e atëhershme, dhe në Rumaninë e sotme, duke ardhur këtu rreth vitit 1263. Shih: A. Hukic, *Arapi i Islam u Evropi, Glasnik VIS-a*, Sarajevë, nr. 7 – 9, 1961, fq. 279.



Copyrighted material

Sipas *Tarih-i Al-i Selcuk* të Jazixhi-zades, Sari Salltëku ka ardhur në Dobruxhë prej Kivit, më 1281, kurse sipas *Mohaç-names*, ai ka kaluar në Dobruxhë në kohën e Ertugrul-beut, para vitit 1281.[107]

Në bazë të të dhënave që ofron shkencëtari maqedonas A. Matkovski, lexojmë se në shekullin XIII ndodhi shpërngulja e madhe e më se dyqind mijë tendave të grupeve nënturke. Pohohet se këta e banuan Dobruxhën nga viti 1250 deri 1260 me fiset turkmene nga Azia e Vogël. Njëkohësisht me këtë proces filloi kolonizimi dhe islamizimi intensiv i Ballkanit. Ndërkaq, në vitin 1263 një grup turkmenësh prej dymbëdhjetë mijë tendash kaluan në Ballkan që u vendosën në Dobruxhë. Në krye të tyre ishte Sari Salltëku.[108] Ndonëse nuk kemi konfirmime për këto shifra nga burime të tjera, megjithatë do të kenë ekzistuar, qoftë edhe me shifra më të vogla.

## Sari Salltëku si predikues fetar dhe luftëtar

Në mbështetje të legjendave që gjenden në *"Sejjahetnamen"* (Udhëpërshkrimin) e Evlija Çelebiut, Sari Salltëku në Turkestan nga Hoxha Ahmed Jeseviu mori urdhrin vijues: *"I dashuri Salltëk Mehmeti im! Ty të dërgoj në tokat e Rumit. Shko në vendin e shtatë mbretërive dhe bëhu njeri me famë e i njohur."* Pas marrjes së këtij urdhri, Sari Salltëku me 700 dervishë të vet, besnikë idesë së tij, erdhi në Anadoll.

Diçka e ngjashme mund të dëgjohet edhe te Sheh Uka, nakshibendi në Gjakovë, i cili thotë se Sari Salltëku

---

[107]Sipas: Hasan Kaleshi, *op. cit.*, fq. 103.

[108] Shih: Aleksandër Matkovski, *Otporot na Makedonija vo vremenoto na turskoto vladenje*, tom II, Skopje, 1983, fq. 275; Muzaffer Tufan, op. cit., fq. 941, sipas: M. Osi, op. cit., fq. 153, 154. Shih: K. H. Karpat, op. cit., fq. 96.



Copyrighted material

është njëri prej nxënësve të Ahmed Jeseviut, mistikut të njohur turk.[109]

Po ashtu, sërish në mbështetje të legjendave, Sari Salltëku, urdhrin e kishte marrë nga hazreti Muhammedi a. s., i cili, gjoja, i paskësh thënë: *"Çliroje Edirnen dhe bëje atë muslimane. Ymeti im të mos e braktisë këtë vend".*[110] Pas marrjes së këtij urdhri, dervishët e tij luftëtarë u nisën në drejtim të detit dhe për herë të parë arritën në brigjet e Rumelisë.

Në *"Vilajet-namen"* e Haxhi Bektash Veliut, Sari Salltëku përmendet rregullisht si dervish dhe nxënës i tij.[111]

Mirëpo, sipas versionit tjetër, Sari Salltëku paraqitet si sunit i vërtetë. Ebu'l-hajr Rumiu, në *Salltëk-namen* e tij, shkruar rreth vitit 1450, Sari Salltëkun e paraqet me origjinë prej familjes së Muhammedit a. s...., duke pohuar se Sari Salltëku i takonte medhhebit hanefi. Edhe në shumë burime (kronika) të kohës, Sari Salltëku nuk ceket të ketë qenë bektashi.

Mbështesim mendimin e H. Kaleshit se bektashinjtë dhe tarikatet e tjera Sari Salltëkun e bënë për vete, për shkak të autoritetit të tij në popull dhe qëllimit të tërheqjes së popullit pas tyre,[112] dhe jo pse për këtë kanë argumente çfarëdo.

Sipas K. Karpatit, në shekullin XIII, popullata muslimane ku jetonin dhe vepronin Izuddin Kejkausi dhe Salltëk Baba ishin ithtarë të tyre.[113] Këtë e argumenton

---

[109] H. Kaleshi, op. cit., fq. 91. Disa historianë mendojnë se Sari Salltëku ishte gjysh i kalifit Ahmed Jaseviut. Sipas: M. Osi, op. cit., fq. 156.

[110] *ANA BRITANICA, Ibid.*, fq. 175.

[111] Hasan Kaleshi, *op. cit.*, fq. 87.

[112] *Ibid.*, fq. 87. Shembull të përvetësimit të personaliteteve të ndryshme kemi edhe te Suzi Zerrini, i cili nga disa historianë e shkencëtarë quhet *Suzi Çelebiu*, nga disa *Suzi Baba*, etj., por ai veten nuk e ka quajtur as dervish, as shi'i, as luftëtar, që jep të kuptojmë se atributet si dervish etj. janë atribuime të mëvonshme. Sipas F. Koprulu, Ahmed Jaseviu, pra edhe Sari Salltëku, ishte hanefij. Shih: Dr. Selçuk Eraydin, *Tesavvufi dhe tarikatet*, Tetovë, 2001, fq. 318.

[113] Fikret Karcic, *Muslimani Balkana*, op. cit., fq. 96.



Copyrighted material

edhe ajo që thuhet se Sari Salltëkut i vinin njerëz, nga viset e ndryshme, e edhe nga Podunavlja, muslimanë të fshehtë që te ky e mësonin besimin islam, kryenin detyrimet tjera islame si namazin, agjërimin e veprime të tjera, dhe pas festës së Bajramit ktheheshin në vendet e tyre si misionarë për ta vazhduar punën që e kishin mësuar.[114]

Kur është fjala për këta muslimanë të fshehtë aso kohe, kemi shënime me bollëk nga burime të ndryshme se në territorin e Panonisë së sotme muslimanët kanë qenë në numër të konsiderueshëm, dhe ata fenë islame e predikonin fshehtazi. Kishte edhe të tjerë që deklaroheshin botërisht muslimanë, kryenin detyrat e tyre dhe zotronin banishtet e shumta të tyre.[115]

Sipas historianit H. Inalxhikut, Sari Salltëku u bë hero i një epi, në të cilin është përshkruar si dervish dhe gazi (luftëtar) që përhap Islamin në Evropë[116]. Ai, i veshur me rasë murgjish të krishterë, predikonte Islamin nëpër kisha dhe me shpatën e tij të drunjtë derdhte gjakun e priftërinjve që e kundërshtonin.[117]

Këtë e konfirmojnë edhe shumë gojëdhëna, si ajo që e transmeton Sheh Uka, se Sari Salltëku ka ardhur në këto vise i veshur me rroba të priftit duke e përhapur Islamin.[118]

---

[114] Shih: Muhammed Hadzijahic i drugi, op. cit., fq. 26.

[115] Shih: Tomas Arnold, "*Historia e përhapjes së Islamit*", në përgatitje për botim në gj. shqipe nga SHB "Dituria islame", Prishtinë, dhe N. Ibrahimi, "*Islami në Ballkan para shekullit XV*", op. cit.

[116] Ndër akinxhinjtë turq në shekullin XIII në Ballkan ishin dervishët e Sari Salltëkut. M. Osi, op. cit., fq. 156.

Thuhet se Ahmed Jaseviu nëpërmjet nxënësve të tij ka ndikuar edhe në Evropë. Shih për këtë: Dr. Selçuk Eraydin, op. cit., fq. 319.

[117] Halil Inalxhik, *op. cit.*, fq. 269-270.

Është interesant të ceket se me kërkesë të Sulltanit, shejhu'l-islami Ebu Suud solli fetvanë më 1566 në të cilën Sari Salltëkun e shpall për murg kristian. Sipas: M. Osi, op. cit., fq. 159. Nuk kemi të dhëna plotësuese lidhur me këtë fetva, andaj mbetet që kjo fetva të zbulohet si tërësi, e pastaj në kontekstin e përgjithshëm të analizohet.

[118] Hasan Kaleshi, *op. cit.*, fq. 91.



Copyrighted material

Legjenda vazhdon e thotë se Sari Salltëku kishte mbytur një dragua që i kishte nën kontroll të bijat e mbretit të Dobruxhës (Hungari)[119], prej kësaj fitoi simpatinë e mbretit dhe për këtë arsye 40.000 pabesimtarë e pranuan besimin islam.

Pastaj legjenda thotë se Sari Salltëku vrau një prift të njohur në Çeki-Sllovaki, dhe tatarët vendas në vendin Lipko pranuan besimin islam. Këta 150.000 muslimanë të rinj i vendosi në qytetin Danzig. Po ashtu, bashkë me këta tatarë, 600.000 banorë të Hersekut, Sari Salltëku i ktheu në besimin islam.[120]

Sipas të dhënave që ofron *"Salltëk-nameja"* (Libri mbi Salltëkun), Sari Salltëku ka udhëtuar në Rumeli, në Anadolli, në Sivasi dhe në Turkestan. Pastaj shkon në malet e Kaukazit, ku ndeshet dhe ballafaqohet me rebelët e cubat, lufton kundër tyre dhe i shkatërron ata. Pastaj udhëton për në Egjipt, Habeshistan (Etiopi) dhe në Indi.[121]

Me të arritur në Rumeli, Sari Salltëku me shoqërinë e tij sheh vuajtjet dhe persekutimet që po i pësonin muslimanët nga ana e kristianëve, prandaj me ushtrinë e vet e pushton Edirnen (me se e plotëson premtimin e dhënë Pejgamberit për çlirimin e Edirnes), pastaj e çliron Shkupin dhe qytetin e Dobruxhës. Kristianët e atyre vendeve i dënon për krimet e bëra ndaj muslimanëve. Më vonë kalon në tokat françeskane, duke depërtuar deri në brendi të shteteve evropiane.[122]

Sipas disa të dhënave, Sari Salltëku i ka shëtitur të gjitha vendet islame, kurse disa prej tyre, sikur Edirnenë, Krimenë, Kefenë dhe Osmanxhikun, i ka pushtuar vetë. Në të gjitha këto ndërmarrje, Sari Salltëku ka përdorur mrekulli

---

119 Sipas të gjitha gjasave, kemi të bëjmë me Dobruxhën në Bullgari / Rumani e jo në Hungari.

120 *ANA BRITANICA, op. cit.*, fq. 175.

121 *Ibid.*, fq. 175.

122 *Ibid.* fq. 175.



Copyrighted material

të ndryshme, vepra çudibërëse, me se u ndihmoi mbretërve, i mahniti disa prej tyre, të cilët pranuan Islamin.[123]

Sari Salltëkun e gjejmë edhe në rolin e këshilltarit të sulltan Osman Gaziut. Atë e pati këshilluar: *"Bëhu i drejtë, mos i detyro të varfërit të të mallkojnë, nderoi me kujdes kadinjtë dhe mëkëmbësit. Sundo me drejtësi nëse dëshiron të mbetesh në pushtet dhe nëse dëshiron ta ruash dëgjueshmërinë e shtetasve të tu."*[124]

Sa i përket Evropës jugore M. Spahiq mendon se Islami së pari është forcuar në Srem, Maçvë dhe në Bosnjën verilindore, ku është kënduar edhe epi i njohur i Salltëk-names, që dëfton për namin e Sari Salltëkut në këto vise.[125]

## Sari Salltëku në trojet iliro-shqiptare

Fenomeni i Sari Salltëkut është i pranishëm mjaft edhe në trojet shqiptare.[126] Sipas etnologut, dr. Mark Tirta, legjendat mitike për Sari Salltëkun në përgjithësi kanë origjinë nga Orienti, por ne gjejmë edhe elemente që kanë të bëjnë me figurat tona mitologjike, si kuçedra, dragoi etj.[127]

Për mbifuqinë e Sari Salltëkut legjenda thotë se ai ka ngulur shkopin në tokë a në shkëmb dhe aty për aty ka shpërthyer uji për të eturit e kalimtarët.[128] Për disa tashmë

---

[123] Për veprat çudibërëse të Sari Salltëkut sipas legjendave shih: Hasan Kaleshi, *op. cit.*, fq. 87 dhe 97-98; dhe *ANA BRITANICA, op. cit.*, fq. 175.

[124] Halil Inalxhik, Op. cit., fq. 94.

[125] Mustafa Spahic, op. cit, fq. 136.

[126] A. Hukiq supozon se Sari Salltëku ishte misionari i parë islam në Shqipëri (Abdurrahman Hukic, *Arapi i islam u Evropi*, Glasnik VIS-a, Sarajevë, nr. 7-9, 1961.) ndonëse të dhënat historike, arkeologjike e kulturologjike çojnë në praninë e Islamit në Shqipëri e trojet shqiptare shumë më herët, për të cilat çështje tashmë shkurtimisht kemi shkruar.

[127] Mark Tirta, *op. cit.*, fq. 183.

[128] *Ibid.* fq. 183



Copyrighted material

lexuam, e për vepra të tjera mund të lexohen legjendat e tubuara nga orientalisti H. Kaleshi.[129]

Disa vende në trojet shqiptare edhe sot e kësaj dite mbajnë emrin e Sari Salltëkut. Do t'i përmendim disa sosh dhe karakteristikat më themelore.

Nja 600 metra sipër Krujës është një majë mali që quhet "Mali i Sari Salltëkut". Aty gjendet edhe "Teqeja e Sari Salltëkut", e vendosur në shpellë, ndaj njerëzit hyjnë nëpër shkallë. Prej shkëmbit buron uji me të cilin marrin abdest dhe të cilin e pijnë si ilaç.[130] Praninë e tyrbes, siç e quan atë M. Kiel, e konfirmon edhe F. Babinger, i cili pohon se tyrbja e Sari Salltëkut në malin e Krujës daton nga viti 1104 h./1692 - 1693[131] dhe të ujit, përkatësisht të kroit, çezmës, i cili thotë se ky krua është i datës 1190 h./ 1776 / 1777.[132] Ky vend në Shqipëri vizitohet prej 7 deri më 15 gusht, me ceremoni e rituale fetare.[133]

Sipas H. Kaleshit, aty gjenden gjurmët e këmbës së Sari Salltëkut duke ikur prej Kruje, për t'iu shmangur një ploje etj. Etnologu M. Tirta, pohon se pranë disa teqeve ose brenda tyre, na dëshmohen gjurmët e këmbëve të njeriut të gdhendura në gurë. Rrëfenjat mitike thonë se këto janë gjurmë të shenjtorit të bektashinjve, Sari Salltëkut, që është hedhur nga mali me po këtë emër, ku gjendet edhe Teqeja e Gjurmës së shenjtë.[134]

Gjurmë të tilla janë dëshmuar edhe në vendin Guricaj a në Radë pranë Durrësit, edhe këto pranë teqeve kushtuar Sari Salltëkut. Legjenda gjurmësh të këmbëve që lidhen me Sari Salltëkun vërtetohen dhe në vende të tjera.

---

129 Shih: Hasan Kaleshi, *op. cit.*, fq. 80-103.

130 Shih: *Ibid.*, fq. 92-95.

131 Sipas: Machiel Kiel, op. cit., fq. 175 dhe fq. 189 fusn. 19.

132 Machiel Kiel, op. cit., fq. 175. Shih shënimet 18 deri 24.

133 Mark Tirta, *op. cit.*, fq. 183.

134 *Ibid.*, fq. 181. Më gjerësisht për legjendat rreth Gjurmës së shenjtë dhe për legjendat rreth Malit të Sari Salltëkut në Krujë shih: Hasan Kaleshi, *op. cit.*, fq. 92-95.



Copyrighted material

Në një kuptim, ky element kulti lidhet edhe me legjendat mitike bektashiane, të ardhura nga Orienti islam.[135]

Gjurmë të ngjashme, mbase të njëjta, hasim edhe në periferi të fshatit Zgatar të Opojës, në drejtim të rrugës malore Zgatar – Lybeçevë - Prizren, në vendin e quajtur Gjerman (s'ka të bëjë me Gjermaninë e gjermanët e sotëm).[136]

Me emrin "Sari Salltëk" është i njohur edhe vendi i quajtur "Fusha e Zejnel Agës", në periferi të Pejës, afër fshatit Qyshk, pranë magjistralit Pejë - Prishtinë. Sipas autorëve antikë, ky vend është i njohur me emrin "Siparunti"[137]. Aty dikur ka pasur një tyrbe, kurse varri i braktisur i

---

[135] Mark Tirta, *op. cit.*, fq. 181.

[136] Në këtë vend gjenden disa gjurmë të kulturës islame të pashpjeguara deri më sot. Në një shkëmb, jo fort të madh, nja 500 metra larg fshatit, gjendet vendi i quajtur "Guni i haxhisë", ku kemi gjurmët e shenjtorit të gdhendura në gurë, duke marrë në shenjë këmbët e kalit, dhe pak më andej, disa metra larg, kemi një karrige të gdhendur, të thelluar në gurë, ku njerëzit ulen, këputin një pe nga petkat e veta dhe pushojnë një çikëz. Legjenda thotë se ulja në këtë karrige dhe pushimi i shkurtër në të është shërues. Më tej, 300-500 metra kemi vendin e quajtur "Vorri i madh", i muruar në gurë, në formë katërkëndëshi, me një dollap të vogël (zgavër) për të lënë para, vezë pule e gjësende të tjera. Ky varr edhe sot nderohet e vizitohet. Për dimensionet dhe karakteristikat e tjera nuk mund të flas për shkak të kushteve specifike kur po shkruhet ky tekst. Po ashtu, disa kilometra më tej gjendet "Shpella e Madhe" e Zgatarit, ku sipas legjendës, hazreti Aliu ka luftuar kundër dragoit dhe e ka mbytur atë, sepse ky i paska ngujuar në shpellë banorët e fshatrave, sidomos femrat e reja.
Duke i marrë për bazë shpjegimet e Mark Tirtës si ekspert, dhe duke i marrë parasysh ngjashmëritë e mëdha midis gjurmëve materiale që i ofron M. Tirta dhe ata të fshatit Zgatar, marr guxim që kompetentëve t'ua shtroj këto të dhëna për hulumtime e studime të mëtejme e me kompetencë, dhe njëherit që këto fenomene të rralla mos t'i dëmtojë koha e mbulojë harresa.
Shënimet për fshatin Zgatar po i ofroj sipas mbamendjes vetjake prej para disa viteve dhe sipas rrëfenjave të babagjyshit Hevzi Tefik Ibrahimit (1903-1988), pasi edhe vetë kam prejardhjen nga ky fshat dhe qindra herë kam ecur rreth e qark "Gunit të haxhisë", "Vorrit të madh", "Shpellës së madhe të Zgatarit" etj.

[137] Mehmet Loci, "*Siparunti antik*", Rilindja, gazeta e datës 26.08.1978, Prishtinë.



Copyrighted material

"Sari Salltëkut" ka qenë i mbuluar. Ekziston edhe një varr tjetër. Të dy varret janë të mbuluara me pllaka guri me muratim të thatë. Aty gjenden dy mihrabe, ku njerëzit ndezin qirinj, këputet ndonjë pe, lihen të holla, përgatitet hallvë etj. Zakonisht vizita bëhet pasdreke deri në iqindi, kur bëhen lutje për plotësimin e muradeve (dëshirave). Dita e martë dallohet nga numri i vizitorëve, por, vizita kryesore gjatë vitit bëhet ditën e "Ali Gjynit", më dy gusht. Është interesante se këtë varr e vizitojnë edhe kristianët.[138] Këtë lokacion e thekson edhe historiani S. Rizaj, i cili pohon se në afërsi të Pejës gjendet tyrbja e Sari Salltëkut, të cilën sot e kësaj dite e vizitojnë si muslimanët ashtu edhe kristianët, me qëllim që të kërkojnë ndihmë nga Perëndia, sidomos për shëndet e fat. Paraqitjen e Sari Salltëkut dhe të misionarëve të tij S. Rizaj e vendos në periudhën paraosmane, krahas paraqitjes së herezive të tjera si bogumilizmi etj.[139]

Edhe M. Cërabregu Tyrben e Sari Salltëkut, e cila gjendet në lindje të Gradinës që ekziston edhe sot, e numëron ndër tyrbet kryesore në Pejë.[140]

Sipas pohimeve të Baba Qazimit - sheh i bektashinjve në Gjakovë, edhe në Lumë, në vendin e quajtur Jallicë (Gjallicë) ekziston një varr që e vizitojnë më dy gusht dhe këtë ditë e quajnë "Dita e Sari Salltëkut".[141]

---

[138] Shih: H. Kaleshi, *op. cit.*, fq. 88.
Lokacioni i "Sari Salltëkut" në Pejë është larg Siparuntit antik rreth 400 metra. Kohëve të fundit janë bërë disa meremetime nga një rend dervishësh, por pa mbikëqyrje profesionale.
Disa nga të dhënat për Sari Salltëkun në Pejë na i ofroi z. Mehmet Loci, arkeolog nga Peja, gjatë vuajtjes së dënimit në burgun e Dubravës më 27. 08. 1996. Për shkaqe objektive, as këtë, e as objektet e tjera për shqyrtim, nuk kemi mundur t'i përcjellim me hulumtime nga terreni, të shënojmë ndonjë gojëdhënë, të bëjmë ndonjë fotografi, skicë etj.

[139] Skender Rizaj, op. cit., fq. 49.

[140] Muharrem Cërabregu, *Gjeografia kulturore në harta dhe në regjistrime gjeografike*, në: *Studimi etnografik i ndryshimeve bashkëkohore në kulturën popullore shqiptare*, Prishtinë, 1990, fq. 195.

[141] Hasan Kaleshi, *op. cit.*, fq. 92.



Copyrighted material

Po ashtu, nja 17 km. larg Pejës, në katundin Prilep të Deçanit, në bregun e lumit Reka, ekziston një tyrbe që e quajnë "Sari Salltëk".[142]

Në majë të bjeshkës së Pashtrikut, nja 4 orë udhëtim në kufi me Shqipërinë (politike), gjendet një varr për të cilin pohohet se është i Sari Salltëkut. Deri pas Luftës së Dytë Botërore, ditën e "Ali Gjynit" me mijëra njerëz nga Peja, Gjakova, Prizreni e Byci, Dibra e Shqipëria e vizitonin këtë varr. Disa mendojnë se Sari Salltëku nuk ka vdekur këtu, por vetëm ka pushuar.[143] Në lidhje me këtë tyrbe në *Sall-namen e Prizrenit* lexojmë: *"Në pjesën perëndimore të qytetit në largësi prej 3 orësh, saktë në maje të malit Pashtrik gjendet tyrbja në të cilën është varrosur Sari Salltëk Dede. Banorët e popujve të ndryshëm kanë respekt të madh ndaj personalitetit të tij dhe e vizitojnë çdo vit në kohë të caktuar.*"[144]

Në burimin tjetër lexojmë: *"Myslimanët çdo vit më dy gusht vijnë në tyrben e Sari Salltëk Dedes, ...atje presin kurban dhe kërkojnë ilaç për gratë shterpa dhe të sëmurët."*[145]

Emrin e Sari Salltëkut e gjejmë edhe në Kishën e Spirgjonit në Korfuz, ku mendohet të jetë varrosur ai. Po ashtu, kjo flitet edhe për Manastirin e Shën Naumit në Ohër, se Sari Salltëku është varrosur aty.[146] Mirëpo, hollësi të mëdha nuk kemi.

Edhe A. Matkovski edhe M. Tufan cekin një tyrbe të Sari Salltëkut *"te burimi i Drinit të Zi, jo fort larg Strugës"* duke e veçuar nga ajo e Ohrit.[147] Për shkak të klimës politike në

---

[142] *Ibid.*, fq. 89.

[143] *Ibid.*, fq. 90-91.

[144] *Prizren salnamesi Pirzerin vilayeti*, Prizren, 1874, sipas: M. Osi, op. cit., fq. 157. Krhs.: Aleksandar Matkovski, op. cit., fq. 273, 275, 278.

[145] *Zadužbine Kosova*, ... Prizren, Beograd, 1987, fq. 497, sipas: M. Osi, op. cit., fq. 157.

[146] Hasan Kaleshi, op. cit., fq. 89. Krhs.: Aleksandar Matkovski, op. cit., fq. 273.

[147] Aleksandar Matkovski, op. cit., fq. 278; Jashar Rexhepagiq, op. cit., fq. 88, dhe: Muzaffer Tufan, op. cit., fq. 320, sipas: M. Osi, op. cit., fq. 163.



Copyrighted material

Maqedoni aktualisht kjo gjendje nuk mund të verifikohet në vend të ngjarjes nëse është fjala për dy Tyrbe (varre) të veçanta apo për një, duke e përshkruar tjetërfare.

Po ashtu, Sari Salltëku është i njohur edhe jashtë trojeve iliro-shqiptare, sikur në Dubrovnik, ku theksohet se ceremonia për Sari Salltëkun festohet krahas festave të tjera të vendit: Sveti Nikolla, Hizir Iljas, Kasum, Nëna Mari dhe Karangjollozi.[148] Tyrben e tij e hasim edhe në qytetin Babadag të Rumanisë, e cila për shekuj ishte vend zijareti i muslimanëve e edhe i sulltanëve kur shkonin apo ktheheshin nga Buxhaku, Moldavia apo Polonia.[149]

## Vdekja e Sari Salltëkut

Në fund të shohim diçka rreth vdekjes së Sari Salltëkut. Ky, para se të vdiste, la amanet që kufoma e tij të përgatitej në shtatë tabute (arkivole) dhe t'u dërgohej shtatë mbretërive: të Moskës, Çekisë, Sllovakisë, Edirnes, Bogdanit dhe Dalmacisë. Kështu edhe ndodhi. Me përcjellje ushtarësh, kufoma e tij u dërgua në shtatë mbretëri dhe me këtë veprim u realizua dëshira e Ahmed Jeseviut, që fama e tij të arrinte në shtatë mbretëri.[150]

Gojëdhëna vijuese jep përshkrim më të detajizuar. Thuhet se para vdekjes Sari Salltëku ishte në keshtjellën Gylgar, dhe me atë rast thirri beun e keshtjellës e i la këtë

---

148 Shih: Evlija Celebi, *Putopis*, Sarajevë, 1979, fq. 427.

149 Kemal H. Karpat, op. cit., fq. 96.

150 *ANA BRITANICA, op. cit.*, fq. 175.

Jean Deny në *"Les Turcs des Environs de Selanique"* cek se një prej shtatë varreve të Sari Salltëkut gjendet në brigjet e liqenit të Ohrit, sipas: M. Tufan, op. cit., fq. 940 – 941.



Copyrighted material

amanet: *"Kur të vdes, secili prej muhibëve* (nxënësve, N.I.) *të mi le ta mbajë nga një arkivol e le ta vendosë afër meje. Le të gjendem në cilindo prej këtyre arkivoleve, e pronari i atij arkivoli le të më marrë e të më çojë në vendin e tij e le të më varrosë atje."* ... Nuk kaloi shumë kohë dhe ai ndërroi jetë. Muhibët e tij arritën prej të gjitha anëve. Secili kishte sjellë nga një arkivol dhe e kishte vendosur pranë Sari Salltëkut. Thuhet se prej secilit arkivol shtrihej dora e tij, secili e mori arkivolin e vet dhe e çoi me gëzim të madh në vendin e tij.[151]

Për Sari Salltëkun[152] thuhet se vdiq nga pirja e ujit të helmuar dhe nga goditja e një fedaini me hanxhar. Të dy bijtë e Sari Salltëkut, Ibrahimi dhe Muhammedi, vazhduan rrugën e babait dhe me dëshirë hynë në shërbim të Perandorisë Osmane.[153]

---

151 Hasan Kaleshi, *op. cit.*, fq. 99.

152 *Salltëk-nameja* - Libri që përmbledh gojëdhënat popullore e që është hartuar me kërkesë të të birit të Mehmetit II, Xhem Sulltanit rreth viteve 1471-1480. Ky i vuri detyrë Ebu'l-Hajr Rumiut që të mblidhte tregimet kushtuar Sari Salltëkut. Në Muzeun "Topkapi – Saraj" ruhet shkrimi më i veçuar për Sari Salltëkun, që daton nga viti 1591. Sipas këtij shkrimi, emri i vërtetë i tij është Sherif Hëzër. Më gjerësisht: ANA BRITANICA: Genel Kültür Ansiklopedisi, op. cit., kaptina 27, fq. 175.

Shih për këtë problem: Halil Inalxhik, *op. cit*, fq. 269 – 274 dhe 280.

P.S. Pjesët e shkruara turqisht nga kjo enciklopedi turke i përktheu shoku shumë i nderuar, z. Shaban (Aziz) Basha nga Prizreni, dhe kështu i bëri një shërbim të madh fjalës së shkruar. Autori.

153 *ANA BRITANICA, op. cit.*, fq. 175.



Copyrighted material

## Përfundim

Në përfundim shtrohet një pyetje logjike: A është Sari Salltëku një person apo janë më shumë, që janë identifikuar me këtë emër? Hulumtimet e studiuesve në terren na dëftojnë se ekzistojnë shumë varre Sari Salltëkësh. Na e merr mendja se Sari Salltëku ka ekzistuar e vepruar, dhe se pas vdekjes së tij këtë veprimtari e kanë vazhduar nxënësit dhe ithtarët e tij, pasi që varre me këtë emër hasim edhe në Bosnjë, Panoni, Turqi e në shumë vende të tjera. Mbetet që në studimet e ardhshme të studiohet dhe të ndahet historikja nga legjendarja e mitikja, të vlerësohet kontributi i tij dhe i nxënësve të tij në përhapjen e fjalës së Zotit, por edhe të shihet roli i tyre në krijimin e legjendave shqiptare me ndikim oriental.



Copyrighted material

# Summary

## Sari Salltuk and his role in spreading Islam in the Illyrian-Albanian and Balkan Territories before the XIV century

Theoretic research and also field work indicate that Sari Salltuk existed and carried out his activities during the XIII century in Anatolia and in Central Europe, but mostly in Illyrian-Albanian territories, whereas after his death these activities were continued by his pupils and disciples. This is verified by many graves with this name, which are to be found even today in Albanian territories, in Bosnia, Panonia, Turkey and in many other places. This subject should be studied more profoundly in the future; the historical should be separated from the legendary, reality from the mythical, and evalution made of his contribution and that of his pupils in spreading God's word. Also their role in the creation of Albanian legends with Oriental influence should be recognized, as well as their influence on both spoken and written literary creativity.



Copyrighted material

# Prejardhja, vendosja dhe roli i peçenegëve në përhapjen e Islamit në trojet iliro - shqiptare e në Ballkan (shekujt IX - XIV)

## Hyrje

Zhvillimi i vrullshëm dhe përhapja e shpejtë në sasi e cilësi e Bashkësisë muslimane (Ummetit) kulmoi me zgjerimin e kufijve të shtetit musliman në të gjitha anët. Prej tyre, shumë popuj e shumë grupe të mëdha prej tyre, të shtrënguara nga dhuna e ushtruar mbi ta nga popujt të tjerë të ndryshëm të asaj kohe, apo nga grupet e popujve të ndryshëm, pra të shtrënguar nga kushtet e vështira të jetës e në kërkim të kushteve më të mira për jetë, si pasojë e luftërave të vazhdueshme e shkatërrimtare, herë-herë të shtrënguar nga mbretërit e ndryshëm u detyruan të migronin, të lëviznin nga një vend në një vend tjetër.

Varësisht nga numri i tyre, varësisht nga shkalla e tyre arsimore e kulturore, popujt apo grupet e popujve në lëvizje e sipër, sillnin me vete besimin, kulturën, mënyrën e jetesës, besëtytnitë, kulturën e mirësjelljes, të ushqimit, të banimit e të punës, dhe ndikonin ndërsjelltazi tek njëri-tjetri, duke këmbyer vlera të ndryshme me kulturat në fërkim apo në bashkekzistencë. Me fjalë të tjera, me



Copyrighted material

kalimin e kohës zhvillohej procesi i akulturimit reciprok.[154]

Ndër popujt e tillë, që lanë vrragë e gjurmë gjatë pjesës më të madhe të Mesjetës, krahas hazarëve, kumanëve, bullgarëve, ilirëve - janë edhe peçenegët, historia e të cilëve është fare pak e studiuar dhe tejet e errët.[155]

## Prejardhja e peçenegëve dhe vendlindja e tyre e parë

Nuk e dimë saktë as domethënien e fjalës "peçeneg", as vendlindjen e tyre të parë. Të dhënat nuk janë të dorës së parë, ndaj disa pohime që pasojnë duhen pranuar me rezervë.

Në *Enciklopedinë Britanike* lexojmë se *"peçenegët (Petchenegs or Patzinaks (lat. Bisseni) janë popull në lindje të Evropës që në historinë mesjetare luajti rol të konsiderueshëm."*[156]

Historiani e filozofi anglez me famë botërore Th. W. Arnold, pohon se *"Peçenegët janë shpërngulur nga brigjet e Uralit nga fundi i shekullit IX, për t'u vendosur në tokat që*

[154] Shih: Barbara Jelavich, *Historia e Ballkanit*, I, Tiranë, 1999.

[155] Me gjithë rezultatet në hulumtimin dhe ndriçimin e periudhës së Mesjetës, shumë çështje nga kjo periudhë ende janë të errëta, jo mjaft të hulumtuara dhe të paraqitura në mënyrë jorelevante. Një ndër to është edhe populli peçeneg: prejardhja e peçenegëve, shtrirja gjeografike, aktiviteti i tyre në kontekstin kohor e hapësinor, besimi dhe niveli i tyre kulturor etj. Me këtë punim të shkurtër nuk pretendojmë t'u përgjigjemi të gjitha pyetjeve të mësipërme, sepse ky angazhim do t'i kapërcente mundësitë momentale, por do të përpiqemi që, në bazë të literaturës që disponojmë, çështjen e peçenegëve ta inicojmë për studime e hulumtime më të hollësishme. Një studim i mirëfilltë do të epte ndihmë edhe për ndriçimin te raporteve historiko-shoqërore të peçenegëve dhe popujve të tjerë të asaj kohe, si ilirët, bullgarët, pastaj sllavët e tjerë.

[156] *Encyclopaedia Britannica*, LTD, vol. XVII, op. cit., fq. 634.



Copyrighted material

*shtriheshin ndërmjet Danubit dhe Donit."*[157] Disa pohojnë se peçenegët janë popull me prejardhje turke,[158] të cilët rreth shekullit VIII jetuan rreth Detit Kaspik, kurse në shekullin IX depërtuan në Detin e Zi,[159], e sipas burimeve tjera jetuan në hapësirën ndërmjet Vollgës dhe Uralit.[160]

Udhëpërshkruesi i njohur mesjetar, hebren veriafrikan, Ibrahim ibn Ja'kubi, i cili më 965 vizitoi Pragën në Çeki, pohon se në vitin 965, fiset e mëdha veriore flasin sllavishten… me ç'rast përmend edhe badshnakët (d.m.th. peçenegët).[161]

Udhëpërshkruesi tjetër Ibn Dasta në veprën *"Libri i thesarit të çmueshëm"* në fillim të shekullit X pohon se *"ndërmjet vendit të peçenegëve dhe të sllavëve janë dhjetë ditë ecje në këmbë."*[162]

Sipas Laszlo Razinyo, peçenegët dhe kumanët nga viti 890 deri 1238 kanë jetuar në bashkësi me popullatën e Rumenit; ata njëkohësisht kanë qenë sundues të tyre."[163]

J. G. Herder në veprën e tij *"Ide për historinë e njerëzimit"* thekson se peçenegët, krahas popujve të tjerë si hazarët, avarët e të tjerë, kanë bërë mjaft në krijimin e Perandorisë Romake të Lindjes e pjesërisht dhe të Perëndimit,"[164] sigurisht duke menduar në ndihmesën e tyre ushtarake dhe aleancat e tyre herë lindore, herë perëndimore.

---

157 Karamasin, vol. I. p. 180-181, cituar sipas: Thomas W. Arnold, *"Povijest islama - Historijski tokovi misije"*, botimi III, Sarajevë, 1990, fq. 507.

158 *Encyclopaedia Britannica*, vol. XVII, op. cit., fq. 634. Maliq Osi, *Prizren drevni grad…*, Prizren, 1996, fq. 66.

159 Maliq Osi, *Prizren …*, fq. 66.

160 *Encyclopaedia Britannica*, vol. XVII, op. cit., fq. 634.

161 Marko Šunjić, *Hrestomatija izvora za opštu istoriju srednjeg vijeka*,Sarajevë, 1980, fq. 126, shën. 18.

162 Ibid., fq. 125.

163 Tuna Kopruleri, fq. 132, 112, sipas: M. Osi, fq. 84.

164 J. G. Herder, *Ide për historinë e njerëzimit*, Leipzig, 1868, vëll. III, fq. 90, sipas: Nelson Çabej (ed), *Autoktonia e Shqiptarëve në studimet gjermane*, Prishtinë, 1990, fq. 49.



Copyrighted material

Sipas *"Itinerarit"* të Benjamin di Tudel në shekullin XII, në Konstantinopolin e atëhershëm tregtonin tregtarët e të gjitha llojeve nga Babilonia, Persia, India, Egjipti, Kanania, Rusia, Hungaria, nga vendi i peçenegëve dhe hazarëve etj.[165]

Kurse Aleks Komneni peçenegët dhe kumanët i konsideron kushërinj.[166]

Sipas shkencëtarit të madh boshnjak N. Smailagiq *"Peçenegët qysh më 560 e. r. i hasim në siujdhesën e Krimesë, bashkë me hazarët dhe kumanët."*[167]

Kronistët e historianët arabë mendojnë se peçenegët kanë prejardhje arabe. Udhëpërshkruesi musliman nga Spanja / Andaluzia muslimane, Ebu Hamid El-Garnati, peçenegët i quan *"El-Megarib"* që d.m.th. *"marokenë"*.[168]

## Vendosja historike e peçenegëve në trojet iliro-shqiptare dhe në Ballkan

Rreth kohës së vendosjes së peçenegëve në Ballkan dhe në trojet iliro-shqiptare, kemi edhe mendime kontradiktore. Ky kontraversizëm mendoj se janë rrjedhim i një mosstudimi sistematik e konsistent të kësaj problematike, prandaj edhe ka mendime se peçenegët në Ballkan janë paraqitur në shekullin VIII, e disa të tjerë mendojnë

---

165 Shënim nga *Itinerari*, Dokumenti III, në: Marko Šunjić, *Hrestomatija izvora za opštu istoriju srednjeg vijeka*,Sarajevë, 1980, fq. 249.

166 Georges Castellan, *Histori e Ballkanit*, Tiranë, 1996, fq. 44. Sipas tij, Kumanët janë popull josllav, turk, nomad. Ibid., fq. 14.

167 Nerkez Smailagić, *Leksikon islama*, Sarajevë, 1990, fq. 600.

168 *Puteshestvie Abu Hamid al-Garnati*, pub. D. Bolshahova dhe A. Mongajta, Moskë, 1971, fq. 27, cituar sipas: Rade Božović, *"Arapi u usmenoj narodnoj pesmi na srpskohrvatskom jezickom podrucju"*, Beograd, 1977, fq. 183. (Disertacion doktorate i autorit).



Copyrighted material

se janë paraqitur nga fundi i shekullit IX. Disa të tjerë shkojnë edhe më tutje dhe paraqitjen e peçenegëve e shtyjnë në shekujt e mëvonshëm.

Në mbështetje të provave historike, quajmë se hulumtuesit që paraqitjen e peçenegëve në Ballkan e vënë në shekullin VIII kanë më shumë të drejtë. Këtë e themi për arsye se formimi i *temave* (njësive administrative bizantine) filloi nga fundi i shekullit VIII, kurse peçenegët, po ashtu, i hasim në këtë kohë, pikërisht të kufizuar në jug me Temën e Maqedonisë, Strumës, në veriperëndim me sllavët, në lindje me Detin e Zi, në veri me hungarezët e Bizantin e të tjera.[169] Të dhënat dëftojnë se peçenegët, por edhe popujt e tjerë, pas ardhjes në Bullgari, Maqedoni dhe vende të tjera të Ballkanit kanë formuar qytetet dhe fshatrat e tyre.[170]

Në të mirë të pohimit se peçenegët u vendosën në Ballkan në shekullin VIII e IX, shkon edhe e dhëna që e shtroi G. Ostrogorski, i cili thotë se "Uçët, nën presionin e kumanëve në vitin 1064, sikur më herët peçenegët nën presionin e uçëve, kaluan në Ballkan",[171] që na jep të kuptojmë se ky kalim i peçenegëve do të ketë ndodhur nga fundi i shekullit VIII dhe gjatë shekullit IX.

Historiani e kulturologu - etnologu i njohur boshnjak M. Haxhijahiq, megjithatë paraqitjen e peçenegëve në Ballkan e vë nga gjysma e shekullit XI.[172] Po këtë e pohon edhe M. Spahiq, boshnjak, duke thënë se "paraqitja e muslimanëve – peçenegëve, ismailitëve dhe agarenëve në gjysmën e shekullit XI në Ballkan, nga qyteti i

---

169 Grup autorësh, *Historia e popullit shqiptar*, I, botimi III, Prishtinë, 1979, fq. 148-149. Po aty shih kartën III, fq. 148. Krahaso: Miroslav Brandt, *Srednjovjekovno doba povijesnog razvitka*, I, Zagreb, 1980, fq. 559.

170 Shih: Maliq Osi, op. cit., fq. 84.

171 Georges Ostrogorski, Historia e Perandorisë Bizantine, Tiranë, 1997, fq. 241.

172 Muhamed Hadžijahić i drugi, *Islam i muslimani u Bosni i Hercegovini*, Sarajevë, 1977, fq. 24 - 25.



Copyrighted material

bullgarëve në Vollgë, duke e populluar Hungarinë dhe Sllavoninë.[173]

Disa hulumtues rusë mbajnë qëndrimin se "*aradhat e para të peçenegëve janë paraqitur në Hungarinë fqinje në shekullin X*"[174]. Kjo, po ashtu, vërehet edhe nga fakti se cari bullgar, Simeoni, peçenegët i shfrytëzoi për mbrojtje kundër hungarezëve, po në këtë kohë, në shekullin X.[175]

Pohimin e mësipërm e ndeshim edhe te G. Ostrogorski, i cili pohon se "Simeoni, i shtrënguar nga Bizanti dhe hungarezët, iu drejtua për ndihmë popullit luftarak nomad të peçenegëve të ultësirës së Rusisë jugore. Me ndihmë të peçenegëve arriti t'i mundte hungarezët ... korri fitore kundër Bizantit në vitin 896.[176]

Të dhënat e tjera na dëshmojnë se "nën presionin e hazarëve dhe peçenegëve, hungarezët në vitet e gjashtëdhjetë të shekullit IX shkuan edhe më larg drejt Perëndimit.[177]

Peçenegët sipas hulumtuesve rusë, që në shekullin XI në numër të madh i lëshojnë stepat ruse dhe u vendosën në Hungari dhe në Bizant.[178] Sipas disa të dhënave të tjera, krahas peçenegëve në Ballkan u vendosën edhe muslimanë arabë e bullgarë.[179]

Gjeografi e shkencëtari musliman nga Spanja, El-Bekri (shek. XI), na sjell të dhëna me rëndësi kapitale,

---

173 Mustafa Spahic, *Povijest islama*, vëll. IV, Sarajevë, 2000, fq. 136.

174 *Puteshestvie Abu Hamid al-Garnati*, *op. cit.*, fq. 97; Gy. Szekely, *Les contacts entre Hongrois et Musulmans aux IX-XII siècles*, nga libri *The Muslim East*, Budapest, 1974, cituar sipas: R. Božović, *op. cit.*, fq. 183.

175 Ibid

176 G. Ostrogorski, op. cit., fq. 175.

177 Miroslav Brandt, fq. 249.

178 *Puteshestvie Abu Hamid al-Garnati*, *op. cit.*, fq. 97; Gy. Szekely, *Les contacts entre Hongrois et Musulmans aux IX-XII siècles*, nga libri *The Muslim East*, Budapest, 1974, cituar sipas: R. Božović, *op. cit.*, fq. 183.

179 V. Klaić, *Slike iz slavenske povijesti*, Zagreb, 1903, fq. 497, cituar sipas: Rade Božović, op. cit., fq. 183.



Copyrighted material

duke i përshkruar peçenegët në Ballkan si etnitet me rëndësi dhe përmend faktin e kalimit të një misioni nëpër Kroaci për në Evropën Lindore, ku gjenden të dhëna se fqinjët e sllavëve - gjermanët, peçenegët e silezianët i njohnin gjuhët sllave.[180]

Në anën tjetër, shkencëtari Lj. Hauptman thekson se ka sinjale qysh para vitit 948 që dëftojnë për fqinjësinë kroato-peçenege.[181]

Praninë e peçenegëve e hasim edhe nga të dhënat onomastike, antroponimike e toponimike, kur krahas emrave *Andrea Saracenus, Cumanus, Sracino, Sarachinus,* hasim edhe emrin *Peçenegus* nëpër vendet tona, që tregojnë, pos të tjerash, edhe lidhjet me arabët muslimanë.[182]

## Aktiviteti ushtarak dhe lëvizjet e tjera peçenege në trojet iliro-shqiptare e në Ballkan

Rrethanat politike - shoqërore e kulturore - fetare që nga koha e paraqitjes së popullit peçeneg e deri në fikjen (asimilimin) e tyre nga skena historike, ishin në shenjë të lëvizjeve, ngritjeve dhe rënieve të shumë popujve e perandorive. Iliria, Bullgaria, Maqedonia, Bizanti, Thrakia, Greqia e të tjera nga shekulli VII e deri në shekullin XIII, qoftë ndërmjet vetes, qoftë të goditura nga sulmet e shpeshta e të furishme të fiseve sllave, avare, bullgare,

---

180 Tadeusz, *Zdrola arabskie do dziegow slowianszczyny,* I, Wroclaw - Warszawa - Krakow, 1956, 1969, fq. 121, cituar sipas: R. Božović, *op. cit.* fq. 183.

181 Lj. Hauptman, *Seoba Hrvata i Srba,* Jugoslovenski istoriski časopis, III, 1-4, 1937, fq. 35, cituar sipas: R. Božović, *op. cit.*, fq. 183.

182 Konstantin Jireček, *Die Romanen in den Stadten Dalmatiens des Mittelalters,* 1, Teil Wien, 1902, cituar sipas: R. Božović, *op. cit.*, fq. 183.



Copyrighted material

vllahe, peçenege, oguze, kumane, - u shkretëruan në masë të konsiderueshme.[183]

Për ta paraqitur më qartë këtë gjendje, do të përpiqemi që peçenegët t'i vendosim në raport të drejtpërdrejtë me popujt kryesorë të asaj kohe, ndonëse një qasje e tillë ka rrezikun e përsëritjes së disa të dhënave.

## Peçenegët dhe rusët

Kontaktet dhe lidhjet e para tregtare e ushtarake peçenego-ruse i hasim herët.[184] Nuk kemi datë të saktë, por historikisht duket se lidhjet e para ndodhën rreth shekullit VIII, kur peçenegët jetuan rreth detit Kaspik, kurse në shekullin IX depërtuan rreth Detit të Zi.[185] Historiani i njohur kroat M. Brandt, njohës i mesjetës, pohon se në dhjetëvjeçarin e gjashtë të shekullit IX Rusia e Kievit ka luftuar me Bizantin, por edhe me peçenegët e me popuj të tjerë,[186] kurse nga fundi i shekullit IX stepat rusojugore nën pushtetin e tyre i mbanin peçenegët, të cilët deri në shekullin XI paraqitnin rrezikun kryesor për rusët e Kievit.[187] Nga gjysma e dytë e shekullit IX, në rrethana të pasqaruara, të mjegulluara, e mbase me nxitje të Bizantit, ndodhi sulmi ndaj Kievit i peçenegëve, që atëherë ishin në stepën ndërmjet Donjecit dhe Bugit jugor. Në këtë luftë peçenegët pësuan humbje.[188] Në këtë periudhë kemi luftëra të vazhdueshme. Kështu, më 867 knjazi Askoldi

---

[183] Për luftërat peçenege lexo: *Encyclopaedia Britannica,* LYD, vol. XVII, fq. 692 – 693; Ibid., vol. VI, fq. 858 – 859. Shih: Skender Rizaj, *Shqiptarët dhe Serbët në Kosovë,* Prishtinë, 1991, fq. 10, 14; G. Ostrogorski, *op. cit.,* , fq. 241.
[184] Shih: Marko Šunjić, *op. cit.,*fq. 249.
[185] Maliq Osi, op. cit., fq. 66.
[186] Miroslav Brandt, *Srednjovjekovno doba povijesnog razvitka,* I, Zagreb, 1980, fq. 552.
[187] Ibid., fq. 567.
[188] Ibid., fq. 559.



Copyrighted material

luftoi kundër peçenegëve që në atë kohë vinin në trojet e Donit dhe Donjecit të mesëm.[189] Më 969 Svjatosllavi, që atë kohë luftonte në Bullgari, përkohësisht u kthye që të zbrapste sulmet peçenege ndaj Kievit.[190]

Luftërat e ndërsjella peçenego-ruse ishin të shpeshta me suksese relative herë për njërën palë, herë për palën tjetër. Më 1019 peçenegët humbin nga Kievi.[191] Më 1036 përsëri peçenegët pësuan humbje në muret e Kievit nga princi i Kievit, Jarosllavi i Urtë. Në shenjë të kësaj fitoreje, Rusia ndërtoi Kishën e Shën Sofisë në Kiev, e në anën tjetër ndihmoi mjaft në zhvillimin e tregtisë së lirë.[192]

Është me vlerë të theksohet se peçenegët nuk ishin vetëm në armiqësi me rusët, por edhe në aleancë ushtrish apo një pjesë e peçenegëve atëbotë ishte në përbërje të shtetit rus. Kështu, më 943 princi rus Igor, në ushtrinë e vet kishte rusë e peçenegë.[193]

## Peçenegët dhe bizantinët

E theksuam se nga shekulli VII e tutje Perandoria Bizantine ishte e rrezikuar nga disa anë dhe nga disa fise e popuj. Peçenegët janë ndër popujt më aktivë për disa shekuj në Ballkan, që kanë ndikuar në fatin e tij. Fillimisht, luftërat bizantino- peçenege u zhvilluan jashtë Ballkanit, e më vonë ato u zhvilluan edhe në vetë Ballkanin.[194] Nga shumë burime lexojmë se Bizanti nga Veriu ishte i shtrënguar nga peçenegët, dhe kjo do të vazhdonte për shumë shekuj.[195] Kështu, gjatë kohës së Teofilit

---

[189] Ibid., fq. 552.
[190] Ibid., fq. 439.
[191] Ibid., fq. 564.
[192] Ibid., fq. 566; Maliq Osi, op. cit., fq. 66.
[193] G. Ostrogorski, op. cit., fq. 187.
[194] Skender Rizaj, *Shqiptarët dhe Serbët*, op. cit., fq. 10 – 14.
[195] Grup autorësh, *Historia e popullit shqiptar*, I, botimi III, Prishtinë, 1979, fq. 161 dhe 169.



Copyrighted material

(829-842), ndonëse Bizanti ishte forcuar ekonomikisht, bënte shpenzime në luftërat në Krime me bullgarët, pastaj në luftërat me peçenegët dhe rusët, të cilët i dëmtonin interesat bizantine dhe me abasinjtë nga Lindja.[196] Në vitin 969 kemi sulmin peçeneg mbi Bizantin.[197]

Konfliktet ushtarake bizantino-peçenege vazhduan me intensitet të lartë edhe në shekullin XI. Kështu, më 1064, peçenegët hyn në koalicion me fiset e afërta të uçëve dhe rrezikuan Perandorinë Bizantine.[198] Më 1049, 1050 dhe 1051 gjejmë luftime të rrepta bizantino-peçenege, me fat luftarak relativ. Mirëpo, në këtë kohë peçenegët hynin në Maqedoni e Traki, e madje deri në Konstantinopol, pa frikë, sipas Franjo Raçkit *"duke plaçkitur e shkretëruar."* [199] Pra, siç dëftojnë burimet historike, peçenegët janë ndër ata popuj që provuan, por nuk arritën ta pushtonin Konstantinopolin.[200] Mirëpo, nga viti 1052 peçenegët i gjejmë më pasivë. Kjo nuk i mjaftoi mbretit Konstantin, i cili mblodhi ushtarë nga Lindja e Perëndimi për t'i sulmuar. Udhëheqjen e ushtrisë ia besoi patrikut Mihajlo dhe Vasiliut bullgar. Kagani Tyrak kuptoi për përgatitjet e Bizantit dhe filloi të përgatitet, duke zënë pozitat strategjike. Pavarësisht nga sulmet e rrepta dhe rrethimi që ua bënë, peçenegët nuk u dorëzuan. Në të kthyer, ushtria greke u sulmua anash dhe u shpartallua, Vasiliu vdiq, kurse Mihajlo mezi shpëtoi dhe iku. Pas kësaj lufte u lidh paqe trevjeçare.[201]

Sipas të dhënave që ofron P. Thëngjili, në vitin 1085 ndodhën konflikte të armatosura ndërmjet Bizantit, në

---

196 M. Brandt, op. cit., fq. 337 – 338; Grup autorësh, *Historia e popullit shqiptar*, I, bot. III, fq. 161 dhe 169.
197 G. Ostrogorski, op. cit., fq. 195.
198 G. Ostrogorski, op. cit., fq. 241.
199 Franjo Rački, *Borba Južnih Slavena*, fq. 132 – 133.
200 M. Osi, op. cit., fq. 59.
201 Franjo Rački, *Borba Južnih Slavena*, fq. 133.



Copyrighted material

një anë dhe normanëve e peçenegëve, në anën tjetër.[202] Pasi e largoi rrezikun nga normanët, Bizanti filloi edhe një luftë kundër peçenegëve, të cilët me vite po i rrinin si shpata e Damokleut mbi qafë. Gjendja u acarua edhe më shumë pasi hordhitë peçenege kishin gjetur përkrahjen e bogumilëve. Kriza ndërmjet Bizantit dhe peçenegëve arriti kulmin, kur pas luftimeve të shumta, më 1090, peçenegët iu afruan mureve të Konstantinopolit. Po atë kohë, në vitin 1090, me peçenegët lidhën aleancë edhe muslimanët e kalifatit islam, të cilët iu afruan Konstantinopolit me flotë nga deti dhe e rrethuan atë.[203]

I shtrënguar nga luftërat e shpeshta me peçenegët, Bizanti, Aleks Komneni, i ftoi dhe i hodhi kumanët në luftë kundër peçenegëve, siç ceket në disa burime, pra, kundër kushërinjve të tyre.[204] Lufta ndodhi më 29. 04. 1091, dhe sipas G. Ostrogorskit, *"Peçenegët u vranë deri tek i fundit."* [205] Ana Komnena këtë ngjarje e përshkruan në mënyrë dramatike: "Një popull i tërë, që llogaritej me dhjetëra mijëra njerëz, u shua në një ditë të vetme."[206]

Pas tri dekadash, më 1122, një mori e re peçenegësh kaluan Danubin dhe u shtrinë në Maqedoni e Traki, duke plaçkitur e shkretëruar ngado që shkelnin. Mirëpo, në luftën e vitit 1122 peçenegët humbën luftën. Ka mendime se pas luftës së vitit 1122 peçenegët nuk ekzistonin më si tërësi etnike, po u tretën në fise të tjera mongolo-tatare, duke u shndërruar në robër.[207]

Siç shënohet në disa burime, kjo luftë ishte e fundit për peçenegët, sepse Jovani II, pasi ngadhënjeu ndaj peçenegëve, robërit i vendosi nëpër provinca si ushtarë.[208]

---

[202] Petrika Thëngjilli, *Historia e Popullit shqiptar*, Tiranë, 1999, fq. 82.
[203] Shih: G. Ostrogorski, op. cit., fq. 256.
[204] Georges Castellan, op. cit., fq. 44.
[205] G. Ostrogorski, op. cit., fq. 257.
[206] Ibid., fq. 257.
[207] G. Ostrogorski, op. cit., fq. 267; M. Osi, op. cit., fq. 67 dhe 127.
[208] G. Ostrogorski, *Istorija Vizantije*, Beograd, 1959, fq. 355 – 367.



Copyrighted material

## Peçenegët dhe hungarezët

Burimet historike shënojnë se në shekullin X e XI peçenegët, pos rusëve e bizantinëve, patën sulmuar edhe hungarezët. Hungarezët nga presioni i tyre u detyruan të iknin drejt Perëndimit dhe të vendoseshin ndërmjet Dnjeprit, Karpateve dhe Danubit të poshtëm,[209] përkatësisht u vendosën në hapësirat që, pak a shumë, i banojnë hungarezët edhe sot.[210]

Nga burimet e tjera lexojmë se hungarezët nëpër Karpate ikën drejt Panonisë në vitin 896, sepse u sulmuan dhe humbën luftën kundër Simeonit bullgar, Bizantit por edhe kundër peçenegëve.[211]

Madje, konsiderohet se një kohë peçenegët kanë qenë faktor politik edhe në Hungari, sepse me ta zyrtarisht në Hungari komunikonte edhe Bizanti.[212]

Shkencëtari boshnjak, që jeton e vepron në Holandë, Salih Haxhialiq, sjellë të dhëna se peçenegët në Hungari në shekullin X kryenin punë tregtie, të zejeve e bujqësie. Për ta thuhet se kanë ardhur nga Lindja dhe kanë pasur status të veçantë, të njohur e të mbrojtur me ligj si mysafir (hospites).[213]

Peçenegët ose beslenjevët, si njihen në disa burime, në Hungari i gjejmë si grupin e tretë muslimanë me rëndësi, që erdhën nga rrethi i Kievit të tanishëm. Gjeografi arab

---

209 M. Brandt, op. cit., fq. 428; G. Ostrogorski, op. cit., fq. 175.

210 G. Ostrogorski, op. cit., fq. 175.

211 M. Brandt, op. cit., fq. 428; G. Ostrogorski, op. cit., fq. 175.

212 J. Ferluga, *Vizantijsko carstvo i južnoslovenske države od sredine IX do sredine X veka*, Zbornik radova Vizantološkog Instituta, knjiga XIII, Beograd, 1971, fq. 84, cituar sipas: Rade Bozović, op. cit. fq. `83.

213 Peçenegët (lat. Bisseni, Bysseni ose Besseni; hung. Bessenyő pl. Bessenyők) në Hungari qenë të njohur e të mbrojtur me ligj, sikur edhe Hazarët, Bullgarët nga Vollga, Kumanët, Horezmianët (Hvalisët, Kalisët), Saracenët etj. Shih: Salih Hadzialic, *Manihejska proslost srednjovjekovne Bosne*, Islamska misao, nr. 143/1990, Sarajevë, fq. 10.



Copyrighted material

Ebu Ubejd el-Bekr në veprën *"Libri i rrugëve dhe vendeve"* shkruan se ndërmjet viteve 988 dhe 997 peçenegët qenë islamizuar nga predikuesit muslimanë në Hungari, Horezmianët,[214] të cilët në Hungari i kemi qysh më herët. Më vonë, në vitin 1036, Jarosllavi i Urtë, mbreti kievas, i ngadhënjeu peçenegët në një beteje, të cilët pas kësaj lufte i kemi të ndarë: një pjesë menjëherë migroi në Hungari, kurse 13 fise të mbetura formuan shtetin e tyre në hapësirën e Bullgarisë së sotme. Mirëpo, ekzistimi i këtij shteti assesi nuk ishte në harmoni me interesat e fqinjit të madh, Perandorisë Bizantine. Bizanti angazhoi forca të mëdha dhe e shkretëroi këtë shtet në vitin 1120. Pas kësaj humbjeje, thuajse të gjitha fiset peçenege u shpërngulën në Hungari. Se ky ishte grupim tejet i madh i muslimanëve në Hungari, mbase edhe më i madhi, dëshmon e dhëna se kemi rreth 150 emërtime gjeografike në lidhje me peçenegët në Hungari.[215]

## Peçenegët dhe bullgarët

Kontaktet e para peçenego - bullgare në trojet iliro-shqiptare e në Ballkan i hasim qysh në shekullin IX e më pas, varësisht nga sukseset ushtarake të njërës apo të tjetrës palë. Qëndron konstatimi i F. Raçkit, se në fatin e Ballkanit rol të rëndësishëm ka luajtur populli peçeneg. Këtë e pamë edhe në raport me popujt e tjerë të asaj kohe, por ngjashëm ishte edhe në raport me bullgarët, herë si palë rivale, e herë si palë aleate. Kështu, bullgarët për shkak të konflikteve të herëpashershme me Bizantin, kanë zhvilluar bisedime për paqë me hungarezët, peçenegët dhe me knjazin serb Petar Gojkinoviq[216].

214 Sipas: *Islam u Madžarskoj*, Islamska misao, nr. 143/ 1990, Sarajevë, fq. 57.
215 Ibid.
216 M. Brandt. Op. cit., fq. 429.



Copyrighted material

Temat ballkanike të Bizantit në shekullit XI nuk ishin të qeta, pos të tjerash, edhe për shkak të veprimtarisë peçenege. Një vit pas vdekjes së perandorit bizantin Vasiliu II, më 1026, peçenegët kaluan Danubin në Bullgari, dhe sipas F. Raçkit, "shumë njerëz, vojvodë e çeta i mbytën dhe i robëruan."[217] Arkondi i Sremit Konstantin Diogeni iu kundërvu këtij sulmi dhe vetëm pas disa betejave peçenegët u larguan përtej Danubit. Pas kësaj lufte, peçenegët disa vjet pushuan nga aktivitetet ushtarake, kurse robërit i kthyen me shpërblim.[218] Por, sërish, më 1032, peçenegët i gjejmë në Bullgari.[219]

Edhe gjatë viteve 1048 – 1054 populli bullgar përjetoi shumë tmerre nga peçenegët. Në këtë kohë bullgarët ishin në anën e Bizantit.[220]

Se çështja e Ballkanit nuk ishte problematike aktualisht, e tregon edhe fakti historik vijues: Tiraku dhe Kegeni ishin princër bullgarë. Për shkak të rivalitetit të skajshëm në mes tyre. Kegeni u largua nga Bullgaria dhe hyri në shërbim të carit bizantin, Konstantini IX. Ky së pari e pagëzoi Kegenin dhe si kundërshpërblim ia dha në administrim dy qytete në bregun e Danubit dhe shumë toka të tjera, por edhe monakun Evthimi, që t'i pagëzonte peçenegët që në numër të madh ishin aty. Pas shumë luftimeve që zhvilloi Kegeni me çetat e veta kundër peçenegëve, i theu dhe ngadhënjeu ndaj tyre.[221]

## Peçenegët dhe serbët

Në kohën bizantine peçenegët i hasim si element etnik edhe përgjatë kufirit të atëhershëm serb. Perandori

217 Franjo Rački, op. cit., fq. 113.
218 Ibid., fq. 114.
219 Ibid., fq. 114.
220 Ibid., fq. 133.
221 Shih: Ibid., fq. 131.



Copyrighted material

bizantin Aleksije, pasi i mundi ushtarakisht peçenegët, i vendosi në të gjitha rrugët, duke i detyruar të bënin shërbim ushtarak. K. Jireçeku konsideron se toponimet – emrat vendorë të fshatit *Peçeneg* në Gruzh dhe *Peçenovci* tek Leskovci në Serbi janë dëshmi të pranisë peçenege të asaj kohe.[222]

Në shekullin XIV, në kohën e car Dushanit, peçenegët përmendeshin ende aktivë, por inferiorë. Car Dushani vendosi në afërsi të Prizrenit 3000 peçenegë, kurse si dëshmi kemi toponimet – emrat e fshatrave Peçan në Suha Rekë dhe Peçenoviq në Prizren.[223] Në Fermanin e Stefan Dushanit lexojmë të dhënën se peçenegu – turku – tatari, me emrin Basaraba, është kryekomandanti i Kara-Tatarëve në betejën e Velbuzhdit, në vitin 1330,[224] që dëshmon se peçenegët kanë qenë aktivë deri vonë.

Se populli peçeneg ka luajtur rol me rëndësi edhe në shekullin XIV në Ballkan, tregojnë edhe të dhënat se "gjatë kohës së mbretit Stefanit II (peçenegët – N. I.) kishin pozita të privilegjuara në pallat."[225]

## Peçenegët dhe shqiptarët

Ndonëse peçenegët veprimtarinë e tyre ushtarake e kulturore në Ballkan e zhvilluan kryesisht në territoret iliro-shqiptare, ata i hasim fare pak në raporte të drejtpërdrejta. Kjo është pasojë e faktit se shqiptarët me shekuj ishin të pushtuar nga popuj të ndryshëm. Dhe të gjitha marrëveshjet ushtarake, tregtare e kulturore, ndonëse në trojet iliro-shqiptare, lidheshin me pushtuesit e iliro-

[222] Konstantin Jireček, Istorija Srba, I, Beograd, fq. 124.
[223] M. Osi, op. cit., fq. 126.
[224] Konstantin Jireček, Istorija Srba, I, Beograd, fq. 110.
[225] Rade Božović, op. cit., fq. 183.



Copyrighted material

shqiptarëve e jo me vetë iliro-shqiptarët. Megjithatë, kemi ca fërkime, direkte dhe indirekte.

Shqiptari i parë në hierarkinë bizantine përmendet nga Skilices – Kedrenosi, në vitin 1001, në kohën e sundimit arab mbi Kolesirinë. Në këtë dokument shkruhet: "Perandori do të kishte hequr Niqifor Uranasin nga qeverisja e Selanikut dhe do ta zëvendësonte atë me Patricin David Arjanitin."[226]

Në vitin 1050 përmendet edhe një Arjanit i dytë në fushatë kundër peçenegëve.[227] Në dokumentet bizantine, kemi edhe një ushtarak shqiptar në rangjet e larta ushtarake bizantine me mbiemrin Komiskarti nga Arbanasi,[228] që konsiderohet të ketë vepruar kundër peçenegëve.

Duke e marrë parasysh shtrirjen gjeografike të peçenegëve dhe të iliro-shqiptarëve, mendojmë se kontaktet e ndërsjella kanë ekzistuar dhe në fushë të fesë, kulturës, civilizimit, tregtisë, të kontakteve ushtarako-diplomatike, e jo vetëm në fushën ushtarake, ndonëse këto të fundit janë më të studiuarat dhe në pajtim me këtë realitet edhe më të theksuarat.

Perandori bizantin më herët i theksuar, Konstantini IX, i shtrënguar prej rreziqeve nga të huajt dhe veçanërisht nga turqit, angazhoi 15.000 peçenegë dhe i armatosi ata kundër turqve. Mirëpo, peçenegët këtë luftë nuk e shihnin si të veten dhe shfrytëzuan rastin e ikën në drejtim të Prizrenit, në Sredskë, te pjesa tjetër e peçenegëve, më herët të vendosur aty. Të unifikuar e të nxitur nga rreziku që u kanosej, ata kaluan në hakmarrje ndaj sunduesve dhe për një kohë sundonin në gjithë Ballkanin.[229]

---

[226] *Dokumente të periudhës bizantine për Historinë e Shqipërisë*, Tiranë, 1978, fq. 87, sipas: Irakli Koçollari, *Arvanitët*, Tiranë, 1996, fq. 15.

[227] Irakli Koçollari, *op. cit.*, fq. 15.

[228] Kostas Biri, *Arvanitas-i tori tu neoteru elenizmu*, Athina, 1967, sipas: Irakli Koçollari, op. cit., fq. 11.

[229] Franjo Rački, op. cit., fq. 131.



Copyrighted material

Të dhënat vijuese argumentojnë edhe më shumë të dhënat e mësipërme. Me urdhrin e vojvodës bullgar Vasiliut, pas humbjeve të peçenegëve nga Bizanti dhe Bullgaria në shekullin X e XI, peçenegët e mbetur u vendosën në zonat e Sredskës në Prizren, të Nishit dhe të Ovçepoljes në Serbi.[230]

Faktet e mësipërme do t'i ilustrojmë dhe argumentojmë edhe me disa emra, patronime që rrjedhin nga Mesjeta e re, nga periudha parasllave e sllave në Prizren e të tjera, që i kanë qëndruar kohës, me prejardhje peçenege, kumane e kipçake si: Ballabani dhe Bilibani, Tatari, Coplan, Gurban, Kara, Karaba, Kuman, Shishman, Tokman, Caqan, Babun etj.[231] Këto fakte tregojnë praninë peçenege në Prizren e Kosovë një kohë të gjatë.

## Peçenegët dhe popujt e tjerë

Prania e peçenegëve në Ballkan e Evropë bëri që ata të ndesheshin si aleatë apo rivalë, si sundues apo të sunduar, me popuj të ndryshëm, pos atyre që cekëm më lart. Kështu, peçenegët i hasim nëpër tërë Ballkanin lindor, Sllavoni e Kroaci,[232] Traki e Maqedoni[233], Rumani[234] e madje edhe në Poloni.[235]

Këto raporte mbesin të hulumtohen.

---

[230] Ibid.
[231] M. Osi, op. cit., fq. 86.
[232] M. Spahić, op. cit., fq. 136; M. Osi, op. cit., fq. 126.
[233] M. Osi, op. cit., fq. 67.
[234] M. Barndt, op. cit., fq. 567.
[235] Ibid., fq. 564.



Copyrighted material

## Peçenegët dhe besimi e kultura e tyre islame

Depërtimi i peçenegëve dhe i popujve të tjerë në Ballkan dhe prania e tyre me shekuj të tërë, solli edhe disa ndryshime të caktuara etnike, konkretisht në viset në veri të Nishit të sotëm, në Danub.[236] Këtë e thekson në njëfarë mënyre edhe K. Jireçek.[237]

Udhëpërshkruesit e shekullit XI e XII flasin se ato vise të pasura bujqësore ishin kryesisht të shkreta, ku si të vetmit banorë i gjejmë "cubat e popullit endacak", duke shtuar se ata "bëhen synet (cirkumizohen)."[238] Krahas këtyre ndryshimeve të caktuara etnike, ardhja dhe vendosja e peçenegëve në Ballkan dhe Evropë gjatë mesjetës solli ndryshime të caktuara edhe në sferën e fesë si botëkuptim jete, në sferën e traditave politiko-shoqërore, tregtare etj. Vilijem Tirski shprehimisht pohon se këta janë peçenegët.[239]

Historiani, kulturologu e etnologu i njohur boshnjak M. Haxhijahiq pohon se peçenegët ishin muslimanë, që provohet edhe nga burimet e tjera. Sipas tij, nga të tjerët, peçenegët janë quajtur edhe ismailitë, pastaj edhe agarenë.[240]

Ekzistojnë mendime se peçenegët duke e komprometuar islamin dhe muslimanët e mirëfilltë, në vitin 1048 e 1049 kanë vrarë e plaçkitur nëpër tërë Ballkanin lindor. Udhëpërshkruesit sllavë flasin me plot pezm për peçenegët si "tiranë", "të paligjshëm" dhe "të pafe".[241]

Orientalisti serb Rade Bozhoviq në disertacionin e tij, sikur edhe shumë studiues të tjerë botërorë, pohon:

---

236 M. Hadžijahić, *Islam i muslimani…*, op. cit., fq. 26.
237 K. Jireček, *Istorija Srba,* II, Beograd, 1952, fq. 154.
238 M. Hadžijahić, *Islam i muslimani…*, op. cit., fq. 26.
239 Sipas: Ibid., fq. 26.
240 Sipas: Ibid., fq. 24 –25; M. Spahić, *Povijest islama,* IV, op. cit., fq. 136.
241 M. Hadžijahić, *Islam i muslimani…*, op. cit., fq. 24 - 25.



Copyrighted material

"Peçenegët muslimanë janë bartës të mundshëm të kulturës arabo-islame në Ballkan", [242] që të vazhdojë e të pohojë se: "E duke e marrë parasysh arsimimin e tyre të shkëlqyeshëm, që shumë historianë e theksojnë, gjithsesi kanë qenë bartës adekuatë të kulturës dhe natyrës arabo-islame.[243]

K. Jireçeku dhe në mbështetje të tij M. Osi, thekson se me anë të peçenegëve në Ballkan është përhapur herezia e besimeve të tjera aziatike – manikeizmit, paulicianizmit dhe mesalianizmit, së pari në Traki e Maqedoni e pastaj në Serbi e më gjerë.[244] Ndërsa Vikli kur përshkruan peçenegët dhe jetën e tyre endacake, pohon se "kanë jetuar nëpër tenda dhe kanë sulmuar herë këtë territor e herë atë territor të fqinjëve." Sipas tij, hordhitë peçenege "derdheshin nëpër krahinat e afërta, duke marrë e shkatërruar çdo gjë që u vinte në dorë." Më tej pohon se armikun "ose e vrisnin, pa marrë parasysh moshën, ose e robëronin dhe e torturonin," të rriturit i mbytnin, gratë dhe fëmijët i burgosnin, digjnin dhe i shkretëronin."[245] Mirëpo, këto pohime duhen shikuar në prizmin e kohës kur kanë jetuar e vepruar me tërë atë që nënkupton Mesjeta.

## Zhdukja e peçenegëve nga skena historike

A ekzistojnë sot peçenegët? Përgjigjja më e drejtë do të ishte se sot peçenegë nuk ka, por ekzistojnë gjurmët e tyre. Ardhja e Perandorisë Osmane në Ballkan nuk e gjeti këtë popull si musliman masivisht, madje as gjurmë të

---

[242] Rade Bozović, op. cit., fq. 183.
[243] Ibid., fq. 183.
[244] K. Jireček, op. cit., II, fq. 254; dhe M. Osi, op. cit., fq. 67.
[245] Franjo Rački, op. cit., fq. 133.



Copyrighted material

dukshme të tyre, së paku jo sipas arritjeve shkencore të deritashme. Luftërat kundër Bizantit, hungarezëve, bullgarëve, serbëve dhe popujve të tjerë kanë qenë fatale për ta, kështu që peçenegët humbën nga skena historike ballkanike, duke u shfarosur, asimiluar apo duke u shpërnguluar në drejtime të tjera.

K. Jireçeku konsideron se "me ardhjen e Turqisë, pjesa më e madhe e peçenegëve kalon në Islam, e pjesa tjetër në kristianizëm.[246] Kurse Georges Castellan mendon se "Gagauzët, pasardhës të peçenegëve, u konvertuan në krishterim dhe mund të ndeshen rreth Varnës."[247]

Të panjohurat, pak të njohurat, por edhe të njohurat për ta duhet të hulumtohen edhe më tej, historikisht të valorizohen dhe opinionit shkencor dhe atij të përgjithshëm t'i prezentohen në të ardhmen.

[246] K. Jireček, op. cit.,II, fq. 254.
[247] Georges Castellan, op. cit., fq. 23.



Copyrighted material

## Përfundim

Paraqitja e peçenegëve në Ballkan dhe në trojet iliro-shqiptare për disa shekuj, qoftë si forcë dominuese ushtarake, qoftë si të mundur nga të tjerët, si popull endacak si i quajnë disa nga paragjykimet, solli me vete edhe paraqitjen e Islamit në këto troje, në mënyrë masive, të qëndrueshme dhe, sipas shumicës dërrmuese të fakteve nga fundi i shekullit VIII e mbrapa, herë në ngritje e herë në rënie.

Sipas të dhënave nga burimet bizantine, serbe etj., peçenegët zotëronin arsimim e kulturë të lartë islame dhe me të drejtë mund të quhen pishtarë të Islamit në këtë pjesë të Ballkanit dhe në trojet iliro-shqiptare veçanërisht. Këtë konstatim nuk e ulin as insinuatat e vlerësimet e kundërshtarëve të tyre kristianë e paganë se peçenegët janë "të pafe", se "cirkumizohen", se janë shkatërrues e shkretërues.

Aktiviteti ushtarak, por edhe fetar, kulturor e civilizues i peçenegëve duhet shikuar dhe vlerësuar në aspekt të kohës dhe hapësirës kur dhe ku kanë jetuar.

Para shkencës përgjithësisht, kurse para shkencëtarëve shqiptarë veçanërisht, mbetet detyrë që çështja peçenege të bëhet objekt hulumtimi e studimi në njërin nga projektet e shumta kërkimore – hulumtuese tek ne. Për këtë na vë detyrë bashkëjetesa shumëshekullore iliro-shqiptare-peçenege në këto troje dhe sjellja e Islamit në trojet tona, e njëkohësisht do të ndriçohej e kuptohej drejt prania e Islamit në periudhën paraosmane, por edhe osmane në trojet ballkanike e iliro-shqiptare.



Copyrighted material

## Summary

### The origin, locations and role of the Pechenegs in spreading Islam in the Illyrian-Albanian and Balkan Territories

The presence of Pechenegs in the Balkans and the Illyrian-Albanian territories for some centuries, either as a dominating military force, or conquered by others, as a nomadic people – as some biased people called them – brought with them the presence of Islam in these territories in very large numbers, and they were unyielding in this religion according to the great majority of facts from the end of the 8th century and even earlier, sometimes on the increase and sometimes decreasing.

According to information from Byzantine and Serbian sources, etc., Pechenegs possessed a high level of Islamic education and culture and they may correctly be called 'The Torch bearers of Islam' in this part of the Balkans, and especially in the Illyrian-Albanian territories. This ascertainment is not reduced in any way by insinuations and evaluations of their Christian and pagan adversaries that the Pechenegs are 'atheists', that they 'circumcise', and that they are destroyers and devastators.

The military and also the religious, cultural and civilizing activities of the Pechenegs should be examined and evaluated, taking into account the time when they lived and the places where they lived.



Copyrighted material

# Turqit vardarianë dhe roli i tyre në përhapjen e Islamit në trojet iliro-shqiptare nga shekulli IX - XIV

## I.

Rrethanat shoqërore-historike në trojet iliro-shqiptare dhe përgjithësisht në Ballkan, në shekullin IX, ishin tejet të rënduara.[248] Perandoria Bizantine, si fuqi e atëhershme botërore, ishte në luftëra të njëpasnjëshme me bullgarët, hungarezët, peçenegët dhe me popujt e tjerë në Ballkan, përkatësisht në trojet iliro-shqiptare.[249] Këto rrethana shkaktuan lëvizje të mëdha e të vazhdueshme, kryesisht të imponuara nga dhuna e shkaktuar nga luftërat e ndryshme.

Historikisht nuk dimë se cilat janë shpërnguljet e para në histori, ndonëse ato ekzistojnë që nga fillimi i njerëzisë. Nuk dimë as për shpërnguljet e para në trojet iliro-shqiptare e në Ballkan, *të dhunshme* (kur ato i bën sunduesi i caktuar për qëllime politike, fetare e etnike) apo *vullnetare* (kur ato i bën populli apo fisi i caktuar për ambicie politike, territoriale, ekonomike, përkatësisht për kushte më të mira shpirtërore dhe materiale jetësore),

---

[248] Barbara Jelavich, *Historia e Ballkanit*, I, Tiranë, 1999.

[249] Nexhat Ibrahimi, *Islami në trojet iliro-shqiptare gjatë shekujve*, botimi III, Prishtinë, 2000, fq. 175-195 dhe 197-216.



Copyrighted material

por pa dyshim, ndër shpërnguljet e para në këto troje janë ato të turqve vardarianë.

# II.

Përhapja gjithnjë e më e shpejtë e më e gjerë e Islamit në jug dhe juglindje të Perandorisë Bizantine dhe përqafimi i Islamit nga popullsia vendëse bëri që Bizanti mos të ndihet i qetë. Të pranishme ishin moskënaqësia fetare, politike, ekonomike e të tjera. Për t'i qetësuar trazirat me motive të ndryshme në Anadolli dhe në vendet përreth, perandori bizantin Teofili[250] i shpërnguli *turqit vardarianë* apo *vardariotë* nga Azia në krahinën e Selanikut,[251] dhe në brigjet e lumenjve e liqeneve në territoret e Greqisë, Maqedonisë dhe Kosovës së sotme.

Disa hulumtues mendojnë se të shpërngulurit nga Azia në kohën e Teofilit nuk ishin turq, por sllavë të robëruar në Anadoll[252], të cilët pas rënies në kontakt me muslimanët dhe pas pranimit të doktrinës muslimane, nga ana e perandorit bizantin Teofilit, u shpërngulën në Maqedoni.[253]

Këtë shpërngulje e theksojnë edhe burimet evropiane kristiane, edhe burimet arabe muslimane. Franjo Raçki[254], historian e klerik katolik nga Kroacia, kur flet për këtë çështje cek se në territoret përreth Vardarit muslimanët

---

[250] Teofili (sundoi prej vitit 829 – 842), i biri i Mihalit II, thuhet se ishte admirues i kulturës islame, kurse periudha e sundimit të tij konsiderohet si periudha e ndikimit më të madh të kulturësa arabe mbi botën bizantine." Shih: Georges Ostrogorski, *Historia e Perandorisë bizantine,* Tiranë, 1996, fq. 139.
[251] Mustafa Spahic, *Povijest islama*, 4, Sarajevë, 2000, fq. 136.
[252] Ibid., fq. 136.
[253] Shih: Nexhat Ibrahimi, *Islami në Ballkan para shekullit XV*, botimi II, Prizren, 2000, fq. 56.
[254] Franjë Racki, *Bogumili i Patareni*, fq. 350 …, sipas: Mehmed Handzic, *Islamizacija Bosne i Hercegovine,* Sarajevë , 1940, fq. 14.



Copyrighted material

ekzistojnë edhe më herët e jo me ardhjen e osmanlinjve, kur perandori bizantin Teofili "e shpërnguli një repart turqish nga Azia, të cilët më vonë u quajtën "turqit vardarianë"."[255]

Edhe historiani e etnologu boshnjak Muhammed Haxhijahiq konfirmon se në rrethin e Selanikut ka pasur muslimanë në kohën e perandorit bizantin Teofilit.[256]

Këtë fakt e provojmë edhe nga të dhënat historike të mëvonshme, kur turqit vardarianë i hasim në Hungari, në shekullin XII. Si ndodhi kjo? Perandori bizantin Timiskes, në vitin 970, pushtoi disa fushëgropa e lugina përreth Anavardarit. Turqit që prej më herët jetonin aty kishin bashkëpunim me Perandorinë Bizantine. Mirëpo, kur Perandoria Bizantine i rregulloi disa çështje me fqinjët në aspekt të sigurisë, filloi përpjekjet e qarta për konvertimin – kryqëzimin e dhunshëm të muslimanëve, turqve vardarianë. Gjendjen më të re, tendencat qëllimkëqija, nuk i duruan muslimanët. Kështu, me rastin e shpërthimit të luftës bizantino-hungareze në vitin 1150, emigruan në Hungari thuajse të gjithë muslimanët, sepse atëbotë Hungaria lejonte autonomi më të madhe fetare sesa Bizanti. Bashkë me turqit vardarianë u shpërngulën edhe arabët magrebianë, të cilët shërbenin si ushtarë me pagesë në ushtrinë bizantine, e të cilët qenë grumbulluar në Tunizi, Algjeri e Marok, për shkaqet e njëjta sikur edhe turqit vardarianë.[257]

Ndonëse nuk kemi prova të drejtpërdrejta, megjithatë, në bazë të të dhënave disa llojesh, dhe nga kohë të ndryshme, mendojmë se lufta e Arabëve kundër Bizantit,

---

255 Tafel, *De Thessalonica Berolini*, 1839, fq. 79, sipas: Mehmed Handzic, *Islamizacija Bosne i Hercegovine*, op. cit., fq. 14.
256 Muhamed Hadzijahic etj., *Islam i muslimani u Bosni i Hercegovini*, botimi I, Sarajevë, 1977, fq. 23.
257 ( - ), *Islam u Madzarskoj*, Islamska misao, 134/1990, Sarajevë, fq. 57.



Copyrighted material

në vitin 904[258], nuk e gjeti Selanikun dhe vendet e tjera në Maqedoni pa muslimanë. Këtë e mbështesin edhe disa varre arabe (muslimane) që gjenden në Qairli dhe Dobroshevë në Maqedoni, ndonëse këto varre, sipas disave, i përkasin ekspeditës arabe të vitit 904 në Selanik dhe Manastir.[259]

## III.

Nga presionet shpirtërore dhe fizike të shtetit ku jetonin dhe të fqinjëve, që tashmë i cekëm më parë, turqit vardarianë filluan pjesërisht të pagëzohen, që më vonë madje të krijojnë edhe eparkinë e tyre fetare të veçantë.[260] e pjesërisht të shpërngulen në vende përreth, ku mund të jetonin edhe më tej si muslimanë. Franjo Raçki shprehimisht pohon se turqit vardarianë fillimisht ishin muslimanë.[261] Kështu, në shekullin XII, turqit vardarianë u shpërngulën në masë në Hungari,[262] që të vazhdojnë të jetojnë edhe për një kohë me muslimanët e tjerë, prej më herët të vendosur aty.

Sikurse Bizanti dhe Hungaria që i angazhonin muslimanët si ushtarë në shtetet e tyre, ashtu veproi edhe car

---

258 Smail Balic, *Die őltesten Berűhrungen der Sűdslaven mit dem Islam*, sipas: Rade Bozovic, *Arapi u usmenoj narodnoj pesmi na srpsko-hrvatskom jezickom podrucju*, Beograd, 1977, fq. 177.
259 Tevfik Mehmed, *Kratka istorija bitoljskog vilajeta*, 1935, vëllimi I, fq. 14, sipas: Rade Bozovic, op. cit., fq. 177. Krhs.: Muhamed Hadzijahic etj., *Islam i muslimani u Bosni i Hercegovini*, op,. cit., fq. 23; dhe: *Enciklopedija zivih religija*, Beograd, 1990, fq. 378 dhe 300.
260 Franjo Racki, *Bogumili i Patareni*, op. cit., fq. 350-351.
261 Franjo Racki, *Bogumili i Patareni*, op. cit., fq. 350-351.
262 Rade Bozovic, op. cit., fq. 177.



Copyrighted material

Dushani serb me turqit vardarianë, duke i përfshirë në ushtrinë e tij, e të cilët gjatë kohës qenë pagëzuar.[263]

Për vazhdimësinë e turqve vardarianë gjejmë prova edhe në Strugë e Ohër. Disa historianë mendojnë se turqit aktualë në Strugë dhe në Ohër janë përzierje e "turqve vardarianë" që rrjedhin nga shekulli IX me osmanlinjtë që erdhën këtu në shekullin XIV.[264]

Në këtë fazë të hulumtimeve nuk zotërojmë të dhëna më të plota dhe hollësi për fatin e turqve vardarianë, por me mbështetjen e provave ekzistuese na bëhet e qartë se një pjesë e turqve vardarianë u asimiluan, përkatësisht i kristianizuan në forma të ndryshme: një pjesë e tyre u shpërngulën në drejtime të ndryshme, sikurse në Hungari, Panoni, Kosovë e Serbi, kurse pjesa tjetër, më e vogël e tyre u rezistoi të gjitha presioneve dhe fijen thuajse të këputur të Islamit e lidhën me ardhjen e osmanlinjve në këto anë.

## IV.

Paraqitja e turqve vardarianë në trojet iliro-shqiptare dhe përgjithësisht në Ballkan, përbën praninë më të hershme të Islamit dhe të muslimanëve në mënyrë kaq masive dhe atë në një periudhë të gjatë disa shekuj.

Jemi të vetëdijshëm se të dhënat që kemi janë të mangëta dhe shërbejnë vetëm sa për ta aktualizuar këtë çështje në historinë shqiptare islame. Mbetet detyrë imediate që institucionet tona shkencore, e veçanërisht historianët, arkeologët e të tjerë ta hulumtojnë më përimtësisht historinë

---

[263] Nijaz Sukric, *Povijest islamske kulture i civilizacije,* I, Sarajevë, 1989, fq. 194, shën. 6.

[264] Muzaffer Tufan, *Goc bereketleri*, fq. 320, sipas: Maliq Osi, *Prizren drevni grad …*, Prizren, 1996, fq. 162.



Copyrighted material

mesjetare dhe të fshehtat e saj, kurse çështjen e turqve vardarianë veçan ta trajtojnë. Kjo do të ndikonte që të kemi një pasqyrë më të plotë për historinë shqiptare islame në trojet iliro-shqiptare në periudhën paraosmane.



Copyrighted material

# Summary

## The Vardarian Turks and their role in spreading Islam in the Illyrian-Albanian Territories (IX – XIV century)

The presence of Vardarian Turks in the Illyrian-Albanian territories and in the Balkans in general suggests the earlier presence of Islam and Moslems in very large numbers during a period which lasted for many centuries.

We are aware that there are many missing pieces in the information we possess, but we are using the information only to illustrate this issue in the Albanian history of Islam. It is now the duty of scientific institutions, and especially historians, archaeologists and others, to make an exhaustive study of mediaeval history and its mysteries, whereas the issue of the Vardarian Turks should be treated separately. This would help us to have a wider picture of the Albanian history of Islam in the Illyrian-Albanian territories during the pre-Ottoman period.



Copyrighted material

Copyrighted material

# Islami dhe muslimanët në Hungarinë mesjetare (shekujt IX – XIV)

## Hyrje

Prania e Islamit dhe e muslimanëve në Evropën qendrore e në veri të Ballkanit, pra në Hungarinë mesjetare, që atëherë kufizohej me popullin iliro-shqiptar, është çështje e pakontestueshme historike. Për këtë çështje flasin burimet dhe literatura bizantine, romake, pastaj aktet ligjore e kartat mbretërore hungareze, por edhe burimet dhe literatura arabe të gjeografëve e shkencëtarëve muslimanë të asaj kohe, e të cilat do t'i theksojmë gjatë mbarështrimit të temës.[265] Këtë prani islamo - muslimane paraosmane individë dhe qarqe të caktuara përpiqen ta injorojnë tërësisht, duke e kualifikuar këtë tezë si 'fantazi të papërgjegjshme'[266] apo së paku ta minimizojnë në forma të ndryshme. Disa të tjerë, vetëm në shikim të parë pa paragjykime e tolerantë, praninë shekullore muslimane në Hungari e identifikojnë me *"kontakt sporadik individual dhe grupor"*, duke pohuar se këto kontakte nuk

[265] *Islam u Madžarskoj, Islamska misao* – revistë fetare, kulturore e shkencore, Sarajevë, nr. 143/1990, fq. 57.

[266] Shih për këtë: Sefko Omerbasic, *Najstariji arapski zapis o Islamu i Muslimanima u Hrvatskoj*, Behar – bosnjacki casopis za kulturu i drustvena pitanja, Zagreb, nr. 37 / 1998, fq. 1 (faqosja sipas faqeve në internet).



Copyrighted material

kanë ndikuar *"më esencialisht në atë që Islami të pushojë të përjetohet si religjion i huaj dhe civilizim i huaj, dhe se, në aspekt të islamizimit, ka qenë praktikisht pa ndonjë efekt më serioz"*,[267] duke fshehur e margjinalizuar dhunën drejt asimilimit dhe shfarosjes së Islamit dhe muslimanëve në Ballkan, Evropë dhe në vetë Hungarinë. Faktet që do të pasojnë do ta argumentojnë tezën tonë, se prania e Islamit dhe muslimanëve në Evropën qendrore dhe juglindore në periudhën paraosmane janë argumente që kërkojnë nga shkencëtarët dhe institucionet shkencore që në të ardhmen kësaj çështje t'i kushtojnë rëndësi meritore. Angazhimi i deritashëm individual dhe institucional është për çdo kritikë. Ndaj, qasja jonë, duhet të shërbejë si motivim por edhe nxitje që *edhe studimi i temave të prejardhjes islame të bëjë pjesë në traditën dhe autoktoninë tonë evropiane, ballkanike dhe shqiptare.*

## I. Prejardhja, vendlindja e parë dhe vendosja e hungarezëve në Evropën qendrore

Për prejardhjen e hungarezëve shkencëtarët nuk kanë mendim të prerë. Shumica pajtohen se "populli hungarez nuk është homogjen, sepse në periudhat e gjata kohore të migrimeve erdhi deri te përzierja dhe asimilimi i ndërsjellë me popujt dhe kulturat ugro-fine, iraniane, turke"[268] etj. Burimet e tjera pohojnë se "populli hungarez është me prejardhje Fino-ugriane, për t'u përzier më

[267] *Enciklopedija zivih religija* (autor i njësisë enciklopedike Darko Tanaskovic), Beograd, 1990, fq. 300.
[268] *Islam u Madzarskoj*, op. cit., fq. 57.



Copyrighted material

vonë me popujt turq.[269] Migrimet dhe lëvizjet e mëdha të popujve që filluan në Antikitetin e vonshëm për të vazhduar edhe gjatë mesjetës i prekën edhe hungarezët. Ata u nisën drejt anës lindore të masivit Ural. Përkohësisht, gjatë shekullit V dhe VI, hungarezët u vendosën në veri të Detit Kaspik, që gjatë shekullit VII – VIII të vendosen në bregun lindor e pastaj atë perëndimor të Detit të Zi.[270] Mendohet se vendlindja e tyre është në luginën e lumit Kam, ndërmjet lumit Don, rrjedhave të poshtme të lumit Vollga dhe Detit Kaspik.[271] Aty janë takuar me fiset turke El-Xhevashir dhe Bashkir, që më pastaj të bashkohen dhe ky bashkim fisesh të zgjasë rreth pesë shekuj.[272]

Jeta e përbashkët e fiseve turko-hungareze zgjati deri në fund të shekullit VIII, kur hungarezët u shpërngulën drejt perëndimit, në Ukrainën e sotme. Këtu mbetën një shekull, që pastaj, nën presionin e popullit peçeneg, të ndahen në disa grupe. Një grup u kthye në vendlindjen e parë, kurse tjetri, grupi më i madh, u nis drejt Karpateve, që gjatë shekullit VIII – IX, përkatësisht pas vitit 896 të vendosen në fushëgropën e Panonisë pjellore, në territorin e Hungarisë[273] dhe Vojvodinës aktuale.

---

[269] Encyclopaedia Britannica, LTD, vol. XI, op. cit., fq. 901. Për gjuhën hungareze thuhet se i përket grupit të familjes së gjuhëve Fino-ugriane. Op. cit., fq. XI, fq. 894.

[270] Ibid., fq. 57.

[271] T. O. Tarhani, *Neki spomenici islamske kulture u Madžarskoj*, Islamska misao – revistë fetare, kulturore dhe shkencore, Sarajevë, nr. 48/ 1982, fq. 43.

[272] Ibid., fq. 43. Jetën e tyre të përbashkët e argumenton edhe gjuha edhe folklori.

Mendohet se në fillim të shekullit IX ishin nën hazarët, por më vonë nën presionin e peçenegëve, ikën drejt perëndimit. Dhe bashkë me disa fise turke e kaluan Danubin në vitin 889. Shih: Encyclopaedia Britannica, vol. XI, op. cit., fq. 901.

[273] Shih: *Islam u Madžarskoj*, op. cit., fq. 57; T. O. Tarhani, op. cit., fq. 43; Miroslav Brandt, *Srednjovjekovno doba povijesnog razvitka*, I, Zagreb, 1980, fq.



Copyrighted material

Vendosja e hungarezëve në Evropën qendrore kishte rëndësi të madhe për Ballkanin dhe trojet iliro-shqiptare, sepse ndikoi që forcat deri atëherë të pranishme, relevante dhe më pak relevante, të prejardhjes romake, pastaj Bizanti, Bullgaria, peçenegët e të tjerë të pozicionohen rishtazi.

## II. Aktiviteti ushtarak hungarez dhe lëvizjet e tjera

Herë nga synimet ekspansioniste, herë nga nevoja historike për mbijetesë, para krerëve të fiseve hungareze u imponua nevoja për formimin e shtetit dhe menjëherë edhe për kristianizimin e popullatës, pasi nuk shihej mënyrë tjetër për të vazhduar jetën, kur nga të gjitha anët rrethohej me shtetet kristiane dhe kristianizimin si proces të hapur por ende të papërfunduar. Burimet historike pohojnë se shtetin e parë hungarez e formoi Ishtvani në fund të shekullit X. Ky njëherit është mbreti i parë hungarez dhe shteti i parë kristian në këtë nënqiell.[274] Shkencëtari françez J. Le Goff, që shquhet për objektivitet shkencor, formimin e shtetit hungarez e përshkruan si vijon: *"Para shekullit X hungarezët do t'i braktisin plaçkitjet, pushtimet, do të vendosen në një vend, do të kristianizohen dhe do të lindë Hungaria."*[275]

Gjatë kohës Hungaria bëri luftëra të përgjakshme me Bizantin, Rusinë, popullin peçeneg, trakas dhe më pak me

428; George Ostrogorski, *Historia e Perandorisë Bizantine*, Tiranë, 1997, fq. 175.

[274] Islam u Madzarskoj, op. cit., fq. 57.

[275] Jacques Le Goff, *Qytetërimi i Perëndimit Mesjetar*, Tiranë, 1997, fq. 64.



Copyrighted material

popullin iliro-shqiptar. Të shtrënguar nga interesat momentale, hungarezët shpeshherë i gjejmë në luftëra të drejtpërdrejta me popuj të ndryshëm, e herë-herë në aleanca me një palë kundër tjetrës, që solli pos përfitimeve politiko-ushtarake, edhe fërkime dhe këmbime të vlerave fetare, kulturore e civilizuese.[276]

Burimet historike tregojnë se luftërat nuk janë i vetmi faktor për konsolidim të brendshëm e të jashtëm. Krahas saj, tregtarët e të gjitha llojeve dhe të të gjitha vendeve këmbenin mallra por edhe idetë fetare, kulturore, të artit ushtarak, të banimit, ushqimit, të komunikimit dhe të vetë gjuhës. Ndonëse në pasiguri dhe në kushte të vështira udhëtimi, tregtarët babilonas, persianë, indu, egjiptianë, kananë, rusë, peçenegë, hazarë, iliro-shqiptarë, muslimanë, kryenin rolin e tyre konstruktiv.[277]

Krahas zhvillimeve ushtarake dhe tregtare pas shekullit IX e sidomos pas shekullit X Hungaria ishte udhëkryq dhe pikëtakim i lëvizjeve të popujve të ndryshëm, grupeve misionariste dhe sektare heretike. Hungaria si vend që braktisi pushtimet e reja, plaçkitjet dhe filloi të stabilizohej ekonomikisht, politikisht dhe fetarisht, ishte vend që parapëlqehej nga grupe e individë. Kështu, prej shekullit IX e deri në shekullin XIV mbretërit hungarezë, të udhëhequr nga *'Udhëzimet për pushtet'* dhe nga traditat e vjetra, pranuan grupime, grupe e popuj të ndryshëm nga lindja, duke i përfshirë në shoqërinë vendore.[278] Kështu për shembull, të shtrënguar nga dhuna bizantine në kohën e

---

[276] Shih: G. Ostrogorski, op. cit., fq. 175; M. Brandt, op. cit., fq. 249, 428; Mustafa Spahic, *Povijest islama*, vëll. 4, Sarajevë, 2000, fq. 136; Maliq Osi, *Prizren drevni grad*, Prizren, 1996, fq. 66; Nexhat Ibrahimi, *Prejardhja dhe vendosja e peçenegëve në trojet iliro-shqiptare e në Ballkan dhe roli i tyre në përhapjen e islamit në këto troje*, Edukata islame, nr. 65/2001, fq. 67 etj.

[277] Sipas: *Itinerari* i Benjamin di Tudel në shekullin XII, Documenti III, në: Marko Susnjic, *Hrestomatija izvora za opstu istoriju srednjeg vijeka*, Sarajevë, 1980, fq. 249.

[278] Islam u Madzarskoj, op. cit., fq. 57.



Copyrighted material

perandorit bizantin Timiskiut në vitin 970 e pas e sidomos pas vitit 1150 *Turqit vardariotë* nga jugu emigruan në Hungari, e cila atë kohë lejonte autonomi fetare.[279]

Grupi tjetër me rëndësi, mbase më i madhi, që migroi në Hungari ishte *populli peçeneg*, të cilët pas humbjes nga Bizanti në vitin 1120, për të shpëtuar, ikën në këtë vend.[280]

Grupi vijues në Hungari ishte ai i *ismailitëve*, më masivi, më kohëgjati, që krijoi histori atje, e që në faqet vijuese do të jetë objekt trajtimi më hollësisht.[281]

Nuk janë të parëndësishme edhe lëvizjet tjera etnike apo heretike si të hazarëve, kumanëve, babunëve, Sari Salltëkut, bogumilëve, të cilët, të ndjekur në vendet e deriatëhershme, kërkonin strehim nga vendi në vend, mirëpo kudo që shkonin linin gjurmë të pikëpamjeve të tyre fetare, kulturore e civilizuese.

## III. Gjendja shpirtërore e hungarezëve para dhe gjatë kristianizimit

Rrethanat shpirtërore, morale dhe kulturore në Hungarinë mesjetare gjatë shekujve IX – XIV ishin në shenjë të zhvillimeve politike dhe ushtarake të Hungarisë dhe vendeve përreth. Dyndja e avarëve, sllavëve, pastaj dyndja e popujve skandinavë, e popujve nga lindja dhe

---

279 Ibid., fq. 57.

280 Ibid.

281 Mehmed Handzic, *Islamizacija Bosne i Hercegovine i porijeklo bosanskohercegovackih muslimana*, Sarajevë, 1940, fq. 14; Mehmed Handzic, *Teme iz opce i kulturne historije*, libri II, Sarajevë, 1999, fq. 140 – 150; Rade Bozovic, *Arapi u usmenoj narodnoj pesmi na srpskohrvatskom jezickom podrucju*, Beograd, 1977, fq. 175 etj.



Copyrighted material

verilindja bëri që Evropa qendrore dhe Ballkani të pësojnë ndryshime etnike, fetare dhe kulturore. Paraqitja dhe përhapja e kristianizmit në Ballkan, vendosja e disa popujve të prejardhjes islame në Ballkan dhe lëvizjet e grupeve të shumta e të fuqishme heretike bënë që fetë / besimet e mëhershme dalëngadalë të zbehen, të margjinalizohen dhe më vonë të zhduken nga skena historike. Megjithatë, kryengritjet sllave në Poloni në vitin 973, kryengritja pagane në Poloni në vititn 1038, mohimi i kristianizimit në Hungari në vitin 1040 e shumë të tjera në shumë vende shpesh shndërroheshin në kryengritje shoqërore, kurse masat e popullit ktheheshin në paganizëm,[282] gjë që tregon se kristianizimi i Evropës ende ishte proces i hapur, që do të mbyllet vetëm në fund të shekullit XIII.

Viteve të fundit të shekullit X dhe atij të XI, kristianizimi në Hungari mori hov. Kjo gjendje favorizohej edhe nga shtetet fqinje, ku kristianizimi ishte në rritje e sipër, siç e quan J. Le Goff, *"nga lart dhe me zor."*[283]

Masivizimi dhe intensifikimi kristian në Hungari bëhej në frymën e një tolerance ndërkristiane, që e dëfton edhe simboli i shtetit, kurora hungareze, e cila përbëhet prej dy pjesëve: pjesa e epërme është dhuratë e perandorit bizantin, kurse pjesa e poshtme është dhuratë e papës romak.[284] Këtë e dëshmon edhe fakti se në këtë vend krahas katolicizmit, pranohej edhe ortodoksizmi.[285] Mbreti hungarez në fazën e parë të kristianizimit të vendit dhe të popullatës shumetnike dhe multifetare, ftoi klerikët gjermanë dhe francezë të propagandojnë kristianizmin, por u ka lejuar edhe fiseve lindore që të vendosen në Hungari, duke iu dhënë autonomi të pjesshme.[286]

---

[282] J. Le Goff, op. cit., fq. 182 - 183. Shih edhe: Andrija Gams, *Biblija i društvo*, Novi Sad, 1979, fq. 269.
[283] J. Le Goff, op. cit., fq. 183.
[284] *Islam u Madžarskoj*, op. cit., fq. 57.
[285] Ibid.
[286] Ibid.



Copyrighted material

# IV. Islami dhe muslimanët në Hungarinë mesjetare parakristiane dhe kristiane

## A. Rrugët dhe koha e migrimit të muslimanëve në Hungarinë mesjetare

Para shkencëtarëve dhe historianëve të fesë dhe të kulturës ende është enigmatike se kur dhe si arritën Islami dhe muslimanët në Hungarinë mesjetare. Pasi nuk zotërojmë të dhëna të përpikta të dorës së parë mbi këtë çështje, që e pranon edhe Berthold W. në *Enciklopedinë islame*, [287] në vazhdim do të përpiqemi që këtë çështje ta analizojmë dhe shtrojmë nga literatura ekzistuese të cilën e kemi.

Duke hulumtuar praninë e Islamit dhe muslimanëve në trojet iliro-shqiptare, në Ballkan dhe në Evropën lindore, duke i analizuar lëvizjet e popujve e fiseve, duke i krahasuar emërtimet e vendeve, fiseve e të tjera, mendoj se Islami dhe muslimanët në Hungari (dhe Vojvodinë) ishin të pranishëm para kristianizimit të Hungarisë[288] nga Ishtvani në fund të shekullit X, për të vazhduar ekzistencën e tyre për disa shekuj, përkundër dhunës sistematike dhe mekanizmave të ndryshëm për asimilimin, largimin nga Hungaria apo edhe zhdukjen e muslimanëve.

Prej shekullit IX, kur mendojmë se i kemi muslimanët e parë në Hungari, deri në shekullin XIV, muslimanët i

---

[287] Mehmed Handzic, *Teme ...*, op. cit., fq. 142.

[288] Muhamed Hadzijahic, *Neki pojavni oblici islamske civilizacije u nas*, Argumenti – revistë për teorinë dhe praktikën shoqërore, Rijekë, nr. 2. 1982, fq. 213.

Ndër vendbanimet e para me muslimanë në Ballkan janë Sremi, Bosnja verilindore, Maçva dhe Hungaria. N. Ibrahimi, *Islami në Ballkan para shekullit XV*, botimi II, Prizren, 2000, fq. 57.



Copyrighted material

hasim me emërtime të ndryshme: ismailitë[289], bashgirdë[290], saracenë[291], buzurmanë[292] e të tjerë, të cilët do t'i sqarojmë gjatë shtjellimit.

Ndër muslimanët e parë, nëse jo të parët, në Hungari kemi fisin me emrin *Kalis* apo *Kabar*. Ky fis, bashkë me shtatë fise të hordhive pushtuese hungareze, erdhën në Hungarinë e sotme.[293]

---

[289] *Ismailitë* – këta muslimanë mendohet se i përkisnin fraksionit xha'ferij, shiit të fatimitëve, e sipas emrit të Shafer es-Sadikut. Të tjerët mendojnë se emri *ismailit* vjen nga ajo se kristianët në Mesjetë i kanë quajtur Arabët ismailitë, bijë të Ismailit, d.m.th. pasardhës të birit të Ibrahimit, të cilit i përkiste edhe vetë Muhammedi a. s.

Disa i kanë quajtur ismailitët me emërtimin keqësues *agaren*, d.m.th. pasardhës të Haxheres, robëreshës dhe gruas së Ibrahimit a. s., për ta bërë dallimin se Arabët nuk ishin nga Sara–gruaja e parë e Ibrahimit a. s. Ky emërtim pastaj u shtri për identifikimin e të gjithë muslimanëve. Shih: Mehmed Handzic, *Teme* ..., op. cit., fq. 140 – 141.

[290] *Bashgirdë* – (bashgjirdë, bashkirdë), popull turk, për të cilët mendohet se janë vetë ismailitët. Ndaj, në vazhdim nuk do t'i përdorim veçanërisht këto sinonime. Shih: Jakut el-Hamewiu, *Mu'xhem'ul-buldan*, II, Kairo, 1906, fq. 37 –39, sipas: Mehmed Handzic, Teme ..., op. cit., fq. 146.

*Bashgirdët* janë popull turk në Uralin jugor, të shpërndarë në grupe më të vogla apo më të mëdha. Kryesisht merren me bujqësi dhe blegtori. Disa janë gjysmënomadë. Feja e tyre është islame. Së bashku me Teptjarët, fis i ngjashëm me ta, numëronin rreth 800.000 njerëz. Gjuha bashkire i përket grupit të gjuhës turke. (Mehmed Handzic, *Teme* ..., op. cit., fq. 141.

Sipas *Enciklopedisë Britanike* emërtimi *'Bashkird'* për herë të parë përdoret në shekullin X nga Ibn Fadlani. Shih: *Encyclopaedia Britannica*, vol. III, op. cit., fq. 170.

[291] *Saracenë* – Mbase nga fjala arabe *sharkijjun* – që fillimisht identifikonte Arabët, e më vonë të gjithë muslimanët. (Nerkez Smailagic, *Leksikon islama*, Sarajevë, 1990, fq. 533, dhe: *Islam u Madzarskoj*, op. cit., fq. 58. Krahs.: *Encyclopaedia Britannica*, LTD, vol. XIX, fq. 987.

[292] *Buzurman* – Bosomenja, boszormeny, (Hungari, Busurman (Rusi), busurman (letërdia e vjetër në ish-Jugosllavi), Busroman, busulman, buslloman, busorman, besterman, bestermanian, besermen, musroman, që d.m.th. musliman. Sipas: Mehmed Handzic, *Teme* ..., op. cit., fq. 141.

[293] Nga burimet arabe dimë se këtë fis në Islam e solli Kutejbe ibn Muslim në vitin 712, kurse territori ku ata e banuan është quajtur *Horezma* apo *Havarezm*, në jug të liqenit Aral. Sipas: *Islam u Madzarskoj*, op. cit., fq. 57.



Copyrighted material

Disa autorë Kalisët i identifikojnë me ismailitët.[294] Sipas udhëpërshkruesit nga fillimi i shekullit X, Muhammed el-Istarhi el-Farisij, ceket se *"Kalisët apo Ismailitët kryesisht ishin ushtarë dhe tregtarë dhe se udhëtojnë shumë."* Ndonëse nuk ekzistojnë të dhëna ekzakte si dhe kur erdhën në Hungari, është fakt se ky fis u paraqit në fillim të shekullit IX.[295]

Burimet e tjera pohojnë se ismailitët në Hungari, të cilët kanë prejardhje turke, rrjedhin nga mercenarët (ushtarët me pagesë) turq, të angazhuar, qysh në fillim të shekullit IX, nga kalifët bagdadas Abasidë, për mbrojtjen e kufijve veriorë të shtetit. Këta mercenarë ishin vendosur në kufirin bizantin. Nga këtu ata kaluan edhe në shërbim të Bizantit, që i përdorte për mbrojtjen e kufirit danubian.[296]

Më pastaj, sipas *Kartës* së mbretit Kolomani nga viti 1111 "populli Kalis" përmendet si "tubues të tatimit për thesarin mbretëror."[297]

Historiani bizantin Joanes Kinnamos, në librin e vet "*Epiteme*", duke përshkruar luftën bizantino-hungareze nga viti 1165, shkruan: "U largua mbreti nga Zemuni, muratoi një fortifikatë të re dhe në te vendosi hungarezët nga Sremi. Këta të zhvendosur i quajnë *kaliz* dhe ata nuk rrëfejnë po atë fe të hungarezëve, por janë ithtarë të fesë persiane,"[298] që d.m.th. se janë pjesëtarë të fesë islame.

---

294 Mehmed Handzic, Teme ..., op. cit., fq.141. S. Omerbasic, op. cit., fq. 9.

295 *Islam u Madzarskoj*, op. cit., fq. 57. Sipas Sh. Omerbashiqit, e ky në mbështetje të Ebu Hamidit '*Kalizët*' janë me prejardhje perëndimore sepse quhen '*Megarib*'. Op. cit., fq. 10.

296 Mehmed Handzic, *Teme* ..., op. cit., fq. 142.

Praninë muslimane në Hungarinë mesjetare dhe në Ballkan përgjithësisht i theksojnë edhe historianët kroatë Tade Smiciklas dhe Ivan Kukuljeviq-Sakcinski në *Corpus Diplomaticus*-in e tyre, pastaj edhe Ferdo Shishiq në historinë e tij *Poviest Hrvata za kraljeva iz doma Arpadoviqa*. S. Omerbasic, op. cit., fq. 1.

297 *Islam u Madzarskoj*, op. cit., fq. 57. Sipas disa burimeve Kolomoni ishte mbret hungarezo-kroat. M. Brandt, op. cit., fq. 572.

298 Mehmed Handzic, *Teme*..., op. cit., fq. 142; *Islam u Madzarskoj*, op. cit., fq. 57.



Copyrighted material

J. Kaliq, në mbështetje të analizave krahasuese Ebu Hamidit, Kinamos dhe Hanijatit konfirmon se një numër i madh i robërve janë banorë të vendbanimeve nga Sremi.[299]

Mbështesim mendimin e M. Hanxhiqit se ismailitët nga vendlindja e tyre në Uralin e poshtëm në Hungari erdhën kryesisht në Hungari, nga veriu, ngjashëm siç migruan muslimanët në Poloni, Finlandë e vende të tjera.[300]

Grupi tjetër me rëndësi që migroi në Hungarinë mesjetare dhe aty qëndruan për disa shekuj, janë bullgarët vollgianë apo povollianë, por edhe bullgarët nga Bullgaria e sotme. Mendojmë se muslimanët nga Bullgaria e sotme kanë migruar në Hungarinë mesjetare gjatë shekullit IX, ashtu siç e përshkruan këtë ngjarje edhe Jakut el-Hamewiu (vdiq 626 h. / 1228), duke thënë se në Hungari patën migruar shtatë shejhë (dijetarë) muslimanë nga Bullgaria,[301] për t'i mësuar banorët e Hungarisë në fenë islame.

Përafërsisht një shekull më vonë në Hungarinë mesjetare migruan edhe Bullgarët të tjerë, vollgianë, që shpesh ndër shkencëtarë ngatërrohen me bullgarët nga Bullgaria e sotme.

Bullgarët vollgianë, apo povollianë migruan në Hungari ndërmjet vitit 960 dhe 972. Këtu i sollën krerët e tyre Bila dhe Butesu. Sipas Ahmed ibn Fadlanit, i cili e vizitoi Bullagrinë vollgiane më 921 – 922, vendbanimi i tyre i parë rreth Vollgës, të gjithë ishin muslimanë.[302] Këta

---

[299] Jovanka Kalic, *Podaci o Abu Hamidu o prilikama u Juznoj Ugarskoj sredinom XII veka*, në: Zbornik za istoriju, IV, Beograd, 1971, fq. 25 – 37, cituar sipas: Muhamed Hadzijahic, *Islam i Muslimani*, op. cit., fq. 26 – 27. Sh. Omerbashiq thekson se J. Kaliq në studimin e saj qëllimisht manipulon me faktet për qëllime politike. Sh. Omerbasic, op. cit., fq. 1 –2.

[300] Mehmed Handzic, *Teme ...*, op. cit., fq. 143. Kjo tezë në të ardhmen duhet argumentuar me fakte materiale

[301] Shih gjerësisht: Mehmed Handzic, *Teme ...*, op. cit., fq. 142; Thomas W. Arnold, *Povijest islama*, botimi I, Sarajevë, 1989, fq. 230 -231; Abdurrahman Hukic, *Arapi i Islam u Evropi*, Glasnik VIS-a, Sarajevë, nr. 4 – 6 / 1961, fq. 152, 281.

[302] *Islam u Madzarskoj*, op. cit., fq. 57.



Copyrighted material

muslimanë migruan në Hungari pasi në vitin 960 shpërtheu luftë ndërmjet gjashtë fiseve vendore.[303]

Grupi i tretë musliman me rëndësi që migroi në Hungarinë mesjetare është populli *peçeneg* (në burime të ndryshme i cekur edhe me emra tjerë si Beslenjevë etj.), i cili erdhi nga rrethi i Kievit të tanishëm. Gjeografi arab Ebu Ubejd el-Bekri në veprën e vet "Libri i rrugëve dhe vendeve" shkruan se ndërmjet viteve 988 dhe 997 peçenegëve ua mësuan Islamin predikuesit horezmianë (ismailitë).[304]

Të dhënat historike tregojnë se peçenegët dhe hungarezët, qoftë si palë ndërluftuese, qoftë në aleancë ndërmjet veti, qoftë edhe gjatë këmbimeve tregtare e kulturore, kanë bashkëjetuar që nga shekulli IX, X e XI.[305]

Në vitin 1036 peçenegët humbën rëndë nga Jarosllavi i Urtë, mbreti kievas, me ç'rast u ndanë në dy grupe kryesore. Një pjesë menjëherë migroi në Hungari, sigurisht nga fakti se aty tashmë kishte muslimanë, kurse 13 fise tjera formuan shtetin e tyre në hapësirën e Bullgarisë së sotme.[306] Ky shtet nuk i shkoi për shtati Bizantit, kështu që pas luftërave të shumta, e veçan pas asaj të vitit 1120, peçenegët pasi humbën luftën, thuajse të gjitha fiset migruan në Hungari. Përkah numri mendohet se ky ishte grupi më i madh musliman që migroi në Hungari, e këtë e argumenton edhe numri i madh i emërtimeve gjeografike, rreth 150 sosh, që sillen në lidhje me peçenegët.[307] Se peçenegët paraqisnin faktor politik e kulturor

---

303 *Islam u Madžarskoj*, op. cit., fq. 57; Gjerësisht: N. Ibrahimi, *Islami në Bullgarinë mesjetare (shekulli IX – XI)*, dorëshkrim. Krhs.: M. Brandt, op. cit., fq. 322 etj. dhe 558 etj.

304 *Islam u Madžarskoj*, op. cit., fq. 57.

305 *Islam u Madžarskoj*, op. cit., fq. 57; M. Brandt, op. cit., fq. 428; G. Ostrogorski, op. cit., fq. 175.

306 *Islam u Madžarskoj*, op. cit., fq. 57.

307 Ibid.



Copyrighted material

edhe brenda Hungarisë, tregon edhe fakti se me peçenegët në Hungari komunikonte zyrtarisht edhe Bizanti.[308]

Në vitin 1196 në Osjek të Kroacisë, atëherë në përbërje të Hungarisë i hasim ismailitët dhe peçenegët me emrin "Hysmaelite vel Bysenii" si të detyruar të bënin pagesën e doganës në dobi të manastirit Çikadora.[309]

Grupimi i katërt musliman që migroi në Hungarinë mesjetare ishin *turqit vardariotë* edhe *arabët magrebianë.*

Turqit vardariotë, sipas të dhënave historike, u shpërngulën nga Anadolli në luginën e Vardarit në vitin 829 – 841 nga ana e perandorit bizantin Teofilit. F. Raçki për ta pohon se fillimisht ishin muslimanë. Mirëpo, gjatë historisë ky popull kaloi nëpër vështirësi të shumta. P. sh. perandori bizantin Timickes, në vitin 970 pushtoi disa fushëgropa në luginën e Vardarit. Një kohë të gjatë turqit bashkëpunonin dhe bashkëjetonin me mbretërinë bizantine. Mirëpo, gjatë kohës gjendja u keqësua. Bizanti dëshironte t'i pagëzonte të gjithë muslimanët. Pas luftës që shpërtheu ndërmjet Bizantit dhe Hungarisë në vitin 1150, Turqit vardariotë të fesë muslimane migruan në Hungari, e cila krahasuar me shtetet përreth ofronte një autonomi më të madhe fetare, një tolerancë më të pranueshme.[310] Këtë migrim e thekson edhe M. Hanxhiq, ndonëse nuk kishte argumente historike të mjaftueshme në kohën e tij.[311]

Sa u përket *arabëve magrebianë,* mendohet se ata ishin ushtarë të paguar në Bizant, të tubuar në territorin e Tunizisë, Algjerisë dhe Marokut. Të gjithë këta thirreshin

---

[308] J. Ferluga, *Vizantijsko carstvo i jugnoslavenske drzave od sredine IX do sredine X veka*, Zbornik radova Vizantoloskog Instituta, Knjiga XIII, Beograd, 1971, fq. 84, sipas: Rade Bozovic, op. cit., fq. 83. Shih: Nexhat Ibrahimi, *Prejardhja dhe vendosja e peçenegëve…*, Edukata islame, 65/2001, op. cit., fq. 57 – 76.

[309] Muhammed Hadzijahic, *Islam i Muslimani*, op. cit., fq. 27.

[310] *Islam u Madzarskoj*, op. cit., fq. 57.

[311] Mehmed Handzic, *Teme …*, op. cit., fq. 143.



Copyrighted material

me një emër: 'Magrebij' apo 'Magribij'. Mendohet se dhuna e ushtruar ndaj tyre për ta përqafuar kristianizmin nga ana e Bizantin bëri që, sikur edhe turqit vardariotë, të migrojnë në Hungari.[312]

## B. Pozita e Islamit dhe muslimanëve në Hungarinë mesjetare

Islami dhe muslimanët në Hungarinë mesjetare gjatë shekullit IX e deri në shekullin XIV kanë kaluar nëpër faza të ndryshme të lirive të jetës, besimit, punës, lëvizjes etj., nga ato faza që mund të cilësohen të tolerueshme deri te ato kur luftohej për të mbijetuar. Në mungesë të studimeve të plota e sistematike, ku do të mund të mësonim për këtë periudhë në mënyrë të hollësishme, do të përpiqemi të ofrojmë një mozaik të dhënash, nga do të mund të nxjerrim përfundime të shëndosha.

Sipas të gjitha gjasave, muslimanët fillimisht u vendosën në veri të Danubit, që d.m.th. në Panoninë e sotme, përkatësisht si e cek këtë Jakut el-Hamewiu. Ne jemi në mes të vendeve kristiane: në veri janë vendet e sllavëve, në jug vendet e papës, në perëndim kemi Andaluzinë kurse në lindje vendet e Bizantit, Konstantinopolit dhe krahinat e tij….[313] Këtë pjesë të Ballkanit e pushtoi mbreti hungarez Lladisllavi në vitin 1091, duke e futur edhe Sremin dhe Maçvën në gjirin e mbretërisë së tij.[314] Sipas të dhënave historike në shekullin X, por edhe më vonë, hungarezët për shumë punë nga tregtia, zejet dhe bujqësia përdornin fuqinë punëtore nga banuesit e lirë të ardhur

---

312 *Islam u Madzarskoj*, op. cit., fq. 57.
313 Jakut el-Hamewiu, *Mu'xhem'ul-buldan*, II, Kairo, 1906, fq. 39, cituar sipas: Mehmed Handzic, *Teme*,…, op. cit., fq. 148.
314 Mehmed Handzic, *Teme* …, op. cit., fq. 143.



Copyrighted material

nga lindja, të cilët kishin status të veçantë, të njohur e të mbrojtur me ligj, si musafir (hospites), siç janë peçenegët, hazarët, bullgarët vollgianë, kumanët, horezmianët (kalisët, hvalisët), saracenët etj.[315] Mbretërit hungarezë i përdornin muslimanët edhe si mercenarë (ushtarë me pagesë), sepse njiheshin si luftëtarë të shkëlqyeshëm.[316] Këtë e argumenton edhe udhëpërshkruesi musliman Ebu Hamid El-Endelus El-Garnati, i cili nga viti 1150 – 1153 qëndroi në Hungari, duke shkruar se në ushtrinë e mbretit hungarez që lufton kundër mbretërisë bizantine ka edhe ushtarë muslimanë.[317]

Për shkak të natyrës së shkrimit, por edhe në mungesë të të dhënave për të gjitha periudhat, nuk do ta ndjekim problemin kronologjikisht. Ndaj, dua të theksoj se muslimanët në Hungari përmenden si rojtarë të fortifikatës peshtiane, kurse në shekullin XIII qenë të shpërndarë nëpër tërë Hungarinë, e sidomos si tregtarë.[318] Në periudhën e '*Bullës së artë*'[319] muslimanët i gjejmë si doganierë

---

[315] Salih Hadzialic, *Manihejska proslost srednjovjekovne Bosne*, Islamska misao, revistë fetare, kulturore e shkencore, Sarajevë, nr. 143/1990, fq. 10.

[316] Mehmed Handzic, *Teme* ..., op. cit., fq. 143.

Për praninë muslimane në ushtrinë hungareze flet e dhëna se në vitin 1159 mbreti bizantin Manuel Komneni nënshkroi paqë me hungarezët. Ky mbret e pyeti një rob lufte, musliman hungarez, për shkakun përse mbreti i tyre hyri në luftë kundër Bizantit, kur këtë nuk e ka pasur traditë, e robi musliman u përgjigj: "Mbreti hungarez ka ushtri të fuqishme muslimanësh; ka lejuar shtimin e detyrave që urdhëron feja islame, kurse ata kanë këmbëngulur se duhet zhvilluar luftë kundër jush." (*Islam u Madzarskoj*, op. cit., fq. 58.)

[317] *Islam u Madzarskoj*, op. cit., fq. 57.

Këtë e argumentojnë edhe fjalët e Ebu Hamidit drejtuar një ushtari musliman hungarez "se a mendon vërtet se kjo luftë është xhihad?" që ai të përgjigjet: "Po". Ata (ushtarë muslimanë, N. I.) që bëhen robër lufte të ushtrisë bizantine mund të propagandojnë ndër muslimanët, të cilët nuk dinë që në ushtrinë hungareze ka luftëtarë të fesë së tyre, se muslimanët jetojnë edhe në këtë vend." (*Islam u Madzarskoj*, op. cit., fq. 58.

[318] Mehmed Handzic, *Teme* ..., op. cit., fq. 144.

[319] *Bulla e artë* (kroatisht 'Zlatna bula') është kartë me vulë të artë, me të cilën mbreti hungarez Andrija II në vitin 1222, pos tjerash, me anë të akteve ligjore hapi rrugën që popullsia e lirë, kryesisht ajo muslimane, të shndërro-



Copyrighted material

mbretërorë[320] farkues këmbyes parash dhe nëpunës të tjerë shtetërorë.

Myslimanët në Hungari ishin të njohur se kishin drejtuar jo vetëm këmbimoret e parave, por edhe me uzinat për farkueset e parave. Disa monedha hungareze nga shekulli XII kishin mbishkrim në arabishte.[321] Në shekullin XIII, në monedhat e argjendta të mbretërve hungarezë vërejmë shenjat lindore: gjysmëhënën dhe shkrimin 'ilahi' me shkrim kufik, kurse në monedhën prej bakri hasim madje edhe ajetin e parë të sures El-Fatihatu *"Bismi'l-lahi'rr-rrahmani'rr-rrahim"*.[322] Disa autorë mendojnë se këto gjurmë ishin rezultat i ndikimit të muslimanëve magribianë dhe atij spanjoll. Figura e zezakut në monedhat hungareze sipas disa të dhënave lidhet me muslimanët magribianë, për të cilët kemi folur më herët, e të cilët supozohet se rrjedhin nga Arabët dhe Berberët nga Afrika veriore.[323] Sipas të dhënave të tjera, figura e zezakut në monedhat hungareze[324] është rezultat i Jacobus Saracenusit, i cili në vitin 1371, kishte marrë me qira farkuesit e parave në Hungari, mbase që të tregojë për prejardhjen e tij *saraceniane* (muslimane).[325]

Me gjithë mekanizmat shtrëngues të mbretërve hungarezë, muslimanët edhe më tej i gjejmë në pozita të larta

het në popullsi të varur. Shih: *Pravna enciklopedija*, vol. II, Beograd, 1989, fq. 1962. Gjerësisht: *Encyclopaedia Britannica*, vol. XI, op. cit., fq. 902 me njësinë bibliografike 'The Golden Bull'.

320 Në *Kartën* e mbretit Kolomoni nga viti 1111 muslimanët theksohen si "tubues tatimi për thesarin mbretëror." (*Islam u Madzarskoj*, op. cit., fq. 57.)

321 Karoly Czegeldy dhe Vilmes Voigt, sipas: Muhamed Hadzijahic i drugi, *Islam u Muslimani u Bosni i Hercegovini*, Sarajevë, 1977, fq. 28.

322 *Islam u Madzarskoj*, op. cit., fq. 58.

323 Karoly Czegeldy dhe Vilmes Voigt, sipas: Muhamed Hadzijahic i drugi, *Islam i Muslimani*, op. cit., fq. 28.

324 Nuk kemi të dhëna se a është fjala për monedhat e sipërtheksuara apo janë rast tjetër.

325 Muhamed Hadzijahic i drugi, *Islam i Muslimani*, op. cit., fq. 28.



Copyrighted material

të administratës shtetërore etj.[326] madje shumë mekanizma financiarë të shtetit i gjejmë në duar të muslimanëve.

Mirëpo, rritja e numrit të muslimanëve në Hungari si nga veriu, lindja, jugu dhe perëndimi, individualisht, në grupime e grupe, por edhe në fise e popuj të tërë, arsimimi i tyre i lartë, shkathtësia në artin ushtarak, por edhe në atë zejtar, bujqësor e administrativ e të tjera nuk i vinte për mbarë Evropës kristiane qysh në fillim. Ata me të gjitha forcat u përpoqën t'i konvertojnë muslimanët në kristianizëm ose ata që refuzojnë konvertimin t'i largojnë nga shteti tashmë i krijuar hungarez. Duke e parë se shumë hungarezë e përqafuan kristianizmin, por muslimanët mbetën të pathyeshëm në Islam, pushtetet e atëhershme vendosën shumë ligje në dëm të muslimanëve.[327] Deri më tash janë zbuluar 32 burime të shkruara historike nga viti 972 deri në vitin 1291, ku ndalohet besimi islam brenda vendit,[328] dhe shumë ligje të tjera duke kufizuar liritë e muslimanëve në Hungari. Në vazhdim të këtij shkrimi do t'i përmendim disa raste drastike, që i hasim nëpër burime dytësore, por që konfirmojnë njëri-tjetrin, kështu që fitojnë në peshë si argumente shkencore.

Mbreti Lladisllavi në vitin 1077 urdhëroi që ismailitët (muslimanë) të pagëzohen. Urdhëresa u aplikua, por shumica dërrmuese e muslimanëve në shpirt mbetën muslimanë.[329]

Në Kodin e vitit 1092 Lladisllavi kumtoi urdhëresën tjetër (edhe më të ashpërsuar nga ajo e vitit 1077) ku ndër të tjera shkruan: "Nëse ismailitët të quajtur tregtarë, pas pagëzimit i kthehen fesë së tyre të parë dhe i cirkumizojnë (synetojnë) fëmijët e tyre, duhet të largohen nga

---

326 *Islam u Madzarskoj*, op. cit., fq. 58.
327 T. O. Tarhani, *Neki spomenici islamske kulture u Madzarskoj*, Islamska misao, Sarajevë, nr. 43/1982, fq. 43.
328 *Islam u Madzarskoj*, op. cit., fq. 58.
329 Mehmed Handzic, *Teme ...*, op. cit., fq. 144.



Copyrighted material

vendbanimet e tyre dhe të vendosen në vende të tjera. Kush prej tyre gjatë hetuesisë e dëshmon pafajësinë e vet, mund të mbesë në vendbanimin e vet."[330]

Po këtë kohë, pas Lladisllavit, mbreti Llasllo në vitin 1092 muslimanëve të pagëzuar me dhunë dhe masa ligjore ua ndalon çfarëdo formë kthimish te feja e parë.[331] Kurse rreth vitit 1095 mbreti Kollomani, në ligjin e tij shkon edhe më tej se Lladisllavi, duke shkruar:

Neni 46: "Nëse dikush vëren se ndonjë ismailit sipas traditës pagane (mendohet në Islamin, N. I.) agjëron apo ushqehet, ngurron nga mishi i derrit apo merr abdest, ose zbaton ndonjë ritual tjetër të fesë së vet – këtë le t'ia komunikojë mbretit, kurse paraqitësi do të shpërblehet me një pjesë të pasurisë së atij ismailiti."

Neni 47: "Çdo fshat ismaili duhet të ndërtojë kishë dhe ta furnizojë atë denjësisht. Pasi të ndërtohet kisha, gjysma e ismailitëve të atij fshati le të shpërngulet dhe le të vendoset me ne si në një shtëpi njerëz të një morali dhe të gjithë së bashku le të marrin pjesë në Shërbesën hyjnore në Kishën e Krishtit."

Neni 48: "Asnjë ismailit nuk bën ta martojë vajzën e vet për ndonjë nga bashkëkombasit e tij, por le ta martojë për meshkujt tanë."

Neni 49: "Nëse ismailitit i vjen dikush në vizitë, apo ai e fton dikë në ushqim, ai dhe mysafiri duhet ta hanë mishin e derrit."[332]

Sipas burimit tjetër kjo ndodhi në vitin 1102.[333]

Përkundër këtyre ligjeve drakonike e tiranike, para të cilave njeriu normal do të rrëqethej e llahtarisej, muslimanët mbijetuan, ndonëse jo me fuqinë dhe mënyrën si

---

[330] Ibid.

[331] *Islam u Madzarskoj*, op. cit., fq. 58.

[332] Sipas: Mehmed Handzic, *Teme* ..., op. cit., fq. 144 – 145.

[333] *Islam u Madzarskoj*, op. cit., fq. 58. Krhs.: T. O. Tarhani, op. cit., fq. 43.



Copyrighted material

ishin më herët. Në vitin 1162 mbreti hungarez Gejza IV e dërgoi ushtrinë e vet në ndihmë perandorit gjerman Fridrih Barbarosës, kurse në këtë ushtri kishte 500 ismailitë.[334] Sipas të dhënave ndërmjet viteve 1235 dhe 1270 ismailitët i gjejmë si këmbyes parash, të cilët i huazojnë mbretit hungarez para.[335] Kurse në vitin 1260 muslimanët i gjejmë si ushtarë të mbretit.[336] Në këtë kohë, përkundër kushteve të rënda, muslimanët në Hungari konvertuan hungarezë në Islam. Mënyra ishte kjo: hungarezi që i kishte borxh muslimanit, e nuk kishte mundësi ta kthejë borxhin, nëse e përqafonte islamin i falej borxhi.[337]

Për shkak të rritjes së ndikimit të muslimanëve dhe jokatolikëve përgjithësisht në Hungari, mbretërit hungarezë, kisha katolike vendore dhe papati në Vatikan ndërmorën masa edhe më të rrepta kundër muslimanëve dhe hebrenjve.[338]

*'Bula e artë'*, neni 24 i saj, nga viti 1222 ka ndaluar punësimin e muslimanëve në shërbimet shtetërore, pastaj ka kërkuar që të pengohet çdo ndikim i saracenëve,[339] por edhe këto masa nuk e dhanë rezultatin e kërkuar dhe nuk patën jehonë më vendimtare.

I frikësuar dhe i shqetësuar me gjendjen dhe fatin e katolicizmit në Hungari, "papa Gregori IX (1227 –1241) duke i shkruar më 03. 03. 1231 peshkopit të Strigonës në Hungari, shprehu keqardhje që kristianët, për t'u liruar nga shfrytëzimi dhe barët e ndryshme që ua ngarkojnë saracenët, kalojnë tek ata dhe i pranojnë ritet e tyre dhe me ta martohen. Kurse saracenët, në mënyrë që më lehtë

---

[334] Mehmed Handzic, *Teme ...*, op. cit., fq. 145.
[335] Ibid.
[336] *Islam u Madzarskoj*, op. cit., fq. 58.
[337] Ibid.
[338] Salih Hadzialic, *Manihejska proslost srednjovjekovne Bosne*, Islamska misao, Sarajevë, nr. 143/1990, fq. 10. Krhs.: *Islam u Madzarskoj*, op. cit., fq. 58.
[339] *Islam u Madzarskoj*, op. cit., fq. 58.



Copyrighted material

të vijnë deri te vashat kristiane, bëhen se gjoja janë kristianë, që menjëherë pas kurorëzimit t'i detyrojnë femrat në qëndrim renegat ndaj besimit kristian"[340].

I pakënaqur me këtë gjendje në Hungari, papa i Vatikanit, Gregori IX[341], më 25. 02, 1232 bëri anatemën kishtare mbi Hungarinë për shkak se muslimanët në te, sipas tij, kishin status jashtëzakonisht të favorshëm.[342] Katër ditë më vonë, më 29. 02. 1232, kryepeshkopi hungarez, i shtrënguar nga papa Gregori IX, proklamoi *Interdiktumin*.[343]

I gjetur para një gjendjeje të këtillë, para mallkimit kishtar nga papa dhe kisha katolike vendore, mbreti Andrija, në vitin 1233 mori si detyrim para kardinalit Jakovit dhe aristokracisë vendore dhe para të deleguarit të papës, se saracenët do t'i largonte nga postet shtetërore dhe se do t'i mbikëqyr rigorozisht,[344] dhe detyrimisht do të bartin shenjën e fesë së vet në rroba për identifikim.[345]

Nga një burim i vitit 1242 shihet se muslimanët i mbijetuan edhe masat më të reja të Andreut II në Hungari, por ata tashmë janë më të dobët, në grupime më të vogla me emrin *saracen*, e disa edhe duke u shpërngulur nëpër vende të ndryshme. Disa u shpërngulën në drejtim të Bosnjës dhe si dëshmi të saj kemi vendin e quajtur

---

340 Fontes Codisis, Juris Canonici Orientalis, seria III, vëllimi 3, nr. 164, cituar sipas: Velimir Blazevic, *Mjesovite zenidbe u pravu Katolicke Crkve*, Zagreb, 1957, fq. 16.
341 Gregori IX udhëhoqi papatin gjatë viteve 1227 –1241. Zef Mirdita, *Krishtenizmi ndër shqiptarë*, Prizren – Zagreb, 1998, fq. 439.
342 *Islam u Madzarskoj*, op. cit., fq. 58. Shih: G. & J. Testas, Inkvizicija, Zagreb, 1982, fq. 1-52.
343 *'Interdictum'* – në historinë e të drejtës d.m.th. "mjet procesor i krijuar për ndërhyrje të shpejtë të pushtetit për ruajtjen e raporteve ekzistuese juridike, shtetërore" etj. (*Pravna enciklopedija*, I, Beograd, 1989, fq. 496), kurse në historinë e së drejtës kishtare katolike *'Interdictum'* d.m.th. "ndalesa e kryerjes së të gjitha ritualeve kishtare si ndëshkim kishtar për një zonë, qytet a shtet " etj. (Milan Vujaklija, *Leksikon stranih reci i izraza*, botimi III, Beograd, 1980, fq. 354.
344 Salih Hadzialic, op. cit., fq. 10; Rade Bozovic, op. cit., fq. 177; Mehmed Handzic, *Teme ...*, op. cit., fq.145.
345 *Islam u Madzarskoj*, op. cit., fq. 58.



Copyrighted material

*Kalesija*, ndërmjet Tuzllës dhe Zvornikut, nga *Kalisët*, për të cilët thuhet se qysh në fillim të shekullit XII janë pagëzuar, por në jetën publike ishin kristianë, kurse në jetën private ishin muslimanë,[346] e disa në drejtim të trojeve shqiptare, atëherë të okupuara nga Serbia, për t'u vendosur në luginën e Moravës dhe Vardarit dhe viseve përreth, e disa prej tyre do t'i gjejmë edhe në pallatin e car Dushanit.[347]

Goditje të fuqishme u dha muslimanëve edhe dyndja tatare e Xhingiz Kanit në vitin 1241, ku p. sh. pas rrethimit të qytetit Perega, hendeqet dhe kanalet e qytetit janë mbushur me trupa të muslimanëve.[348] Sipas po këtij burimi, në vitin 1266 kemi një fshat të tërë me muslimanë me emrin Temerkeny[349]. Vlen të theksohet se para sulmit tatar në vitin 1241 në Hungari janë regjistruar 210 vendbanime (qytete e fshatra), që sipas të gjitha gjasave i kanë populluar vetëm muslimanët që, ndonëse si pakicë fetare, paraqiste rëndësi të veçantë.[350]

Ndonëse muslimanët në Hungari, ku jetonin tashmë disa shekuj, u destabilizuan, disa u zhdukën nga hungarezët, disa nga tatarët, e disa, pos Bosnjës dhe trojeve iliro-shqiptare, ia mësynë edhe Moldavisë dhe Hordhisë së artë,[351] Finlandës,[352] dhe vendeve tjera të lindjes, kurse një pjesë përfundimisht janë asimiluar, megjithë lëvizjet

---

346 Salih Hadzialic, op. cit., fq. 10.

347 Abdurahman Hukic, *Arapi i Islam u Evropi,* Glasnik VIS-a, Sarajevë, 4-6/1961, fq. 153.
Ashpërsia e hungarezëve ndikoi që shumë muslimanë të shpërngulen në Serbi. Pasi edhe vetë serbët ishin në hall me hungarezët, ardhja e osmanlinjve pas betejës së Kosovës më 1389, bëri që jo vetëm muslimanët, por edhe vetë serbët t'u kundërvihen hungarezëve e të jenë krah me osmanlinjtë. Shih: Thomas W. Arnold, *Povijest islama,* botimi I, Sarajevë, 1989, fq. 231 – 232; Mehmed Handzic, *Teme* ..., op. cit., fq. 145 – 146.

348 Mehmed Handzic, *Teme* ..., op. cit., fq. 145.

349 Ibid

350 *Islam u Madzarskoj*, op. cit., fq. 58.

351 Ibid.

352 T. O. Tarhani, op. cit., fq. 43; A. Hukic, op. cit., fq. 152.



Copyrighted material

e mëdha që solli ushtria e Xhingiz Kanit sërish në Hungari solli grupe më të vogla muslimanësh. Kështu, pas vitit 1238, bullgarët povollian që patën mbetur në vendlindjen e tyre të parë, erdhën në disa pjesë të Hungarisë.[353] Ky grup u forcua shpejt, sepse ndër të tjera, punuan shumë në arsimimin e tyre, duke shkuar disa muslimanë hungarezë në shkollim në vendet arabe.[354]

Ndonëse në disa burime pohohet se shënimi i fundit i shkruar për muslimanët në Hungari haset deri në vitin 1291,[355] Th. W. Arnoldi cek se në Hungari kishte muslimanë, kuptohet në përmasa më të vogla, deri në vitin 1340, kur mbreti hungarez Karlo Roberti i detyroi muslimanët e mbetur që ta pranojnë kristianizmin ose të shpërngulen nga shteti i tij.[356]

Fati i mëtejshëm i muslimanëve nuk është i njohur, pos edhe të dhënës se gjatë sundimit të Ludvigut të Madh (Llajoshit të Madh) (sundoi 1342 – 1382) përmenden edhe disa familje muslimane,[357] për t'u ruajtur kujtimi për të gjithë këta muslimanë në antroponime, patronime, toponime etj. Islamin në Hungari do ta kemi sërish me ardhjen e osmanlinjve në këto troje.

---

353 A. Hukic, op. cit., fq. 152.
354 T. O. Tarhani, op. cit., fq. 43.
355 *Islam u Madzarskoj*, op. cit., fq. 58.
356 Th. W. Arnold, op. cit., fq. 231; Mehmed Handzic, *Teme* ..., op. cit., fq. 145; A. Hukic, op. cit., fq. 152 – 153.
357 Mehmed Handzic, *Teme* ..., op. cit., fq. 146.



Copyrighted material

## Përfundim

Islami dhe muslimanët në Hungarinë mesjetare nga shekulli IX deri XIV kaluan nëpër faza të ndryshme të bashkëjetesës me hungarezët, të ardhur nga lindja e të vendosur në Evropën qendrore kah fundi i shekullit IX. Faktorët që ndikuan në cilësinë e bashkëjetesës ndërmjet shumicës fillimisht pagane e mëpastaj kristiane hungareze dhe pakicës muslimane (ismailitët, bashgirdët, turqit vardariot, bullgarët, peçenegët, magrebianët etj.) ishin si të natyrës materiale (supremacioni politik, ushtarak, ekonomik etj.) ashtu edhe të natyrës shpirtërore (paragjykimet fetare kristiane kundrejt muslimanëve dhe insistimi i vazhdueshëm i Vatikanit te mbretërit hungarezë që muslimanët të kryqohen, të largohen ose të zhduken nga Evropa.

Përkundër vështirësive të shumta nëpër të cilat kaluan muslimanët, muslimanët në Hungarinë mesjetare mbijetuan deri vonë, për t'u zhdukur, thuajse tërësisht, kah mesi i shekullit XIV.

Në këtë përfundim vlen të tërhiqet vëmendja se kjo temë sikur edhe shumë të tjera të ngjashme janë të injoruara nga shkencëtarët eminentë shqiptarë dhe institucionet kompetente shqiptare. Po ashtu, as njohësit e gjuhëve orientale nuk bënë asgjë në ndriçimin e veprave të udhëpërshkruesve apo gjeografëve muslimanë nga Mesjeta, për të dhënë dritë të re dhe për të shkruar histori më objektive. Angazhimin tonë intenziv për një kohë të



Copyrighted material

gjatë për hulumtimin e *pro et contra* argumenteve, valorizimin, interpretimin e tyre dhe shkruarjen e një studimi të karakterit kulturo-historiko-shkencor, me gjithë mangësitë që ka, e shohim si pikënisje për një punë edhe më studioze në perspektivë.



Copyrighted material

# Summary

## Islam and Muslims in Mediaeval Hungarian (IX-XIV century)

Islam and Moslems in mediaeval Hungary went through various phases of the coexistence with Hungarians from the IX until the XIV century. The Hungarians had come from the east and settled in Central Europe towards the end of the IX century. The factors which influenced the quality of the coexistence of the Hungarian majority, who were originally pagan and later Christian and the Moslem minority (Ishmaelite, Bashkire, Vardarian Turks, Bulgarians, Pechenegs, Magrebians etc.) were of a material nature (political, military and economic supremacy etc.) and also of a spiritual nature (prejudice of the Christian religions against the Moslems) and the continual insistence of the Vatican to the Hungarian Kings that the Moslems should convert to Catholicism, leave Europe or be exterminated.

In spite of the many difficulties which they had to overcome, the Moslems in Mediaevel Hungary survived until a fairly late date and disappeared almost completely only about the middle of the XIV century.



Copyrighted material

Copyrighted material

# Shtojca I

## Jakut El-Hamewiu

### Bashkirët[358]

"**Bashgird** (disa e shqiptojnë Bashxhird, e disa Bashkird) është vendi ndërmjet Konstantinisë (Stambollit) dhe Bullgarisë. Muktedir Bil-lahi e pati dërguar Ahmed ibn Fadlan ibn Abbas ibn Rashid ibn Hammadin, klientin (mevla) e Emiru'l-mu'minin, pastaj klientin e Muhammed ibn Sulejmanit, mbretit të Sllavëve, i cili e pati pranuar islamin bashkë me banorët e vendit të vet, që t'ua përcjellë pelerinat dhe t'ua mësojë dispozitat islame. Ibn Fadlani ka rrëfyer çdo gjë që ka parë prej kur ka dalë nga Bagdadi, deri sa nuk u kthye, kurse nisja e tij ishte në muajin safer të vitit 309 (921). Kur përmenden Bashgirdët Ibn Fadlani thotë: "Dhe erdhëm në vendin e një populli turk që quhet Bashgird, nga të cilët jemi frikësuar dhe ruajtur, sepse ata ishin më të tmerrshmit ndër turqit, më të fuqishmit dhe më insistuesit për vrasje. Njëri prej tyre e takoi një njeri, ia theu kokën, të cilën e mori, kurse atë (trupin) e la. Ata i rruajnë mjekrat dhe i

[358] Shkëputje nga vepra monumentale e Jakut El-Hamewiut "*Mu'xhem'ul-buldan*", II, Kairo, 1906, fq. 37 – 39, sipas: Mehmed Handzic, *Teme iz opce i kulturne historije*, II, Sarajevë, 1999, fq. 146 – 149).



Copyrighted material

hanë veshët. Disa nga ata i hulumtojnë rrobat e tyre dhe me dhëmbë i ndrydhin ata. Me ne ishte një njeri i tyre, që kishte pranuar islamin. E kam parë një ditë se ky kur e gjeti morrin, e mbyti me thua, e pastaj e fërkoi thoin dhe kur më vërejti mua tha: Mirë!

Secili prej tyre ka prerë një dru për vete në madhësi të kurorës, të cilin e varë për vete, dhe kur dëshiron të udhëtojë ose kundër armikut të luftojë e puthë, i përkulet duke folur: "O Zot ma jep këtë dhe këtë". I thashë përkthyesit që ta pyes njërin prej tyre se cila është mbështetja e tyre dhe argumenti i tyre për këtë veprim dhe përse e konsideron për Zot të vetin? U përgjigj se ai është krijuar nga i ngjashmi dhe se nuk njeh për vete krijues tjetër. Ndërmjet tyre ka disa që besojnë se ka 12 (kurse i numëroi 14) zota: zoti i dimrit, zoti i verës, zoti i shiut, zoti i erës, zoti i drurit, zoti i njerëzve, zoti i shtazëve, zoti i ujit, zoti i natës, zoti i ditës, zoti i vdekjes, zoti i jetës, zoti i tokës dhe zoti i qiellit, i cili ndër ta është më i madhi. Ai takohet me këta në harmoni dhe çdonjëri prej tyre kënaqet me atë që bën shoku i tij (Zoti ynë është i lartësuar nga ato që flasin mëkatarët dhe ata që nuk besojnë!) E kemi parë një grup në mesin e tyre, që i adhurojnë gjarpërinjtë, disa që i adhurojnë peshqit dhe grupin që adhurojnë kurrilët. Më kanë rrëfyer, se njëherë luftuan me disa njerëz, të cilët ishin armiq të tyre. Armiqtë fituan, kurse pas tyre kurrilët lëshuan zë, dhe armiqtë humbën pasi njëherë patën fituar. Për këtë arsye filluan t'i adhurojnë kurrilët duke thënë: "Ata janë zotërat tanë, sepse ata i fituan armiqtë tanë." Këtë e shënoi Ibn Fadlani për ta, e sa më përket mua, unë kam gjetur në qytetin Halep (Aleppo) grup të madh të cilët i quajnë Bashgirdë. Janë tërësisht bardhoshë në flokë dhe fytyrë. Mësojnë fikhun sipas shkollës (medhhebit) së Ebu Hanifes, Zoti qoftë i kënaqur me të. E pyeta një njeri ndër ta, të



Copyrighted material

